

**FEJA
DHE TRAJTIMI I SAJ
NË SHOQËRI**



Dr. Xhabir Hamiti

DR. XHABIR HAMITI

FEJA DHE TRAJTIMI I SAJ NË SHOQËRI

Prishtinë, 2014

Redaktor gjuhësor:
Ermal BEGA

Korrektor letrar:
Besnik JAHA

Faqosja:
Ermal BEGA

Kopertina:
Kushtrim HAMITI

© Autori, Prishtinë 2014

Fjala e recensuesve

Feja, gjatë gjithë historisë ka luajtur një rol të rëndësishëm në orientimet dhe tundimet e shoqërive njerëzore në përgjithësi, pesha dhe roli i të cilës as sot nuk është zvogëluar në formimin e identitetit personal, shoqëror dhe atë kulturor të njerëzve.

Libri “Feja dhe trajtimi i saj në shoqëri”, i autorit Xhabir Hamiti ngërthen në vete dimensione të rëndësishme mbi trajtimin e fesë dhe mësimëve të saj në përgjithësi dhe të atyre islame në veçanti. Ky libër vjen mu në kohën kur format, qasjet si dhe këndvështrimet e disa shpjeguesve të fesë, brenda dhe jashtë rrethit tonë kanë marrë kahje të re, me tendencë të ngjyrosjes së saj me ideologë dhe ideologji politike të huaja. Hamiti përmes këtij punimi, në formë akademike dhe argumentuese vë në pah se feja islame në parimet e saj e pranon diversitetin etnik, racor dhe fetar, të të gjithë njerëzve pa dallim, dhe se çdo thirrje dhe qasje tjetër e kundërt, e cila mbjell dhe kultivon ndasi, urrejtje dhe fton në luftë kundër të tjerëve në emër të saj, është thirrje e cila bie ndesh me mësimet hyjnore dhe me vet Krijuesin.

Një hapësirë të rëndësishme në këtë libër zë edhe vlera shumë shekullore e harmonisë, respektit dhe tolerancës fetare në mesin e shqiptarëve, të cilën autori e sheh edhe sot si

shtyllë të pakontestueshme të unitetit, stabilitetit dhe zhvillimit tonë kombëtar dhe fetar.

Porositë, këshillat dhe sugjerimet, të cilat dalin nga ky studim janë të nevojshme dhe të domosdoshme, si në kontekstin e kohës ashtu edhe për interesin e përgjithshëm shoqëror dhe kombëtar.

Autori në këtë studim të tij ka bërë një paraqitje brilante të theksuar shkencore, si rrallëherë që ndodh në studime të tilla teologjiko-doktrinare.

Prof. dr. Ismail HASANI
Rektor i Kolegjit Universitar Humanistica
Ferizaj, Kosova

~~~

Libri më i ri i Dr. Xhabir Hamitit, "Feja dhe trajtimi i saj në shoqëri" paragjykimet dhe stereotipet abuzive mbi Islamin dhe tendencën e shumë formave të ndryshme interpretuese të tij në arealin shqiptar dhe përgjithësisht atë global, mundohet t'i vë në kornizat e një logjike shkencore dhe padyshim të kuptueshme jo vetëm për elitën intelektuale por edhe për lexuesin e rëndomtë. Hamiti, paragjykimet dhe stereotipet e tilla nuk i konteston *ad hoc*, por përmes argumenteve shkencore islame. Në fakt, autori, këtë proces të analizimit e padyshim edhe të kontestimit të rrymave dhe fraksioneve që aktualisht kanë vërshuar edhe në "tregun" e Ballkanit Perëndimor, e bënë përmes interpretimeve të ajeteve kur'anore dhe haditheve autentike të Profetit Muhammed (a.s.).

Fryma e interpretimit mbi fenë islame, natyrisht është subjektive, por, një qasje objektive dhe tipike shkencore mund të dëshmojë dhe kontribuojë mjaft shumë edhe në interpretimet subjektive të rrymave dhe drejtimeve kontemplative mbi të, si fe të pages dhe tolerancës midis popujve dhe kombeve në shekullin tonë. Në këtë drejtim, Hamiti duke e elaboruar këtë kontekst jo vetëm fetar, por edhe sociologjik përmes grykës shkencore, pra, përmes një lloj mimezisi social, dëshmon jo vetëm për përgatitjen e tij akademike, por edhe për erudicionin dhe gjerësinë e të kuptuarit dhe sensin e akomodimit të Islamit me kohën tonë, që

në fakt mund ta hasësh pak apo pothuajse aspak në literaturën mbarëshqiptare. Si njohës i Islamit burimor, autori me mjaft kompetencë, përveç përpjekjes për t'i kontestuar “tipologjitë” e adresuara paragjykuese nëpër shekuj nga politika, islamofobët, argatët e ndryshëm pseudoshkencorë dhe pseudosocialë, ofron edhe shumë argumente bindëse sociale për Islamin si fe e paqes dhe tolerancës, ashtu siç edhe është në të vërtetë urtextin i tij.

**Prof. dr. Fadil MALOKU, sociolog**



## PARATHËNIE

Islami bën pjesë në mesin e feve monoteiste me përmasa globale, pjesëtarët e së cilës janë të shpërndarë gati në të gjitha pjesët e botës, ku më shumë e ku më pak. Ndryshe, për nga numri, muslimanët përbëjnë rreth 1.5 miliard të popullatës në tokë, shifër kjo e cila, kuptohet, ndryshon nga viti në vit.

Sipas hulumtimeve dhe analistëve të kohës, interesimi i njerëzve për fenë në përgjithësi, nuk është duke u zbehur, përkundrazi është më i gjallë dhe më aktiv. Ajo me të cilën të gjithë pajtohen në kohën e sotme bashkëkohore, është fakti se paqja dhe stabiliteti i shoqërive në botë janë të lidhura ngushtë me nivelin e respektimit dhe të konsideratës së bindjeve shpirtërore të njerëzve pa dallim. Kultura e kultivimit të respektit dhe të tolerancës ndaj lidhjes dhe besimit shpirtëror të çdokujt, sot shihet si përgjegjësi e të gjitha strukturave të një shoqërie të edukuar dhe përparimtare, duke filluar nga prijësit e besimeve fetare në rend të parë, pastaj të intelektualëve, të institucioneve edukative-

arsimore si dhe të organizatave joqeveritare dhe institucioneve shtetërore të një rrethi, vendi apo bashkësie të gjerë shoqërore.

Përfaqësimi i lirë fetar i dikujt duhet trajtuar si vlerë e zgjedhur e tij, përderisa ai nuk cenon lirinë e tjetrit dhe nuk e keqpërdor bindjen e tij shpirtërore për të dëmtuar dhe luftuar tjetrin në emër të saj. Ngritja e vetëdijes dhe të ndërgjegjes së qytetarëve, për trajtimin e fesë dhe sjelljen me të në formën dhe mënyrën më të mirë dhe më civilizuese të mundshme, është obligimi ynë si prijës fetarë vendorë, por edhe i çdo njeriu mendjehapur dhe dashamirës i vendit dhe i së ardhmes sonë.

Në Kosovë dhe në trojet shqiptare në përgjithësi, në dekadën e fundit të shekullit 20 dhe në dekadën e parë të shekullit 21, kemi qenë dëshmitarë të shumë lëvizjeve të reja fetare dhe sektare, të cilat në vete kanë bartur dhe bartin prapavijë dhe nijet jo të mirë për vendin dhe të ardhmen e shoqërisë sonë. Shumë nga protagonistët e tyre janë sjellë dhe po sillen me ne, sikur në këto troje asnjëherë nuk ka pasur traditë dhe kulturë fetare, duke bartur e imponuar modele dhe qasje, të cilat janë treguar e vërtetuar si të dështuara në vetë origjinën e tyre. Lëvizjet fetare me ngjyrimë politike, nuk po zënë vend të duhur dhe nuk po tregohen stabilizuese në asnjë vend dhe shoqëri ku ato sot janë aktive, prandaj, pse duhet që ne t'i kopjojmë ato, kur paraprakisht dihet se cili është epilogu i tyre.

Tendencave të jashtme për të na ndarë e përçarë në emër të “fesë” duhet t’u themi “ndal”.

Fenë dimë dhe mundemi t’a kultivojmë e zhvillojmë vetë, pa ndikime dhe kushtëzime të jashtme, ashtu siç ditën dhe bënë prijësit fetarë të rilindjes sonë, të cilët ruajtën edhe fenë edhe atdheun njëkohësisht duke mos e cenuar e dëmtuar atë me asnjë çmim. Diversitetet fetare në shoqërinë tonë shqiptare, janë vlera dhe pjesë e thellësive tona shekullore, të cilat kanë ecur bashkërisht krah për krah në vuajtje e gëzime, në respekt dhe tolerancë të ndërsjellë nga ithtarët dhe pasuesit e tyre.

Libri “Toleranca Fetare - Rrugë që duhet ndjekur”, përmban opinione dhe reflektime të reja të kohës, lidhur me trajtimin e fesë në përgjithësi dhe tek ne shqiptarët në veçanti. Uroj që ky punimi im sadopak të japë një dritëz në këtë drejtim, me qëllimin më të mirë që, si shoqëri, popull dhe komb gjithmonë të jemi të bashkuar dhe të vëllazëruar, në të mirë dhe në shërbim të të gjithëve pa dallim.

Zoti qoftë me ne!

**Doc. dr. Xhabir Hamiti**



## FEJA DHE INTERPRETIMI I SAJ NË MESIN TONË

***“Feja është një institut që vëllazërimin e ka parim themelor, e kur ajo bie në shkallë sa bëhet vegël anarkie për të përçarë një popull nuk është më fe, por është shoqëri politike e mshefun nën maskën e fesë; është një fe deformuese.”<sup>1</sup>***

Në botë ekzistojnë shumë fe dhe besime të ndryshme, të cilat njeriu qysh herët i ka zgjedhur si besim të vetin shpirtëror<sup>2</sup>.

Në mes të feve dhe besimeve të ndryshme, ka dallime sipërfaqësore dhe rrënjësore. Në literaturën e studimeve fetare, fetë ndahen kryesisht në dy grupe kryesore; qiellore dhe tokësore. Fe qiellore sot njihen tri, si më të mëdhatë dhe më me ndikim në botë, të ndara sipas periudhave historike; Hebraizmi,

---

<sup>1</sup> Revista *Zani i Naltë*, Nr. 3, Shkodër, 1936, f. 72.

<sup>2</sup> Historia ka regjistruar elemente fetare tek njerëzit që para 5000 viteve, ndoshta më herët. Me historinë mbi feve në formë akademike, për herë të parë ka filluar të merret Gjermania, e cila në shekullin 19 kishte themeluar shkollën e quajtur “*Religionsgeschichtliche Schule*”, shkollë kjo e cila edhe sot si objekt studimi ka fenë si fenomen socio-kulturor. Përveç Gjermanisë, edhe Universiteti i Çikagos në Amerikë nxjerr revistën e quajtur “*History of Religions*”, të themeluar në vitin 1961, e cila boton artikuj të rëndësishëm, të cilët merren me studimet e fenomenit të feve që nga koha e parahistorisë deri në kohën e sotme moderne.

Krishterimi dhe Islami<sup>1</sup>. Ndërsa, në mesin e feve tokësore hyjnë kryesisht fetë e shpikura nga individë të caktuar, të cilët kanë pasur apo kanë për qëllim që përmes tyre të realizojnë interesa individuale, familjare, materiale apo fisnore, pa përjashtuar edhe interesa politike në shumë raste.

Dallimi i feve qiellore nga ato tokësore është në gjenezën e tyre. Qielloret në esencë, i ftojnë njerëzit në monoteizëm (besimin në një Zot të Vetëm), edhe pse ato janë të ndryshme në mënyrën dhe formën e interpretimit të monoteizmit. Gjithashtu, për dallim nga ato tokësore, ato kanë librin e shenjtë hyjnor dhe kumtuesin hyjnor, peygamberin (profetin, ferrëfyesin).

Hebraizmi mbështet në Teuratin (Dhiatën e vjetër) dhe në profetin Musa (Moisiu), kurse Krishterimi në Inxhil (Dhiatën e re) dhe në profetin Isa (Jezus) dhe apostujt e tij. Ndërsa Islami, është një fe e bazuar në Kur'an dhe në thëniet e profetit Muhammed a.s., të njohura në literaturën islame si Hadith dhe Sunnet.

Fetë qiellore (monoteiste), janë kumtuar dhe shpjeguar në rend të parë nga peygamberët, për të vazhduar më pas nga ithtarët, dijetarët e pasuesit e tyre. Me shtimin e numrit të besimtarëve, janë rritur dhe zgjeruar edhe mësimet fetare, duke u shpërndarë anekënd botës.

---

<sup>1</sup> Si fe qiellore disa nga studiuesit e fesë i renditin edhe Budizimin dhe Konfuçianizmin.

Këto fe qiellore, në lindjen e tyre, janë shpjeguar në gjuhën e shpalljes, nga njerëz të cilët kanë komunikuar me atë gjuhë, ndërkaq, me kalimin e kohës ato janë përcjellë e zgjeruar edhe përmes gjuhëve të tjera nga mesi i fiseve, popujve e kombeve të ndryshëm, të cilët ato i kanë pranuar dhe përqafuar si besimin shpirtëror të tyre.

Në mesin e shumë shoqërive dhe popujve që pasojnë fetë qiellore (monoteiste) është edhe bota perëndimore, pjesë e së cilës jemi edhe ne shqiptarët. Tri fetë qiellore për të cilat po flasim, më me ndikim në botë, nuk kanë lindur në kontinentin e Europës, por në pjesën lindore të globit tokësor, më saktë në Lindjen e Mesme, atëbotë kur toka ende nuk ishte e ndarë në vija gjeografike siç është sot.

Interpretimet e mësimave të feve jashtë origjinës dhe vendlindjes së tyre, për shkak të një varg rrethanash politike e shoqërore përmes së cilave kanë kaluar popujt, kanë pësuar ndryshime, ku më pak e ku më shumë.

Feja islame, të cilës i takojnë pjesa dërrmuese e shqiptarëve edhe sot në Ballkan, kohëve të fundit, jo rrallëherë është bërë cak i sulmeve dhe shpifjeve të individëve dhe qarqeve të ndryshme, që padenjësisht Islamit i kanë dhënë një pasqyrë të keqe që nuk i përket. Islamit këtë pamje po ia veshin edhe grupe të caktuar njerëzish, të paditur ose keqpërdorues të fesë, keqdashës të paqes, të cilët për realizimin e objektivave dhe interesave

të ngushta individuale apo grupe, ideologjike apo politike, kanë dalë jashtë binarëve të shëndoshë të saj dhe jashtë racionalitetit, duke e shndërruar veten në kameleonë.

Në këtë kontekst, vlen të thuhet se të gjithë ata që duan të shkruajnë për Islamin si fe, është mirë që, paraprakisht, të dinë të bëjnë dallimin mes tij dhe ithtarëve të tij.

Njeriu si besimtar mund të jetë pasues i denjë dhe jo i denjë i fesë dhe mësimëve të saj. Fatkeqësisht, sot ka individë të caktuar, të cilët mundohen që Islamin ta nxjerrin nga natyra e tij e vërtetë dhe nga konteksti origjinal i tij, duke shtrembëruar me ose pa vetëdije, duke e keqinterpretuar si dhe duke e paraqitur gabim misionin e tij të shenjtë e të drejtpeshuar në origjinë.

Një pasues i denjë i Islamit burimor dhe mësimëve të tij, nuk mund të ketë ndonjë urrejtje pa arsye të justifikueshme për asnjë qenie njerëzore në gjithë sipërfaqen e tokës, pa marrë parasysh fenë, gjininë, kombin apo racën-ngjyrën e tij.

Një musliman i devotshëm nuk guxon të fyejë padrejtësisht, nuk guxon të vrasë një njeri të pafajshëm, nuk guxon të vetëvritet duke vrarë veten dhe njerëz të tjerë, për realizimin e objektivave dhe qëllimeve fisnore apo sektare, siç ka ndodhur dhe është duke ndodhur në disa pjesë të botës islame; në Irak, Afganistan, Palestinë, Pakistan, Oman, apo siç ka ndodhur

edhe më herët në shpërthimet vetëvrasëse, që kanë shkatërruar dhe vrarë në masë të madhe jetë civilësh, siç janë rastet në shumë qendra të botës perëndimore; në Nju Jork, Londër, Madrid, Stamboll, e së fundmi edhe në Boston e gjetiu.

Nëse në të kaluarën ose sot, grupe të caktuara kanë keqpërdorur fenë, atëherë gjykimi duhet të jetë i përkufizuar dhe të rëndojë mbi individin ose grupin, e jo mbi fetë të cilave ata ose ato u përkasin, sepse koncepti i fesë është shumë më i gjerë dhe shumë më gjithëpërfshirës se sa koncepti i një individi apo grupi të caktuar.

Feja si tërësi dhe komplete, nuk mund të shihet e plotë pos tek Pejgamberi a.s.. Të gjithë ata që mendojnë se pas Pejgamberit a.s., fenë e gjejnë të gjallë, të praktikuar, të zbatuar në jetë në çdo plan, edhe te ndonjë njeri tjetër i zakonshëm, gjykojnë gabim.

Ashtu si edhe fetë e tjera qiellore, ithtarët e të cilave janë të shpërndarë në shumë vende të botës, po ashtu edhe Islami dhe muslimanët janë të shpërndarë në shkallë globale. Universalizmin e fesë islame ndryshe e dëshmon edhe Kur’ani në shumë ajete të tij, ku gjithë njerëzimit pa dallim i bën thirrje me shprehjen e përgjithshme: **“Ja ej-juhe nas!”** (*O ju njerëz!*) Prandaj, nisur nga ky apel kur’anor, askush nuk ka të drejtë të bëjë monopolizimin e fesë, duke e quajtur veten si pasues parësor të saj, kurse të tjerët si dytësorë apo të tretë.

Edhe pse të gjitha fetë monoteiste të lartpërmendura burojnë nga Lindja e Mesme, megjithatë nuk mund të thuhet me asnjë argument se banorët e asaj pjese të botës janë më besimtarë apo më të devotshëm se sa banorët e pjesëve të tjera të rruzullit tokësor. Për shembull, Malajzia si vend dhe si popull, sot për sot, praktikisht është shumë më i përkushtuar ndaj Islamit se sa shumë pjesë të tjera në Lindjen e Mesme, ku flitet dhe shkruhet në gjuhën e shpalljes hyjnore. Edhe francezët ose italianët besohet se janë më shumë të përkushtuar ndaj fesë katolike se sa pjesëtarët e tjerë të krishterë të shumë vendeve të Lindjes së Mesme.

Sa i përket Islamit, rrugët e interpretimit të tij nuk kanë qenë dhe nuk mbasin as sot të pandryshueshme. Islami në gjenezën e tij është një fe e përhershme e mbështetur në tekstin e pandryshueshëm të Kur'anit, mirëpo natyra dhe qasja e interpretuesve të tij nga koha në kohë është e ndryshueshme dhe evolutive<sup>1</sup>. Komentimet dhe analizat e studiuesve për Islamin janë prodhime shkencore, të cilat burojnë nga njerëz me rezonime të ndryshme, të cilët, jo rrallë, për arsye të rrethanave shoqërore, politike dhe gjeostrategjike përmes të cilave ata kalojnë,

---

<sup>1</sup> Qasjet dhe këndvështrimet e ndryshme të dijetarëve të Islamit më së shumti shihen në komentimet e shumta të Kur'anit, përgjatë shekujve, sidomos gjatë shpjegimit që ata i bëjnë dispozitave të caktuara shariatike-legjislative si dhe disa çështjeve të akaidit (doktrinae të besimit).

ndikohen në mënyrë direkte ose tërthorazi që të bëjnë interpretime dhe shpjegime të mësimëve islame, jo identike njëra me tjetrën, varësisht nga rrethi dhe vendi ku ata jetojnë dhe veprojnë. Kjo tregon se prodhimet e tyre mendore dhe intelektuale mbi fenë nuk janë të shenjta siç është vet feja në esencën dhe zanafillën e saj.

Shumë mësimë dhe porosi kur'anore vazhdojnë të mbesin edhe më tutje të hapura për shtjellim dhe elaborim, përkatësisht në dispozicion të dijetarëve të kohës. Të gjithë studiuesit muslimanë janë të pajtimit se Muhammedi a.s., sa ishte gjallë nuk e ka komentuar Kur'anin në tërësi, por e ka lënë në disponim të gjeneratave të ardhshme, në mënyrë që ato vazhdimisht të merren me studime dhe analiza të reja.

Rol të rëndësishëm në interpretimin e suksesshëm të feve në përgjithësi dhe të Islamit në veçanti luajnë disa faktorë, të cilët nuk duhen anashkaluar në asnjë mënyrë, si:

- vendi, përkatësisht rrethanat shoqërore të një populli;
- niveli edukativo-arsimor i tyre;
- kultura, tradita dhe zakonet (*urfi*).<sup>1</sup>

Ne si shqiptarë dhe si pjesëtarë të dy besimeve fetare, deri më sot kemi qenë të kujdesshëm në interpretimin e fesë në përgjithësi, sepse përmes

---

<sup>1</sup> Në rast se këta faktorë anashkalohen ose neglizhohen nga ana e thirrësve, dëmi për fenë dhe ithtarët e saj do të jetë shumë më i madh se sa dobia.

saj gjithnjë kemi krijuar më shumë elemente të bashkëjetesës dhe respektit ndërfetar se sa elemente të ndarjes dhe distancimit nga njëri tjetri<sup>1</sup>.

Një rol të rëndësishëm për këtë vlerë, e kanë të gjithë prijësit shpirtërorë, nga të gjithë komunitet fetare shqiptare, pa dallim. Në vijim, vlen të shkëputen disa fragmente të tyre të rëndësishme në lidhje me këtë:

Njëri nga komentuesit më të njohur të Kur'anit tek shqiptarët, në fillim të shekullit 20, **Hafiz Ibrahim Dalliu**, në favor të bashkëjetesës fetare ndërsqiptare thoshte: *“Ne shqiptarët, prej çdo feje qofshim, jemi tanë vllazën gjaku dhe vllazën vatani. Do të shkojmë mbarë e mirë me shoq si jemi tue shkue, do të punojmë së bashku për lulzimin e atdheut tonë dhe do ta mbrojmë atë me gjakun tonë”*.

Ndërkaq, **Mulla Idriz Gjilani**, imam dhe predikues i thellë i Islamit në trojet shqiptare nënvizonte: *“Kemi tri fe, por kemi vetëm një Atdhe të përbashkët, një gjak vëllazëror, një gjuhë, një diell e një Zot. Detyrë mbi detyrat kemi bashkimin dhe mbrojtjen e atdheut.”*

**Haxhi Vehbi Dibra**, i cili për 17 vjet rresht qëndroi në krye të hierarkisë më të lartë të Komunitetit Musliman në Shqipëri, hapur u drejtohej besimtarëve me fjalët e tij: *“Kristianë e myslimanë janë vëllezër shqiptarë të pandarë... Ta*

---

<sup>1</sup> Taborët ngacmues, urrejtës dhe përçarës në emër të fesë janë ogurzi për kombin dhe shoqërinë tonë, të cilëve u gëzohen vetëm armiqtë tanë.

*duam njëri-tjetrin..., t'i tregojmë botës mbarë se shqiptarët pa dallim feje, janë vëllezër si bij të njëshëm të së dashurës sonë Shqipëri.<sup>1</sup>*

Ndërsa **Atë Gjergj Fishta**, në favor të kultivimit dhe të respektit të ndërsjellë fetar ndër shqiptarët deklaronte: *“Është e vërtetë se ne kemi Bajram e Pashkë, por Shqiptarinë e kemi të përbashkët.”<sup>2</sup>*

Është interesant gjithashtu të përmendet fakti se shqiptarët edhe në rezistencën e tyre mbi njëshekullore kundër armiqve të tyre sllavë, serbëve, grekëve dhe malazezëve, asnjëherë nuk e kanë përdorur fenë si instrument në mbrojtje të lirisë dhe atdheut të tyre, edhe pse shumë herë ishin të kërcënuar edhe mbi bazën e saj, të cilës si shumicë i përkisnin.

---

<sup>1</sup> Shih Qazim Xhelili, *“Toleranca në marrëdhëniet midis komuniteteve në Shqipëri dhe ndikimi i tyre në jetën shoqërore, në periudhën midis dy luftërave botërore, Krishterimi ndër shqiptarët - simpozium ndërkombëtar”*, Tiranë, 16-19 Nëntor 1999, Shkodër 2000.

<sup>2</sup> Ibid.

## **Liria e bindjes dhe besimit shpirtëror sipas Kur'anit**

Liria e bindjes dhe besimit, për të cilën dekadat e fundit janë shkruar rregulla dhe norma me karakter ndërkombëtar duke e kategorizuar si një të drejtë elementare të çdo individi, është përmendur qysh herët edhe në librin e shenjtë, Kur'anin. Besimi në Zot, sipas shumë ajeteve kur'anore, shihet si një e drejtë ekskluzive e çdo individi. Në vijim, në lidhje me këtë çështje të rëndësishme do të shkëpusim disa ajete domethënëse të Kur'anit:

Në suren El-Bekare, ajeti 69, në formë të prerë thuhet se: **“Nuk ka dhunë në fe”** - (*La ikrahe fi ed-din*). Rrënja e fjalës *Ikrahe* - *kerihe* është përmendur disa herë në Kur'an, përmes konteksteve të ndryshme; në kuptimin e dhunës - imponimit të një veprimi jashtë vullnetit të dikujt dhe si diçka që urrehet në brendësinë e njeriut, etj.<sup>1</sup>

Prandaj, kuptimi që del nga rrënja e kësaj fjale, si dhe nga kontekstet në të cilat është përmendur ajo në Kur'an, rezulton se njeriu nuk gëzon të drejtën që të tjerëve t'ju imponojë bindjen e tij shpirtërore të besimit.

Në të gjitha udhëzimet e përgjithshme kur'anore, individi është lënë i lirë të zgjedhë mes besimit dhe mosbesimit:

**“Kushdo le të besojë e kushdo le të mohojë”**  
(El-Kehf: 29).

---

<sup>1</sup> Shih Ibni Mendhur, *Lisanul Arab*.

Ndërsa, si formë e përfundimit të dialogut dhe të diskutimeve me ata që nuk besojnë si ne, në Kur'an është shpallur:

**“Ju keni fenë tuaj e ne kemi fenë tonë!”** (El-Kafirun: 6).

Kurse ajeti 99 i sures Junus jep sugjerimin e rëndësishëm për ne, për të mos urrejtur e detyruar njerëzit në besimin që ne i përkasim:

**“Vallë, ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?!”** - që do të thotë se, sikur Zoti të donte, gjithë njerëzit në sipërfaqen e tokës do t'i bënte besimtarë, mirëpo një gjë të tillë Ai nuk e urdhëroi për *hikmetin* (urtësinë) që vetëm Ai e di.<sup>1</sup>

Është Zoti që e udhëzon kë do Ai, dhe e lë të pa udhëzuar atë që Ai do. Nuk është e drejta jote, o i Dërguar, që t'ia imponosh njerëzve besimin tënd!<sup>2</sup>

Në po të njëjtën sure, ajeti 108, si dhe në suren En-Neml, në lidhje me udhëzimin në rrugën e besimit, gjejmë porosinë tjetër me peshë të lartë kur'anore:

**“Kush udhëzohet në rrugën e drejtë ai është udhëzuar për dobinë e vet, dhe kush e humb rrugën e drejtë ka humbur në dëmin e vet, ndërsa unë nuk jam mbikëqyrësi juaj”.**

Kurse në suren Ez-Zumer, ajeti 14-15, lexojmë:

**“Thuaj: “Vetëm Zotin e adhuroj me besimin tim të plotë dhe të sigurtë, kurse ju adhuroni kë të doni në vend të Tij”.**

---

<sup>1</sup> Shih *Tefsiri i Xhelaljenit*.

<sup>2</sup> Ibid.

(Thuaj, o Muhammed): **“Tashmë ju kanë ardhur nga Zoti juaj prova të qarta. Ai që i sheh ato, i sjell dobi vetes, ndërsa ai që i mbyll sytë para tyre, i bënë dëm vetes. Unë nuk jam rojtari juaj”.**

**“Sikur të donte Zoti, ata nuk do të ishin idhujtarë. Ne nuk të kemi bërë rojtar të tyre e as nuk je përgjegjës për ta”.** (Ajetet 104 dhe 107)

Në lidhje me këtë mospërgjegjësi personale edhe të vetë Muhammedit a.s. karshi atyre që kthejnë kokën anash dhe nuk dëshirojnë të jenë dëgjues dhe përkushtues të fjalës së Zotit, në ajetin 80 të sures En-Nisa lexojmë:

**“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Zotit. Sa për ata që kthejnë kokën mënjanë, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre”.**

Në këtë plan kemi edhe ajetin 48 të sures Esh-Shura:

**“Nëse ata të kthejnë kurrizin, dije se Ne nuk të kemi dërguar ty (Muhammed), si roje për ta”.**

Pastaj:

**“...populli yt e quan gënjeshtër atë (Kur'anin), ndonëse ai është i vërtetë. Thuaj: “Unë nuk jam rojtari juaj”.** (El-En'am: 60)

**“Ne e dimë mirë se çfarë të thonë ata, por ti nuk do t'i detyrosh ata me dhunë (që të besojnë). Prandaj, këshillo me Kur'anin këdo që e ka frikë paralajmërimin Tim”.** (Kaf: 45)

**“Këshilloji njerëzit (o Muhammed), se ti je vetëm këshillues, dhe nuk je i ngarkuar t'i detyrosh ata me forcë”.** (El-Gashije: 21-22)

Nga domethënia e ajeteve të përmendura më sipër, shihet mjaft qartë se i dërguari i Zotit, Muhammedi a.s., detyrë mbi detyrat e tij ka pasur kumtimin e shpalljes, e jo imponimin apo rolin e rojtarit që të ruajë bindjet e brendshme shpirtërore të njerëzve. Detyrë dhe angazhim qenësor i Muhammedit a.s. ka qenë transmetimi i shpalljes, si dhe thirrja në besim të vërtetë në Krijuesin Një dhe të Vetëm. Këtë përfundim mund ta vërtetojmë edhe me shumë ajete të tjera të Kur'anit:

**1. “...kurse i Dërguari është i ngarkuar vetëm të përcjellë qartë Mesazhin Hyjnor”. (En-Nur: 54)**

**2. “Nëse ju nuk më besoni, dijeni se edhe popujt e mëparshëm i kanë quajtur gënjeshtarë të dërguarit e tyre, prandaj i Dërguari ka për detyrë vetëm të shpallë qartazi”. (El-Ankebut: 18)**

**3. “I dërguari ka për detyrë vetëm që t’ju kumtojë Shpalljen...” (El-Maide: 99)**

**4. “...nëse refuzojnë, detyra jote është vetëm të përcjellësh (mesazhin), e Allahu i vrojton robërit e vet”. (Ali Imran: 20)**

**5. “...për të dërguarit s’ka tjetër detyrë veçse të shpallin qartë”. (En-Nahl: 35)**

**6. “Dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit (Muhammedit a.s.)! Kujdes, nëse nuk ia vini veshin, ta dini se i Dërguari ka për detyrë vetëm të përçojë Shpalljen e qartë”. (El-Maide: 92)**

**7. “Ti je vetëm paralajmërues”. (Fatir: 23)**

**8. “Unë jam vetëm paralajmërues dhe sjellës i lajmeve të mira për njerëzit që besojnë”. (El-Ea’raf).**

**9. “Thuaj (o Muhammed a.s.): “O njerëz, unë jam për ju vetëm një paralajmërues i hapur”. (El-Haxh: 49)**

Ajetet e sipërpërmendura janë argumenti më i qartë se Muhammedi a.s. si detyrë të tij parësore kishte informimin e njerëzve për mesazhin hyjnor, shpalljen e Librit të Zotit, Kur’anin dhe shpjegimin e tij për ata që duan ta mësojnë e dëgjojnë porosinë e tij.

Përveç kësaj, Muhammedi a.s., kishte detyrë që të jetë po ashtu shembull në raport me njerëzit, që, edhe pas vdekjes modeli i tij i shkëlqyer të kumbojë ngjashëm si thirrja që ai bëri për besim në Një Zot sa ishte gjallë. Në këtë kontekst, në Kur’an lexojmë:

**1. “Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur. Dhe diskuto me ta në mënyrën më të mirë”. (En-Nahl: 125)**

**2. “Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm në mënyrën më të mirë”. (El-Ankebut: 46)**

**3. “Të keqen ktheje me të mirë...” (El-Mu’minun: 96 & Fus-silet: 34)**

**4. “Thuaju: “Ju nuk do të pyeteni për atë që kemi gabuar ne, as ne nuk do të përgjigjemi për atë që bëni ju”. (Es-Sebe’e: 25)**

**5. “I dërguari thotë: “O Zoti im, ky është një popull që nuk beson! Largohu prej tyre (o Muhammed) dhe thuaju: “Paqe!” Ata së shpejti do ta dinë”. (Ez-Zuhruf: 89)**

Llogaria për veprat tona në Ditën e Gjykimit është në dorën e Zotit dhe në fuqinë e Tij absolute. Në lidhje me këtë, Kur'ani thotë:

**1. “Vërtet, si ata që kanë besuar, ashtu edhe çifutët, sabi’inët, të krishterët, mexhusitë e idhujtarët, Allahu do t’i gjykojë drejt të gjithë në Ditën e Kiametit. Nuk ka dyshim se Allahu është dëshmitar për çdo gjë”. (El-Haxh: 17)**

**2. “Me të vërtetë, Zoti yt do të gjykojë midis tyre në Ditën e Kiametit, për çështjet në të cilat kishin mosmarrëveshje”. (Es-Sexhde: 25)**

**3. “Pastaj, të gjithë do të kthehen tek Unë dhe Unë do të gjykoj mes jush për çështjet që jeni grindur”. (Ali Imran: 55)**

**4. “Ne ta kemi zbritur ty Librin, vetëm që ti t’ia sqarosh atyre çështjet për të cilat ata nuk pajtoheshin”. (En-Nahl: 64)**

**5. “...detyra jote është që të kumtosh shpalljen, se llogaria është tek Ne”. (Er-Rad: 40)**

**6. “...tek Allahu është puna e tyre, e pastaj Ai do t’u tregojë se çfarë punuan”. (El-En’aam: 159)**

Nga ajetet e sipërcituara, ne paralajmërohem se në emër të fesë askush nuk guxon të ushtrojë dhunë, e as të detyrojë dikë që të besojë nën presion. As vetë Muhammedi a.s., i cili ishte edhe i dërguari i Zotit të Madhëruar, nuk e kishte të drejtën dhe mundësinë e mbizotërimit të zemrave të njerëzve, dhe as të imponimit të asaj që ai predikonte. Është e drejtë individuale e çdonjërit të besojë apo të mos besojë, të jetë i bindur ndaj

Zotit apo të jetë mohues. Kjo është e bazuar edhe në thëniet autentike të Muhammedit a.s.<sup>1</sup>.

Detyrë e çdo besimtarit të fesë islame është që të pranojë dhe t'i besojë edhe shpalljet e mëhershme qiellore, përkatësisht librat e mëhershëm hyjnorë, të cilat janë emëruar me emra si; Tevrati (Tora), Zeburi dhe Inxhili (Dhiata e vjetër dhe Dhiata e Re).

Ndryshe, besimi në pejgamberët e mëhershëm dhe në librat e tyre të shpallur është edhe njëri nga themelet bazë mbi të cilat ngritet vetë feja islame. Në gjithë literaturën e studimeve islame, të shkruar gjatë gjithë historisë deri më sot, asnjëherë nuk mund të gjendet fjala më e vogël fyese ndaj pejgamberëve të mëhershëm.

Në këtë kontekst, mund të përmenden disa ajete të librit tonë të shenjtë me të cilat vlerësohen dhe çmohen pejgamberët para Muhammedit a.s.:

**1. “Besimtarë të Zotit janë ata të cilët besojnë në atë që të shpallet ty (o Muhammed) dhe në**

---

<sup>1</sup> Historia asnjëherë nuk ka shënuar ndonjë rast kur Pejgamberi a.s., ose shokët e tij kanë përdorur dhunë ose shtrëngim ndaj njerëzve për të pranuar fenë islame jashtë vullnetit të tyre.

Islami nuk është identifikuar dhe nuk mund të identifikohet në bazë të një mendimi të ndonjë individi ose grupi të degëzuar nga trangu amë. Shumë gazetarë dhe publicistë, në media të ndryshme me ndikim global së fundi paraqesin vetëm skenat më të vrazhda të individëve dhe grupeve, që në veprimet e tyre çnjerëzore thirren në emër të Islamit, që në fakt ata nuk kanë të bëjnë asgjë me faktin dhe të vërtetën e tij.

**atë që është shpallur para teje** (Tevrati, Zeburi dhe Inxhili)". (El-Bekare: 4)

**2. "Thuaj: Ne besojmë në Zotin dhe në atë që na është shpallur neve, dhe në atë që i është shpallur Ibrahimit (Abrahamit), Ismailit (Ishmaelit), Is-hakut (Isaakut) dhe fiseve të tyre, (besojmë) në atë që i është dhënë Musait (Mojsiut) dhe Isaut (Jezusit), (besojmë) në gjithë atë që i është dhënë peygamberëve të Zotit. Ne nuk bëjmë dallim mes tyre dhe vetëm Zotit Një i përulemi".** (El-Bekare: 136)

Kur'ani, në të gjithë tekstin e tij të brendshëm nuk bën asnjë dallim në mes të profetëve të Zotit duke filluar prej Ademit, nëpërmjet Ibrahimit e Musait, e deri te Muhammedi a.s. Ndërsa për Isain a.s. (Jezusin), të birin e Merjemes, vërtetuesin e Tevratit, në Kur'an lexojmë edhe citatin në vijim:

**"Ne vazhduam gjurmët e tyre (të peygamberëve) me Isain, birin e Merjemes. Atij i dhamë Inxhilin, që është udhëzim i drejtë dhe dritë, që është vërtetues i Tevratit që kishin pranë, që ishte udhëzues e këshillues për të devotshmit".** (El-Maide: 46-47)

Nga kjo përmbledhje e shkurtër e ajeteve kur'anore, demantohen të gjitha tezat e atyre që pretendojnë dhe gjykojnë se Islami është fe e dhunës dhe e imponimit. Një cilësim i tillë i Islamit vjen vetëm nga ata që nuk e kanë lexuar e studiuar mirë Kur'anin, ose nga të tjerët që nuk e kanë kuptuar ose nuk duan t'a kuptojnë atë në

mënyrë të drejtë, profesionale dhe shkencore, apo edhe nga grupi tjetër i cili qëllimisht i jep atij një drejtim të gabuar dhe devijues.

## **Toleranca dhe dialogu ndërnjerëzor dhe ndërfaqet në këndvështrimin islam**

Ndjenja për besim në një fuqi absolute të quajtur Zot, ka qenë pjesë shpirtërore e njeriut që nga momentet e para të daljes së tij mbi sipërfaqen e tokës, gjë e cila është vërtetuar edhe nga shumë etnologë dhe historianë, eksplorues të së kaluarës njerëzore mbi sipërfaqen e tokës. Kjo ndjenjë do të vazhdojë të jetë aktive edhe në të ardhmen tek krijesa njeri. Hulumtimet e bëra deri më sot nuk kanë treguar se ka pasur njerëz që nuk kanë besuar shpirtërisht në një fuqi absolute, të cilën varësisht, sipas shkallës së pranimi të tyre, e kanë emërtuar me emër të veçantë. Edhe sot hasim fise e popuj që besojnë në fenomene të ndryshme natyrore; diell, hënë, shi, yje, planete të tjera qiellore si Jupiter, Venus etj., pastaj në lumenj, pemë, erëra e të tjera fenomene, të cilat ata i klasifikonin si zot të së mirës dhe zot të së keqes.

Në librat hyjnorë, krijesa njeri ka qenë fokus i tyre i veçantë, përmes të cilave ai është ftuar që të jetë në shkallën e duhur të dëgjimit dhe zbatimit të porosive të Zotit, në mënyrë që përmes praktikimit të tyre të jetojë në dashuri, mirëqenie, në paqe dhe liri me vetveten, familjen, rrethin dhe shoqërinë njerëzore në përgjithësi.

Ndryshe, toleranca dhe barazia mes njerëzve janë edhe fryt i njohjes hyjnore në formën e saj të dëlirë. Përmes mësimëve qiellore, siç është

Kur'ani në të cilin njihemi si muslimanë, njeriu arrin të kuptojë vetveten dhe rolin e tij në shoqëri dhe, si rrjedhojë e kësaj të zhvillojë edhe marrëdhënie të shëndosha njerëzore të bazuara në tolerancë dhe barazi.

Larmia, ndryshueshmëria dhe llojllojshmëria e njerëzve në planetin tonë, si ajo etnike, racore dhe gjuhësore është akt i qëllimshëm i Zotit që në ezel/ (në zanafillën e parë të krijimit të njeriut), për njohjen dhe afrimin e tij me të tjerët, e jo për të treguar ose shprehur urrejtje ndaj njëri-tjetrit. Këtë diversitet të qenies njerëzore mbi sipërfaqen e tokës Kur'ani e potencon tekstualisht, si në vijim:

**“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise, që të njiheni ndërmjet vete. Më i ndershmi ndër ju është ai i cili ia ka më së shumti frikën Zotit. Zoti është i gjithëdijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”. (El-Huxhurat: 13)**

Në bazë të këtij ajeti kur'anor shihet dhe kuptohet se gjeneza njerëzore ka një burim dhe një Krijues të Vetëm, kurse ndarja në fise, popuj apo etnitete të ndryshëm është zgjedhje e Zotit, prandaj si e tillë ajo duhet pranuar dhe duhet respektuar.

## **Zhvillimi i marrëdhënieve shoqërore dhe bashkëjetesa me pjesëtarë të besimeve të tjera**

*“Drejtësia mban qiellin dhe tokën” - thoshte Muhammedi a.s..*

Si në të kaluarën, ashtu edhe në ditët e sotme ka zëra të pamatur dhe hipotetike, të cilët thërrasin për të bojkotuar bashkëpunimin dhe shoqërimin me pjesëtarët e besimeve të tjera. Në mësimet burimore dhe autentike islame nuk ka barrierë e cila pengon shoqërimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore me pjesëtarë të feve monoteiste.

Përderisa Islami lejon martesën me pjesëtare të besimit tjetër monoteist, atëherë si do të mund të thoshte dikush se ai e ndalon shoqërimin me ta, kur dihet se martesa është lidhja më e fortë dhe më e afërt mes dy individëve.<sup>1</sup>

I Dërguari i Zotit, Muhammedi a.s., sipas të dhënave historike kishte një grua të fesë hebraike me emrin Xhujejra bint el-Harith el-Mustalakije,

---

<sup>1</sup> Islami është integruar e jo diferencues. Gjithçka që Islami si fe synon të arrijë tek individ, është ndërtimi i karakterit që pranon bashkëjetesën dhe miqësinë në paqe me të tjerët. Në fakt, ky parim është i mbështetur edhe nga filozofët e hershëm. Për shembull, Aristoteli, në lidhje me socializimin e individit shprehet se, çdo individ që nuk pranon jetën në shoqëri, dhe pranon të kundërtën, atë në vetmi, duhet të jetë i vetëdijshëm se është ose bishë ose Perëndi, ngase, janë bishat ato që vrasin gjithë ç’kanë afër, si dhe Zoti është i vetëm që s’pranon rival. Në këtë nivel mund të rendisim edhe bashkëjetesën mes besimtarëve të feve të ndryshme.

si dhe një të fesë së krishterë me emrin Maria el-Kibtije.

Ndërsa nga historia islame ka po ashtu shumë shembuj të rëndësishëm mbi respektimin e njeriut - si krijesë e Zotit fillimisht dhe jo si pjesëtar i një besimi të caktuar. Në një rast, Muhammedi a.s., përderisa ishte ulur me shokë, pranë tij kaloi një grup njerëzish të cilët mbi supet e tyre po mbanin një njeri të vdekur, pjesëtar i komunitetit hebre. Në shenjë respekti, Muhammedi a.s. u ngrit në këmbë duke qëndruar në heshtje gjersa kaloi kortezhi. Një nga të pranishmit iu drejtua Muhammedit a.s. me fjalët: *“O i dërguar i Zotit, pse u ngrite në këmbë? A nuk e more vesh se i vdekuri ishte çifut?!”* Muhammedi a.s. u kundërpërgjigj: *“A nuk ishte ai një njeri - krijesë e Zotit, siç jemi edhe ne?!”*

Gjithashtu, është i njohur edhe rasti tjetër shumë domethënës dhe fisnik i Pejgamberit a.s., karshi pjesëtarëve të besimit të krishterë, të cilët kishin ardhur për vizitë në Medinë, nga Habeshi - Etiopia e sotme, me qëllim që të kuvendojnë me të. Pas një qëndrimi disa ditësh në Medinë, pjesëtarët e krishterë i kishin shtruar Muhammedit a.s. kërkesën që t'u sigurohet një vend për lutje fetare sipas besimit të cilit i takonin. Në mungesë të ndonjë hapësire të përshtatshme, Muhammedi a.s., u kishte ofruar hapësirën e xhamisë<sup>1</sup> së tij.

---

<sup>1</sup> Shih librin: “Es-Siretu en-Nebevijeh” nga autori i mirënjohur Ibni Hisham, vdiq në vitin 218 H / 833 M.

Në këtë kontekst, nuk mund të anashkalohet e të mos përmendet po ashtu edhe dokumenti i Medinës, i njohur si **Karta e Medinës**, të cilën e kishte hartuar Muhammedi a.s. me shokët e tij, e cila luante rolin e kushtetutës së shtetit në atë kohë. Përmes tij siguroheshin plotësisht të drejtat e jomuslimanëve që ishin banorë të Medinës. Nenet e Kartës ishin zgjeruar edhe ndër fiset hebreje dhe te fiset e tjera që banonin në Medinë. Fiset çifute, në nenin 29-30, ishin bërë pjesë e Ummetit (Bashkësisë muslimane), në të cilën ata gëzonin të drejtën që, të shprehin lirshëm bindjet e tyre fetare si dhe të merrnin pjesë në luftë përkrah muslimanëve për të mbrojtur qytetin nga politeistët<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Neni 17 i Kartës së Medinës thotë: “Është detyrë e të gjithë muslimanëve të ndihmojnë dhe t’u ofrojnë sjellje miqësore çifutëve, të cilët kanë hyrë në marrëveshje. Asnjë shtrëngim i çfarëdo lloji qoftë nuk duhet ushtruar mbi ta dhe nuk duhen ndihmuar armiqtë e tyre kundër tyre.”

## **Çështje të përbashkëta mes pjesëtarëve të feve monoteiste**

Në këtë nëntitull nuk mund të renditet asgjë më e vlefshme sesa fjala e Kur'anit:

**“O ithtarë të Librit, ejani të bashkohemi rreth gjërave të përbashkëta edhe për ju, edhe për ne: të adhurojmë vetëm Zotin e mos t'i bëjmë asnjë shok Atij dhe mos ta marrim njëri-tjetrin si Zot, në vend të Zotit”. (Ali Imran: 64)**

Islami e sheh të rëndësishëm zhvillimin e dialogut me ithtarët e librave qiellorë të mëhershëm siç u përmend edhe më herët, për faktin e pranisë së gjërave të përbashkëta, qoftë në sferën e besimit, apo të kuptimit dhe zhvillimit të jetës në përgjithësi. Dallimet të cilat kanë mbetur të trashëguar nga e kaluara, janë më tepër rezultat i moskuptimit të ndërsjellë sesa realitet. Kur i krahasojmë mësimet hebraike, të krishtera dhe islame, zbulojmë gjëra të përbashkëta, të cilat mund t'i quajmë “E mirë e përbashkët” e tri feve monoteiste. Nga këto të mira të përbashkëta mund të veçohen:

1. Besimi në monoteizëm;
2. Besimi në shpalljen nga Zoti i Madhëruar;
3. Tradita e hershme e profetëve (të dërguarve);
4. Besimi në Ditën e Gjykimit;
5. Jeta në varreza;
6. Lutjet drejtuar Zotit;
7. Thirrjet për bamirësi, mëshirë dhe falje;
8. Organizimi dhe respektimi i jetës familjare;

9. Shpresa për shpëtimin e shpirtit duke bërë vepra të mira;

10. Ndëshkimi për mëkatin dhe shpërblimi për veprën e mirë (Parajsa dhe Ferri).

Këto janë disa elemente të përbashkëta të tri feve qiellore, përmbledhur në vija të trasha.

Do të ishte e rrugës që të gjithë pa dallim, duke filluar nga liderët e botës së sotme moderne, intelektualët kudo qofshin, që të japin kontributin e tyre pozitiv në ruajtjen e qetësisë dhe respektimit ndërfaqetor mes njerëzve pa dallim. Si krijesë e vetme me përgjegjësi, mbi sipërfaqen e tokës, siç është njeriu, ai gjithëherë duhet të jetë në nivel të duhur dhe në shërbim të së mirës së përgjithshme njerëzore. Përndryshe, ky është ideali më i çmuar edhe nga ana e mësimave të Zotit.

Ftesa për njohje, dialog dhe bashkëpunim është detyrë e përbashkët e gjinisë njerëzore. Dialogu me të tjerët nuk është vetëm një hap i dëshiruar, por i detyrueshëm për kohën në të cilën jetojmë dhe për gjetjen e rrugëzgjdhjes më të dobishme, siç porosisin edhe këshillat hyjnore të librit tonë, **“bashkëpunoni dhe këshillohuni mes vete në të mirë dhe në devotshmëri”!**

Synime dhe ide humane e fisnike janë vetëm ato që si qëllim final kanë mirëqenien dhe lumturinë e përbashkët të të gjithë njerëzve, pa dallim race, kombësie e feje, sepse këto ndryshe janë dallime të lindura bashkë me njeriun dhe në

to nuk ka asgjë të keqe. Të jesh ndryshe nga të tjerët, nuk është e metë, gjynah e as krim, dhe askush nga ne nuk është përgjegjës për këtë. Urrejtja, e cila buron nga dallimet e tilla është njëra nga fatkeqësitë më të mëdha të njerëzimit në histori, prej nga lindi racizmi, nazizmi, shovinizmi etj.

Në këtë kontekst vlen të shkëputet një pjesë e fjalimit historik të Muhammedit a.s., në Haxhin e Lamtumirës:

*“Të gjithë jeni pasardhësit e Ademit, ndërsa Ademi është prej elementeve të dheut. Nuk është i pranueshëm asnjë dallim mes jush. Nuk ka përparësi arabi ndaj joarabit, as joarabi ndaj arabit! I bardhi nuk është më i mirë se i ziu, as i ziu më i mirë se i bardhi. E vetmja gjë e rëndësishme është devotshmëria personale”.*

Në pikëpamjet dhe porositë islame nuk mund të gjesh asnjë element i cili e shtynë ose e nxit njeriun që të urrejë të tjerët në emër të fesë, racës apo etnitetit. Historia e dominimit të muslimanëve në botë është e njohur për bashkëjetesën, respektin dhe mbrojtjen shtetërore ndaj pjesëtarëve të besimeve të tjera.

Thirrja për të mos u shoqëruar ose për të urrejtur në kushte paqeje, të gjithë ata të cilët nuk besojnë si ne, është thirrje kundër porosisë së Zotit dhe mësimave islame në përgjithësi.

## **Feja dhe përgjegjësia e bartësve të saj në shoqërinë tonë**

Besimi fetar është e drejtë personale e çdo njeriu, e garantuar nga Zoti, e njëkohësisht e mbrojtur edhe sot me ligjet dhe konventat bashkëkohore për të drejtat e njeriut.

Pjesëtarët e kombit tonë, siç edhe dihet, shumica e tyre i takojnë besimit islam, fe të cilën e përqaftuan me shumicë në fillim të shekullit 17 dhe më herët. Shkolla dominuese e Islamit tek ne është sun-nite si dhe ajo sufiste (mistike). Gjatë kultivimit të mësimave fetare në trojet tona, në përgjithësi ka pasur batica dhe zbatica, të cilat shpeshherë kanë përcaktuar dhe rrethanat e caktuara gjeopolitike dhe gjeostrategjike, dhe forcat mbizotëruese të kohës.

Kombi ynë është krenuar dhe ende vazhdon të krenohet për tolerancën dhe respektin e ndërsjellë ndër fetar mes qytetarëve të vet. Ky element i rëndësishëm, i cili buron nga thellësitë e shekujve, është konsideruar si alfa dhe omega për mbijetesën e kombit tonë dhe shpëtues nga kthetrat e shumë armiqve tanë shekullor - një trazim rruge që duhet të vazhdojë së ndjekuri edhe në të ardhmen, sepse bashkëjtesa, respekti si dhe toleranca fetare ndërshtypare janë shtylla nga më qenësoret pa të cilat kombi ynë nuk do të mund të ketë mirëqenie e as ekzistencë unike. E udhës do të ishte të shikohen ngjashmëritë si vlerë e përbashkët që duhet investuar për

kultivimin e tyre, e jo dallimet që nxisin në decentralizim ose ikje nga qendra jonë e përbashkët, siç është etnia.

Përgjegjësia për ruajtjen e kësaj vlere kombëtare, në rend të parë bie mbi prijësit fetarë të të gjitha komuniteteve, pa dallim, por edhe mbi institucionin shtetëror. Është me rëndësi të veçantë që çdo prijës i fesë në trojet tona, të jetë i kujdesshëm në misionin e tij shpirtëror, sepse fjala e tij mbart mbi vete peshën dhe përgjegjësinë publike. Prandaj, matura në dhënien dhe shpalosjen e vlerave fetare duhet të jetë në funksion dhe e aktivizuar në mënyrë permanente. Një fjalë e urtë e literaturës së hershme islame thotë: *“Një gjë edhe pse e ditur, nuk citohet gjithmonë - vakt e pa vakt”!*

Për të qenë në rrugën e Zotit dhe jo në dëm të dikujt, organizimi fetar në mesin e shqiptarëve duhet të jetë nga bijtë tanë autoktonë, i kultivuar dhe i organizuar nga vetë ne, e jo i shtyrë nga ideologët dhe tutorët e huaj. Si kurrë më parë, në mesin e shqiptarëve sot ka studiues të mjaftueshëm të fesë dhe të filozofisë së saj, të cilët janë të aftë për të kryer misionin e tyre me nder dhe profesionalizëm, pa pasur nevojë për shtytës ose mësues të jashtëm. Si shoqëri e hapur dhe demokratike, ne nuk mund të jemi të izoluar nga bota dhe nga ndryshimet globale që po përjeton ajo, por as edhe nga idetë dhe ideologjitë e reja të cilat sot janë të prekshme dhe të afërta përmes internetit, si kurrë më parë. Mirëpo, ajo që ne

mund të bëjmë, është që të tregohemi të kujdesshëm në pranimin dhe mospranimin e asaj që është në dëmin tonë, e cila jo rrallë na servohet nën petkun e fesë, pas së cilës fshihet prapavijë dhe prirje që dëmton unitetin tonë të përgjithshëm fetar - afatshkurtër dhe afatgjatë. Kjo zakonisht ndodh në shoqëritë në tranzicion, sikundër është edhe kjo e jona tash, pas rënies së sistemit komunist dhe atij serbo-sllav.

Ne duhet të jemi syçelë ashtu siç është edhe bleta, e cila kalon qindra e mijëra lule, mirëpo thith vetëm nektarin e pastër të tyre. Frymat dhe rrymat jo tolerante, të cilat po zhvillohen në botë, në emër të fesë, e në dekadat e fundit edhe tek ne, nuk janë në interes të fesë së Zotit e as në interes të asnjë populli a kombi. Kujdesi ndaj çdo elementi të tillë duhet të jetë në maksimum. Liria fetare nuk nënkupton edhe keqpërdorimin e saj për të realizuar interesa jo të fesë, si dhe për të krijuar huti e turbullira në mesin e besimtarëve në emër të bajraktarizmit dhe liderizmit.

Shqiptarët dhe prijësit shpirtërorë të tyre, pa dallim, tradicionalisht i kanë pasur vijat e qarta të pasimit dhe të kultivimit të fesë. Gjuha e urrejtjes, e anatemimit, e përçarjes dhe ndarjes, nuk ka qenë dhe nuk është as sot në interes të asnjë komuniteti fetar, përkatësisht të ndjekësve të saj, por as në interesin e përgjithshëm dhe të gjithmbarshëm njerëzor. Feja dhe bindjet e askujt nuk bënë të fyhen, sepse fyerja nuk është edukatë dhe parim i besimtarit të devotshëm e aq më pak

e një prijësi të çiltër. Sa herë që feja kalon në fyerje, detyrim, dhunë, ajo nuk është fe, por plotësim interesash ideologjike, politike e personale. Identiteti fetar tek individit është bindja e tij në fe, deri aty ku ai nuk është i dhunshëm ndaj të tjerëve, sepse, po qe i tillë, ai kalon në diçka që s'është fe por ideologji dogmatike, gjë të cilën feja kurrë nuk e ka pasur në tërësinë e saj. Feja është e gjallë, jeton si në individin, në praktikën e tij fetare, ashtu edhe në shoqëri, pra në mirëqenien e tyre të përbashkët. Prandaj njerëzit nuk ofrohen duke i fyer e nënçmuar, por duke i dashur, respektuar dhe vlerësuar.

**“Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos Zotit, e (si hakmarrje) të fyejnë Zotin nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij)...”** (Kur'an 6: 108)

Ftesa dhe thirrja e cila i bëhet dikujt në emër të fesë, duhet të jetë e mbështetur mbi forcën e arsyes dhe argumentit, ndërsa polemika, dialogu dhe diskutimi, me të gjithë ata të cilët i takojnë bindjeve të tjera fetare, duhet të jetë në shkallën më të lartë të mirësjelljes, tolerancës dhe respektit, në përputhje me porosinë e librit hyjnor Kur'anit:

**“Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) në atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit”.** (Kur'an: 16: 125)

Prijësit fetarë muslimanë, si shumicë që janë në mesin e kombit tonë, sot e kurrë nuk duhet të fusin pyka ndarëse në komunitetin e tyre fetar në emër të fesë, e as ndaj të tjerëve, duke marrë për model ideologë të jashtëm, të vendeve që nuk i njohin rrethanat dhe kontekstin shoqëror dhe hapësinor të vendit dhe shoqërisë sonë. Të njëjtën gjë nuk duhet ta bëjnë as prijësit fetarë të komuniteteve të tjera fetare shqiptare.

Ajo që duket më së shumti brengosëse tek shumë prijës të sotëm fetarë, në të gjitha anët ku banojnë shqiptarët pa ndarje të kufijve, është një zëvendësim i argumentimit rrënjësor dhe fundamental me atë sipërfaqësor dhe dytësor gjatë ligjërimit dhe adresimit, para masës së besimtarëve dhe opinionit të gjerë.

Në këtë plan, vitet e fundit, në emër të Islamit, qindra faqe interneti (website) e adresa facebook janë krijuar nga njerëz të ndryshëm, “për punë” në emër të fesë. Asnjëri nuk është i koordinuar me tjetrin. Çdonjëri vendos dhe shpërndan ide e mendime në emër të fesë, pa asnjë recensim dhe redaktim profesional, thuajse nuk kemi të bëjmë me të njëjtën fe islame. Kështu, duke qenë krejtësisht pa fre interpretimi i fesë në vend, ajo po degradohet dhe keqinterpretohet më tepër se asnjëherë më parë. Prandaj, jo rastësisht, edhe si epilog i tyre shihet se dëmi është dukshëm më i madh se sa dobia. Kjo për arsye se veprimi i tillë i çakorduar, për të cilën kanë dhënë mund e pretenduar themeluesit e tyre, zakonisht jo

studiues e teologë të shkolluar, ishte një veprim që më shumë nxiti dallime dhe ndarje se sa bashkim, më shumë polemika të panevojshme se sa përfundime të dobishme për bashkësinë, dhe sigurisht për një varg arsyesh të tjera. Kjo formë ka bërë që hutia dhe paqartësitë rreth fesë në masë jo vetëm të largohen e të zvogëlohen por, përkundrazi, të rriten e të shtohen edhe më shumë.

Kësaj paqartësie i kanë ndihmuar edhe shumë individë “intelektualë”, të cilët nuk e kanë pasur dhe nuk e kanë fenë studim parësor dhe, të cilët janë lëshuar në shpjegimin e fesë për të përfituar materialisht. Kjo është e ngjashme sikurse dikush nga mesi i prijësve fetarë të shpjegojë mbi inxhinierinë e ndërtimtarisë ose arkitekturës, apo ndonjë lëmi tjetër - pa i studiuar ato mirë paraprakisht! Prindërit dhe gjyshërit tanë thoshin: *“Kur dini (feja) bëhet dinar ajo më nuk është fe”*, që do të thotë se kur feja kultivohet, zhvillohet në emër të interesit material, ajo më nuk është fe e zemrës dhe e shpirtit, por është fe e interesit individual ose politik, e devijuar nga binarët dhe themelet bazë të saj.

“Ju pyetni, ndërsa X personi ju përgjigjet”, është motoja e facebook-ut të disa prijësve fetarë në kohët e fundit tek ne. Përdoret edhe motoja tjetër: *“Të përfitojmë nga i nderuar X prijës”*. Në shikim të parë kjo tingëllon bukur, sepse, në fund të fundit, sot çdokush është i lirë të flasë pavarësisht nga të tjerët. Mirëpo, jo edhe çdokush

është i aftë dhe kompetent të gjykojë në emër të çështjeve dhe tematikave madhore islame, i pavarur dhe pa leje, ose pa miratime paraprake të një komisioni të lartë fetar kompetent.

Të tilla adresa në gjuhën shqipe së fundmi janë shumëfishuar në mënyrë drastike. Asnjëri prej tyre nuk ka unifikim të mendimeve dhe qëndrimeve me tjetrën. Gjithsecili pretendon se di më shumë se tjetri, duke bërë edhe gara për më shumë like (pëlqime) në faqen e facebook-ut të tij!

Si rezultat i kësaj dukurie të lehtësuar përmes kibernetikës së sotme, me kompetencë shkencore mund të konkludohet se autorët e tillë të këtyre faqeve islame, me përjashtime të rralla, më shumë e kanë dëmtuar dhe po e dëmtojnë imazhin e vërtetë dhe real të fesë, se sa që po e ndihmojnë atë. Ata, me ose pa vetëdije, janë duke e dobësuar trungun e përgjithshëm të komunitetit fetar musliman, sepse me “fetvatë” (dekretet fetare) e tyre ditore kontradiktore nga njëri-tjetri, po copëtojnë dhe po e dëmtojnë harmoninë e përgjithshme në mesin e besimtarëve muslimanë në rend të parë, por edhe të tjerëve<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Enciklopedisti i studimeve islame, i njohur me nofkën Madhështori i Fesë - Xhelalud-din es-Sujutiu, i cili kishte jetuar në shekullin 14, e për të cilin thuhet se ka shkruar mbi 600 vepra në fushën e shkencave islame në përgjithësi, megjithatë nuk ishte lëshuar në fetva individuale, përderisa mësuesit dhe dijetarët e kohës së tij nuk i kishin dhënë leje për një veprim të tillë. Kjo jep të kuptohet se, sado që dikush nga mesi ynë mund të ketë njohuri fetare, ai paraprakisht duhet të marrë pëlqimin e një forumi më të

Në mungesë të organizimit të seminareve, konferencave dhe takimeve të tjera shkencore dhe edukative të rregullta nga ana e qeverisë dhe komuniteteve fetare, për të vetëdijesuar dhe edukuar kuadrot e tyre, është krijuar hapësirë ndaj çdonjërit si prijës shpirtëror, që në mënyrë vetjake dhe të pavarur t'i qaset fesë dhe kultivimit të saj duke mos i dhënë përgjegjësi askujt për punën dhe aktivitetin e tij me besimtarët dhe publikun.

Kjo neglizhencë e institucionit fetar zyrtar në vend ka hapur derën e bisedave dhe debateve, shpeshherë edhe të nxehta, qoftë në rrugë, në institucione e në takime private, si dhe kudo tjetër. Pyetjet që më së shumti përsëriten në mesin e qytetarëve në emër të fesë janë: “Kush e ka thënë këtë mendim fetar?”, “Cili është ai, apo ky prijës fetar?”, “Sa është e vërtetë thënia e tij ose e tyre?”, “Ku është bazuar ai dhe kush qëndron pas tij?”, etj., që përgjithësisht janë vetëm disa nga pyetjet në kuadër të gjithë vërshimit të vrullshëm të mendimeve të ndryshme e laramane që po ndodhin sot në mesin tonë, në emër të fesë.

---

gjerë të dijetarëve muslimanë, për të dhënë e lëshuar fetva (dekrete dhe vendime fetare) me peshë në opinion, si i pavarur nga të tjerët. Tek ne, në mungesë të një koordimi zyrtar, është bërë përditshmëri të dëgjojmë fetva kontradiktore të prijësve fetarë muslimanë. Ky moskoordinim, ditë e përditë po shkakton turbullira dhe paqartësi në mesin e besimtarëve tanë dhe shoqërisë në përgjithësi.

Ky mosunifikim i qëndrimeve fetare është në kundërshtim me porosinë e Zotit: ***“Dhe respektojeni All-Ilahun e të dërguarin e Tij, e mos u përçani mes vete, e të dobësoheni dhe ta humbni fuqinë”***. (Kur`an 8:46)

Në Ditën e Gjykimit, nuk do të pyetemi sa kemi qenë dhe pse kemi qenë dëgjues ose nënshtrues të mendimeve të ndonjë prijësi të caktuar të sotëm fetar<sup>1</sup>, ose të një autori të caktuar të ndonjë doktrine ose ideologjie fetare, por, para së gjithash, atje do të pyetemi sa kemi qenë nënshtrues dhe përkushtues të devotshëm e të vërtetë të fjalës së Zotit (Tekij). Sa kemi qenë të besës e të fjalës? Sa kemi qenë bashkëpunues me njëri-tjetrin? Sa kemi qenë të drejtë dhe të kujdesshëm në moscenimin e pasurisë, nderit dhe moralit të tjetrit? Si i kemi trajtuar jetimët, të varfërit dhe të mjerët? Si jemi sjellë me prindërit tanë, me fqinjët tanë? Sa kemi qenë të drejtë në gjykimin e tjetrit? Pse kemi bërë padrejtësi, nëse kemi bërë ndonjëherë ndaj të pafuqishmëve dhe atyre të pa krah? Pse e kemi përvetësuar pasurinë e tjetrit padrejtësisht? Pse nuk jemi treguar të mëshirshëm e të përshpirtshëm ndaj qenies njeri pa dallim? Sa kemi qenë të moralshëm dhe të virtytshëm? Sa kemi punuar për bashkimin dhe

---

<sup>1</sup> Kjo nuk nënkupton se ne nuk duhet të kemi prijës të fesë, sepse kjo edhe nuk bëhet, mirëpo prijësi fetar duhet të pasohet vetëm deri në momentin kur ai nuk del nga kornizat e mirëfillta autentike të mësimave fetare si dhe të etikës morale dhe humane.

vëllazërimin e njerëzve? Sa jemi kujdesur për lirinë, sigurinë dhe mirëqenien e tjetrit? Pse kemi mbytur e vrrarë njerëz të pafajshëm? Pse kemi krijuar huti, turbullira e përçarje... etj., etj., janë këto vetëm disa nga pyetjet më të rëndësishme që do të mund të na bëhen, për dallim nga rëndësia që ka përcaktueshmëria në ndonjë prijës fetar.

Besimi gojor dhe teorik, jo i ngulitur drejtë në shpirt, i zhveshur nga normat e etikës morale dhe humane, është besim gjysmak dhe i rrejshëm. Shpirti që e ka frikën e vërtetë në Zotin nuk mund të jetë prijatar i të keqes, i përçarjeve, nxitës dhe vrasës i njerëzve të pafajshëm dhe të pafuqishëm. Fjala hyjnore i drejtohet arsyes dhe logjikës së shëndoshë të njeriut, prandaj çdo veprim jo i arsyeshëm dhe jo human është në kundërshtim me Zotin, por edhe me mësimet e mirëfillta që dalin nga libri hyjnor.

Si përfundim i gjithë asaj që u tha më lartë, vlen të përmenden dy nga thëniet e Muhammedit a.s.:

1. “Vërtetë feja është e lehtë, dhe kushdo që mundohet t’a shtrëngojë (komplikojë) atë, do të jetë i humbur! Renditni radhët, afrohuni mes vete, përgëzojeni njëri-tjetrin (me fjalë të mira e të buta)”.

2. “Të shkatërruar janë ata të cilët e teprojnë me shtrëngime (në çështje të fesë dhe të dunjasë, pra që janë teprues në lejime dhe ndalime).

Përgjegjësia për t’u prirë drejtë dhe mirë vlerave fetare në shoqërinë tonë, sipas renditjes,

fillimisht bie tek ne muslimanët, duke qenë se jemi komuniteti shumicë në mesin e shqiptarëve, mirëpo e njëjta gjë vlen edhe për të gjithë komunitetet e tjera fetare që janë pjesë e trojeve tona. Provokimet, ngacmimet ose tendencat për të fyer bindjet fetare të tjetrit, duke ndarë bashkërisht një gjuhë, një kulturë dhe një traditë të përbashkët, nuk duhen lejuar që të zënë vend në mesin tonë.

Me muslimanët, kudo që janë, komuniteti ynë shqiptar musliman ndan fenë e përbashkët, por me shqiptarët e çdo përkatësie fetare ndan gjakun, tokën, dheun dhe atdheun.

Vetëm të bashkuar, tolerantë dhe respektues të njërit-tjetrit, do të kemi edhe ndihmën e Zotit dhe të tjerëve. Kurse, të ndarë e të përçarë, mos dhashtë Zoti, do të gëzojmë e ndihmojmë vetëm shejtanin dhe armikun tonë.

Prijësit e fesë islame në vendin dhe trojet tona arbërore, karshi bashkëkombësve të tyre të krishterë dhe të tjerëve, gjithnjë kanë zbatuar fjalën e Zotit: ***“Ju keni fenë tuaj dhe ne kemi fenë tonë.”*** (Kur'an: 109: 6)

## Provokimet në emër të fesë janë ogurzi

Në vitet që lamë pas të fundshekullit të kaluar dhe ato të fillimshekullit 21, bota muslimane ishte e trazuar dhe vazhdon të jetë e tronditur si kurrë më parë. Kjo për arsye të shfaqjes së disa veprimeve tendencioze dhe fyese, nga grupe të pjesëtarëve të feve të ndryshme, me orientime raciste dhe prapavijë fobiste. Karikaturat të cilat portretizonin figurën e Profetit Muhammed a.s. me pamje degjeneruese, si ato në Danimarkë, Suedi e Holandë etj., ishin vetëm disa nga aktet e qëllimshme që provokuan ndjenjat e besimtarëve muslimanë në shumë pjesë të botës. Si provokim i drejtpërdrejtë, së fundmi u konsiderua edhe prodhimi i një filmi me metrazh të shkurtër, i mbushur plotë me urrejtje dhe mllef kundër Islamit dhe muslimanëve. Filmi i titulluar *“Pafajësia e muslimanëve”* (Innocent of Muslims), në fakt nuk ishte gjë tjetër veçse një grackë e radhës, e përgatitur mirë nga njerëz me tendencë dhe paragjykime, dhe kjo në fakt që si pjesë shtesë në vazhden e përpjekjeve të qarqeve të caktuara, ku qëllimi i tyre është futja e urrejtjes dhe përçarjes së mëtejshme mes njerëzve mbi baza fetare<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Një paralajmërim përplasjeje mes civilizimeve pas rënies së sistemit komunist e kishte bërë edhe autori Samuel P. Huntington në veprën e tij: *“The Clash of Civilizations”* (Përplasja e Qytetërimeve).

Mirëpo, ky rast si dhe paralajmërimet e mediave për provokime të tjera në baza fetare, në ditët, muajt apo vitet në vijim që pritet të ndodhin, janë veprime që duhet të parandalohen nga të gjithë, sepse ato jo vetëm që nuk i shërbejnë paqes dhe harmonisë ndërnjerëzore dhe ndërfetare, por krijojnë urrejtje dhe hendeqe të thella ndarëse, të cilat kur marrin tatëpjetën, atëherë do të jenë sfidë dhe do të bëhet i pamundur ndalimi i tyre.<sup>1</sup>

Fyerjet e ndjenjave fetare të njëri-tjetrit janë ogurzi për paqe, tolerancë dhe respekt të ndërsjellë të kombeve dhe shteteve me identitete të ndryshme fetare. Kurdo gjatë historisë, kur ndjenja e besimit është keqpërdorur për këso qëllime dhe prapavija, kanë rezultuar ngatërresa, luftëra dhe gjakderdhje me pasoja fatale për shoqërinë, të cilat lehtë mund të dëshmhohen edhe nga historia e kaluar jo shumë e largët e njerëzimit.

Provokimet e drejtpërdrejta me ndjenjat e brendshme shpirtërore të njerëzve nuk duhen lejuar që të ndodhin askund, sikundër as në mesin tonë. Ato duhet të parandalohen nga të gjithë njerëzit qëllimshëm dhe të devotshëm. As muslimanët, as të krishterët e as hebrenjtë, si dhe të tjerët, nuk duhet ta lëshojnë veten deri në atë

---

<sup>1</sup> Se sa është fatale për shoqërinë kultivimi i urrejtjes ndërfetare mund të kuptohet edhe me rastin e ekstremistit katolik, Andres Breivik, i cili mbi bazë të urrejtjes vrau 69 persona dhe plagosi 121 të tjerë.

shkallë sa të fyejnë të tjerët mbi baza fetare. Forma e vetme e lejuar për të shprehur kundërmendimin ndaj tjetrit duhet të jetë forca e argumentit, e arsyes dhe logjikës së shëndoshë.

Dhuna, konspiracioni, përçarja, turbullirat dhe vrasjet e njerëzve të pafajshëm, të cilat bëhen dhe shkaktohen nga njerëzit që thirren kinse në emër të fesë, duhet të kundërshtohen nga çdo njeri i arsyeshëm. Atyre u duhet bërë me dije se me mendime dhe veprime të tilla janë kundër Zotit dhe mësimave të Tij.

Muslimanët, por edhe pjesëtarët e besimeve të tjera fetare, duhet të jenë të parapërgatitur për provokime të ndryshme, e ndoshta edhe më të rënda, të cilat mund të ndodhin në të ardhmen nga grupe të njerëzve shpirtligj dhe ndjellakeq. Mirëpo, në raste të tilla, njerëzit e fesë dhe arsyes duhet të reagojnë në kohë, në mënyrë që ata të mos devijojnë në mënyrë të pakufishme dhe të pafundme.

Frustrimi dhe veprimet e një grupi të caktuar njerëzish brenda një komuniteti të gjerë fetar nuk duhet të shërbejnë si element i fyerjes dhe urrejtjes së trungut të përgjithshëm dhe përkatësisë së gjerë të besimtarëve.

Në këtë apel duhet të bashkohen të gjithë krerët fetarë të të gjitha besimeve, sepse në fund të fundit të gjithë i takojmë një Zoti të Vetëm. Zaten, edhe në bazë të studimeve gjenealogjike, njerëzit pa dallim race e etnie janë 99.9% të ngjashëm nga ana e brendësisë krijuese dhe

strukture të tyre, që nënkupton se të gjithë kanë një zanafillë dhe bërthamë të vetme nga e cila, u gjetën, u lindën dhe u zhvilluan në këtë planet.

Prandaj, orientimet e ndryshme në besimin e tyre të brendshëm shpirtëror duhet të shikohen si zgjedhje e lirë e çdonjërit, dhe jo si shkaktarë të urrejtjes mes vete. Kultura e bashkëjetesës dhe respektit të ndërsjellë duhet të jetë mbizotëruese në shoqëritë njerëzore, e kurrësi jo ajo e urrejtjes dhe përçarjes. Në raste provokimi, njerëzit duhet të reagojnë mbi bazën e arsyes dhe analizës, e jo mbi bazën e emocionit dhe mërzitjes së rastit, sepse pikërisht mërzitja dhe çorientimi i palës së shenjuar është edhe qëllimi i provokuesit.

I ashtuquajtur i film *“Innocence of Muslims”*, si provokim i hapur i radhës ndaj ndjenjave të muslimanëve, i hedhur në media me ndikim në botë si dhe në rrjete të shumta të internetit, ishte një veprim i keq dhe i pështirë.

Mirëpo, muslimanët që kohë pas kohe janë dhe mund të jenë target i këtyre ngacmimeve edhe në të ardhmen, duhet të jenë të kujdesshëm që të mos bien në grackën e projektuesve tendenciozë, të cilët kanë për synim shkaktimin e trazirave në mesin e muslimanëve në rend të parë, pastaj edhe plotë qëllime të tjera të cilat jo të gjithë besimtarët e rëndomtë mund t'i deshifrojnë me lehtësi.

Është fatlume që në shoqëritë njerëzore në përgjithësi, njerëzit e mirë dhe qëllimmirë janë

gjithmonë më shumë se sa e kundërta<sup>1</sup>, mirëpo, megjithatë në rast se grupi i parë shumicë i të mirëve hesht, atëherë grupi brejtës do të arrijë të realizojë qëllimet e tij në shkaktimin e së keqes në mesin e njerëzve, riparimi i së cilës do shumë kohë, e nganjëherë është edhe i pamundur<sup>2</sup>.

Në asnjë libër të shenjtë nuk ka Zot që urdhëron për vrasjen e njerëzve të pafajshëm, ose që mëson dhe nxit urrejtje kundër qenies njeri. Prandaj, nuk do të ketë paqe në botë nëse nuk ka mirëbesim dhe respekt ndërnjerëzor! Ndërsa as

---

<sup>1</sup> Punët e liga, veprimet e dëmshme dhe turbulluese që ndodhin në shoqëritë njerëzore janë rezultat i heshtjes së njerëzve të mirë dhe të arsyeshëm.

<sup>2</sup> Grupet njerëzore dhe shoqërore në këtë botë, janë si udhëtarë të ngarkuar në anije lundruese. Të gjithë ne, në një formë apo një tjetër, mbi sipërfaqen e tokës lundrojmë së bashku, por në drejtime e rrugë të ndryshme. Si qenie njerëzore, të gjithë kemi një fillim dhe një mbarim. Siguria e anijes është e varur në kujdesin që ka marinari dhe udhëtarët në bordin e saj. Në këtë kontekst, vlen të theksohet thënia e Muhammedit a.s., e cila nga ai ishte deklaruar në formë të një shembulli të urtë dhe domethënës: *“Nëse në anijen në të cilin ju lundroni, njëri nga udhëtarët e pakujdesshëm dhe qëllimkeq merr në dorë një hekur të mprehtë dhe e godet bordin e anijes duke u munduar që ta shpërthejë atë, cila do të ishte detyra e udhëtarëve në ato momente?! Heshtja dhe shikimi nga distanca, apo veprimi i menjëhershëm parandalues?! Sigurisht se veprimi i menjëhershëm parandalues do të ishte më se i kërkuar, sepse në të kundërtën jo vetëm brejtësi i anijes, por edhe të gjithë udhëtarët bashkë me të do të fundoseshin në ujë. Prandaj, është detyrë e të gjithëve që të parandaloni të keqin, sepse me një veprim të tillë, ju jo vetëm që do të shpëtonit protagonistin nga fundosja, por edhe veten dhe gjithë të tjerët të cilët janë të pafajshëm”.*

njëra e as tjetra nuk do të arrihen nëse mungon respekti i lirisë së përkatësisë fetare të çdonjërit.

Zoti i Madhëruar në librin e Tij, na këshillon me fjalët: ***“Keni kujdes nga përçarja, sepse kur ajo ndodhë, në të nuk përfshihen vetëm shkaktarët e saj (por edhe njerëzit e mirë dhe të pafajshëm)”***. (El-Enfal: 25)

## **Vrasja e të pafajshmëve në emër të fesë është veprim kundër porositë të Zotit**

Ngjarjet e vrasjeve të njerëzve të pafajshëm, kalimtarë rasti, ose në pabesi, nga individit dhe grupe të cilat thirren në emër të Allahut, janë veprime të liga dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me vetë fenë në të cilën ata thirren. Këto akte të cilat në mënyrë sporadike vazhdojnë edhe sot të ndodhin kohë pas kohe në vende të botës islame dhe jashtë saj, mund të shkaktojnë dëme të paparashikueshme për të gjithë shoqërinë njerëzore në përgjithësi, dhe jo vetëm për një rreth a territor të caktuar hapësinor dhe kohor siç mund të pretendojë dikush.

Përgjegjësia parandaluese në këtë drejtim bie mbi institucionet dhe predikuesit e fesë në përgjithësi, por edhe mbi të gjithë të tjerët të cilët kanë ndikim në shoqëri. Si të ngarkuar drejtpërdrejt për lidhjet shpirtërore të njerëzve me Zotin, prijësit fetarë kanë për detyrë që besimtarëve t'u shpjegojnë fenë drejt, mbi parime dhe baza të shëndosha, larg çdo ndikimi apo doktrine të huaj, e cila ndodh të jetë e kundërt me mësimet fetare e të mirëfillta hyjnore<sup>1</sup>. Qëllimi i fesë është zbutja e zemrave të njerëzve, lidhja me Zotin, kultivimi i afërsisë ndërnjerëzore, dhe jo

---

<sup>1</sup> Çdo mendim, opinion apo ideologji që nuk ka mbështetje në Kur'an si dhe në thëniet autentike të Muhammedit a.s., në shkencat islame konsiderohet si jo e shenjtë, e saktë ose pasaktë qoftë.

mbjellja e vrazhdësisë, urrejtjes dhe vrasjes në emër të Zotit!

Elemente të ekstremizmit fetar ka pasur dhe ka edhe sot, thuajse gati në mesin e çdo shoqërie dhe komuniteti fetar në botë, ku më pak e ku më shumë. Mirëpo, angazhimi ynë duhet të shkojë në drejtim të parandalimit të tyre, përmes edukimit të drejtë dhe të mirëfilltë të gjeneratave në vijim, sepse në të kundërtën, mendimi i ashpër dhe i mbyllur fetar do të rritet edhe më shumë në mesin tonë, i cili po zuri rrënjë, do të jetë e vështirë të parandalohet dhe të vihet nën kontroll. Feja, mjerisht, kohë pas kohe është keqpërdorur nga njerëz dhe qarqe të caktuara, me qëllim që në emër të saj të realizojnë më lehtë qëllimet ideologjike, gjeopolitike si dhe interesat personale, klanore apo grupe të tyre.

Fundi i shekullit të kaluar dhe fillimi i shekullit 21 ka qenë i mbushur me akte dhune e terrori në emër të fesë<sup>1</sup>. Ndërhyrjet e aleatëve perëndimorë në shumë vende islame së fundmi, nga një pjesë e madhe e muslimanëve janë konsideruar armiqësore, okupim, anti-islame dhe anti-muslimane. Mirëpo, në anën tjetër akte dhune, për fat të keq, kanë ndodhur dhe po ndodhin edhe në mesin e vetë muslimanëve, të shtyra e të

---

<sup>1</sup> Në dekadën e parë të këtij shekulli ka pasur vrasje masive të muslimanëve në Burma, Indi dhe Kinë.

nxitura nga grupe sektare fetare si në Irak, Libi, Tunizi, Egjipt, Siri,<sup>1</sup> Pakistan, Afganistan, etj..

Sa herë që ndodhin veprime të tilla vrastare në emër të ideologjisë fetare, ato gjykohen me shpejtësi dhe me gjuhë e tone shumë të ashpra, nga të gjithë prijësit e besueshëm fetarë si dhe nga akademikët më të lartë të fesë islame, si Shejhu i Ez-herit - instanca më e lartë fetare islame, e deri te imamët e xhamive, duke i cilësuar si akte të papranueshme, jo njerëzore dhe në kundërshtim me vetë mësimet burimore fetare të Islamit.

---

<sup>1</sup> Trazirat në botën arabe, të njohura si “Pranvera Arabe”, kanë rezultuar me rrëzimin e sistemeve diktatoriale. Mirëpo, prapëseprapë këto vende, në vend që të konsolidohen, ato ende nuk po arrijnë të fuqizohen e të riorganizohen si shtete të lira e demokratike. Me të rrëzuar diktatorët e tyre, në shumë vende të pas Pranverës Arabe, janë organizuar shumë grupe të ndryshme me qëllim të marrjes dhe grabitjes së pushtetit, e jo me synim të ndërtimit të shtetit. Interesat për pushtet kanë bërë që shumë parti dhe fraksione brendapërbrenda këtyre shoqërive post-diktatoriale të ngjyrosin aktivitetin e tyre edhe me ideologji fetare. Në vend që të ofrohen dhe bashkohen, duke qenë se janë një popull me një gjuhë, fe e kulturë, ata janë ndarë e përçarë edhe më shumë se sa në kohën e diktatorëve. Ditë e përditë dëgjohen konflikte e vëllavrasje të pamëshirshme, të cilat shumë prej tyre fatkeqësisht janë të motivuara edhe fetarisht. Shembulli më i dhembshëm sot është Siria, populli i së cilës po vuan e po kalon vitet më të rënda, që nga koha e kryqëzatave në Mesjetë. Edhe Egjipti nuk është duke e kaluar fazën e tranzicionit qetësisht, ndërsa mirë në këtë drejtim nuk është as Tunizia e as Libia.

Mirëpo, megjithatë, ato prapë po përsëriten, prapë po ndodhin, ku më shumë e ku më pak.

Në rrethana normale nuk mund të ketë prijës të mirëfilltë të fesë, i cili në një ambient të pages, mund të arsyetojë vrasjen masive të njerëzve të pafajshëm, e atëherë më pak ato tinëzare dhe në pabesi. Për të arsyetuar akte të tilla të çmendura, ai ose ajo duhet të jetë ose pa ndjenja shpirtërore dhe pa ndjenja besimi në Zot, ose i/e orientuar dhe indoktrinuar thellësisht, psikikisht dhe emocionalisht në drejtim të gabuar.

Rezultatet analitike dhe praktike kanë treguar se kryesit e akteve të vrasjeve masive, të të pafajshmëve në rrugë, xhami, bulevarde etj., në emër të fesë, mbi 90% e tyre kanë rezultuar si njerëz të paarsimuar, ose gjysmë të arsimuar, ose pa njohuri të mirëfillta paraprake mbi fenë, për dallim nga projektuesit e tyre. Shumica e vrasësve kamikazë manipulohen dhe ndikohen me anë të indoktrinimit tendencioz fetar e shpirtëror, të versionit intolerant, nga njerëz të caktuar, oratorë dhe mjeshtër të nxitjes së flijimit dhe sakrificës në emër të Zotit. Po ashtu të tillëve - vetvrasësve kamikazë, nga ana e ideologëve ju premtohet fitimi dhe shpërblimi me Xhennet në botën tjetër për guximin e veprimit të tyre.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Askund në të gjithë literaturën islame shkencore, klasike dhe bashkëkohore nuk mund të gjendet premtimi i Xhennetit për ata të cilët, në kushte paqeje dhe në ambient të lirë e të sigurtë vrasin fëmijë, gra, burra e pleq të pafajshëm.

Këto vrasje masive të njerëzve të pafajshëm, si të qytetarëve dhe të kalimtarëve të rastit në emër të “Islamit”, nga ana e fidainjëve, kamikazëve, Komunitetit Musliman Botëror në përgjithësi (Ummetit), në formë të drejtpërdrejtë i kanë shkaktuar dhe po i shkaktojnë një imazh tepër të keq karshi botës së qytetëruar. Këto veprime të pamatura, i kanë nxitur dhe po i nxisin pjesëtarët e besimeve të tjera në botë, që të gjithë besimtarët muslimanë t’i quajnë, pa hezitim, si të tërbuar, të pashpirt, anti-humanë, ekstremë, gjakpirës, bisha të egra, etj. etj..

Ndërsa në anën tjetër islamofobia - mbjellja e frikës ndaj Islamit, që në botën perëndimore po kultivohet së fundi kujdesshëm, padyshim se është rritur si asnjëherë më parë, pikërisht si pasojë edhe e këtyre akteve të çmendura, prapavijën e të cilave sot nuk mund ta kuptojë gjithsecili.

Pyetja e cila lind vetvetiu në këtë lidhshmëri është se çfarë faji kanë mbi 90% të muslimanëve, të cilët nuk pajtohen me këto veprime të çmendura, të nxitura e të realizuara nga një celulë e shkëputur e gjithë trungut të madh të botës muslimane? Pse muslimanët e devotshëm dhe të drejtë janë të orientuar të urrehen për shkak të kësaj pjese të vogël njerëzish, të cilët po e keqpërdorin Islamin për qëllime dhe interesa të ngushta dhe të pjesshme?

Nëse projektuesit e deritanishëm kanë synuar dhe synojnë që veprimet e tilla vrasëse e terroriste

të formës kamikaze do t'i kontribuojnë Islamit dhe muslimanëve, le ta dinë se ata kanë bërë dhe po bëjnë pikërisht të kundërtën e asaj që kanë synuar dhe mund të synojnë.

Ata që në emër të Islamit thërrasin për vrasjen e njerëzve të pafajshëm ose të krejt atyre që nuk besojnë dhe mendojnë si ata, janë kundër Zotit, Islamit dhe muslimanëve. Prandaj, le të ndalen e këndellën të gjithë dhe le të kuptojnë këtë realitet si apel, sidomos të rinjtë tanë, që të mos bien pre e manipulimeve dhe keqinterpretimeve të qëllimta fetare, të cilat bëhen me parapërgatitje nga njerëz apo individë të caktuar, qoftë përmes formës verbale, të drejtpërdrejtë, apo edhe të uebsajteve e audio-videove që qarkullojnë me ose pa ndonjë adresë. Gjithashtu, të kihet kujdes e të mos bëhen robër të asnjë interpretimi të ashpër, konservativ dhe jo racional të mësimave fetare islame.

Kjo do të vlente edhe për pjesëtarët e feve të tjera, në mesin e të cilave po ashtu gjenden grupe ekstreme dhe jo racionale, të cilët bëjnë ose kryejnë akte provokuese të ngacmimit të ndjenjave fetare të të tjerëve në emër të Krishtit, Judës, Hinduizimit, apo të diçkaje tjetër.

Për të arritur deri te kjo vetëdije, ne si shoqëri kemi nevojë për një edukim të mirëfilltë dhe serioz të brezave të tanishëm dhe të ardhshëm, sepse sa më e lartë që të jetë vetëdija njerëzore, aq më i lartë është respekti dhe solidariteti mes njerëzve. Studiues të shkencave shoqërore dhe fetare, institucione qeveritare dhe jo qeveritare,

OJQ-të, të gjithë së bashku duhet të punojnë për vetëdijesimin e shoqërisë mbi respektimin e vlerave të njëri-tjetrit.

Vrasja e njerëzve të pafajshëm në parimet islame është kategorizuar si vrasje e gjithë njerëzimit, kurse shpëtimi i një shpirti të vetëm është vlerësuar si shpëtim i gjithë njerëzimit. Mësimet e Kur'anit janë të lidhura ashtu siç janë edhe nyjet e trupit të njeriut, funksioni i të cilave nuk mund të paramendohet pa lidhshmërinë mes tyre. Forma e pjesshme e komentimit të Kur'anit është në kundërshtim me vetë Kur'anin, sepse si e tillë është gjysmake, e çalë dhe jo shkencore. Në Kur'an këshillohemi: ***“...nëse dikush mbytt dikë, i cili nuk ka mbyttur askënd ose nuk ka bërë turbullira në tokë, është sikur të ketë mbyttur tërë njerëzinë, e kush bëhet shkaktar për të jetuar dikush është sikur t'i kishte ngjallur (shpëtuar) gjithë njerëzit...”*** (el-Maide: 32)

Ndërsa porosia e Muhammedit a.s., për shokët e tij ishte: *“...mos të vrasin fëmijë dhe njerëz të pafajshëm, as gra, pleq e plaka...”*

Vrasjet e të pafajshmëve, kudo që ndodhin, duhet të jenë një sinjal i vetëdijesimit tonë ndërshtiptar dhe më gjerë, si parandalues për të ruajtur të ardhmen e fëmijëve tanë, që të mos bien viktimë e qarqeve të errëta që dëmtojnë të ardhmen e bashkëjetesës sonë. Toleranca fetare ka qenë dhe mbetet alfa dhe omega e jetës paqësore mes njerëzve, prandaj të gjithë jemi të obliguar që në këtë drejtim të japim kontributin tonë, minimal dhe maksimal.

## **Sistemi i ri demokratik dhe ballafaqimi me kërkesa të reja të komunitetit musliman shqiptar**

Ne shqiptarët, për dallim nga popujt e tjerë fqinjë në Ballkan, jemi dalluar dhe dallojmë edhe sot me gjuhë, zakone dhe me një kulturë e traditë të veçantë. Përveç këtyre divergjencave, jemi të ndryshëm edhe me elementin e përkatësisë fetare, pasi që shekuj me radhë si shqipfolës kemi përqaftuar fetë monoteiste më të mëdha në botë. Mirëpo, edhe pse të ndryshëm në përkatësi fetare, ndaj raportit me armikun pushtues gjithmonë kemi qenë unik. Ndërsa si komb, brenda për brenda, asnjëherë nuk kemi pasur konflikte mbi baza fetare, një vlerë e rrallë që është vlerësuar dhe po vlerësohet edhe sot nga të gjithë, si në qarqet vendore ashtu edhe në ato ndërkombëtare.

Lufta ndaj fesë, kudo që ka ndodhur në botë, ka prodhuar pakënaqësi në shoqëri. Shembullin më tipik të luftimit të fesë dhe besimtarëve të Zotit, si dhe rezultatin e pasojave të shkaktuara nga luftimi i besimit të lirë të njeriut si dhe të krijimit të një vakumi shpirtëror tek njerëzit, kemi shtetin tonë amë Shqipërinë, gjatë periudhës së regjimit enverist, komunist dhe ateist. Regjimi i tij me gjithë sanksionimin e hekurt ndaj fesë, i cili në Shqipëri kishte zgjatur dekada me radhë, komunistët e këtij vendi megjithatë nuk kishin arritur të zhdukin ndjenjën e brendshme shpirtërore të shumë besimtarëve që u

persekutuan e u vranë edhe për shkak të përkatësive të tyre fetare. Me të përfunduar regjimi totalitar në Shqipëri, një ndër hapat e parë që bëri qytetari shqiptar i këtij vendi ishte rikthimi i kulteve fetare dhe fillimi i praktikimit të fesë. U hapën xhamitë dhe kishat, aty këtu të mbijetuara gjatë komunizmit, si dhe kultet e tjera të komuniteteve fetare, u ndërtuan e rindërtuan institucionet e reja fetare, të cilat shihej dhe prekej me të madhe se u kishin munguar për një kohë të gjatë.

Tek ne, në Kosovë, dhe në vendet e tjera të ish-Jugosllavisë ka pasur një qasje paksa më të butë karshi fesë. Edhe pse si çdo sistem tjetër komunist kudo në botë, edhe në Kosovë minimizoheshin dhe nëpërkëmbeshin vlerat dhe liritë fetare të njerëzve, por që nuk shkonin në ekstrem siç kishte ndodhur në vendin tonë amë, ku njerëzit të cilët nuk donin të linin dhe braktisnin fenë, internoheshin e vriteshin në mënyrën më makabre të mundshme<sup>1</sup>. Në vendet e ish-Jugosllavisë, pjesë e së cilës padrejtësisht ishim edhe ne si Kosovë, faltoret dhe institucionet edukativo-fetare ishin të lejuar të punojnë për të gjitha besimet pa dallim<sup>2</sup>, mirëpo kuptohet me

---

<sup>1</sup> Një vendim të tillë, për ndalimin e çdo aktiviteti dhe propagande fetare në Shqipëri, e kishte marrë qeveria e Enver Hoxhës në vitin 1967.

<sup>2</sup> Sistemi komunist në ish-Jugosllavi, pas vitit 1945, ka përndjekur, burgosur e vrarë shumë prijës fetarë të kombësive jo serbe, të cilët haptazi kishin kundërshtuar sistemin komunist.

aktivitet të reduktuar, të kufizuar dhe të kontrolluar vazhdimisht.

Pas rënies dhe shembjes së bllokut komunist në vitet e '90-ta, shoqëritë post-komuniste të shumë vendeve të botës filluan t'i përkushtohen dhe t'i rikthehen fesë si kurrë më parë, ku numri i besimtarëve të të gjitha besimeve fetare filloi të rritet me një ritëm të ngjeshur e të vazhdueshëm. Në mesin e vendeve post-komuniste bëjmë pjesë edhe ne, si shoqëri dhe si komb shqiptar në përgjithësi.

Praktikimi i lirë i fesë duhet respektuar dhe rregulluar me ligj dhe norma, në mënyrë që askush të mos gjejë hapësirë dhe boshllëk për komentim dhe interpretim të ndryshëm, për të marrë pastaj formë diskriminuese në shoqëri.<sup>1</sup>

Më poshtë do të sjellim një opinionin tonë lidhur me tri çështje me të cilat është preokupuar komuniteti fetar musliman në Kosovë prej pas luftës në vitin 1999, por edhe komuniteti shqiptar në Shqipëri dhe Maqedoni.

---

<sup>1</sup> Praktikimi i fesë është një liri e garantuar nga të gjitha konventat ndërkombëtare si: Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (4 nëntor, 1950), Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut, "Pakti i San Hozesë" (22 nëntor, 1969), pastaj nga "Pakti i San Salvadorit" (17 nëntor 1988), Konventa në kuadër të Mbrojtjes së Pakicave Kombëtare (Strasburg, shkurt 1995), si dhe nga tri konventat e tjera ndërkombëtare që, përgjithësisht, që të shtatat konventa garantojnë lirinë e besimit dhe praktikimin e tij.

**1. Edukata fetare** - në shkollat publike të shtetit, për të gjitha komunitetet fetare të shoqërisë sonë, në të ardhmen mund të rregullohet e sistemohet si çështje dhe si kërkesë, por vetëm pas parapërgatitjeve të larta profesionale nga ana e një grupi ekspertësh fetarë në bashkëpunim me studiues të shkencave edukative dhe shoqërore si dhe ekspertë të historisë. Ky grup, në bashkëpunim të plotë mes vete, do të arrinin të përgatitnin një plan-program me kurrikulë të përparuar, i cili do të mbikëqyrej nga institucionet tona përkatëse dhe arsimore në vend<sup>1</sup>. Lënda e edukatës fetare në shkollat publike, nuk do të ishte në dëm të shoqërisë, për sa kohë ajo do të përgatitej dhe mbikëqyrej nga njerëz kompetentë, të ndërgjegjshëm dhe të vetëdijshëm për rrethanat e vendit në të cilin ne jetojmë.

Si çështje, duhet të diskutohet dhe të debatohet me ekspertë vendor, e pse jo edhe me ndërkombëtar, në koordinim të plotë me të gjitha bashkësitë fetare në vend<sup>2</sup>.

---

<sup>1</sup> Kjo formë e edukimit të brezave të ardhshëm do të parandalonte bindjet e shtrembëruara, të cilat në të ardhmen mund t'i keqpërdorin në emër të fesë.

<sup>2</sup> Sot shumë vende në Europë praktikojnë lëndën e edukatës fetare në shkollat e tyre publike, ndërsa disa pjesë të tjera të këtij kontinenti, të cilët ende nuk e kanë paraparë këtë në plan-programet e tyre shkollore, janë duke punuar seriozisht për përfshirjen e saj në plan-programet shkollore publike, në një të ardhme të tyre të afërt.

**2. Çështja e shamisë** - konkretisht e mbulesës së kokës, është e drejtë individuale e një besimtareje të besimit islam, e cila me bindjen e vet të lirë, si dhe me vullnetin e saj të pa imponuar dhe pa trysni, ka vendosur që të marrë një hap të tillë. Ndryshe, ndërhyrja në bindjet shpirtërore dhe personale të individit, në shoqëritë e lira dhe demokratike, konsiderohet shkelje e të drejtave dhe lirive të njeriut.

**3. Xhamia qendrore** - nga të gjithë ne duhet shikuar si nevojë e hapësirës së besimtarëve muslimanë të cilët jetojnë në kryeqytet, ku dendësia e besimtarëve është e theksuar, dhe jo si kundërpërgjigje ndaj ndonjë besimi tjetër. Vendfaljet ndërtohen për t'ju lutur Zotit kolektivisht, e jo për inat dhe mëri të dikujt.

Islami si fe hyjnore, i ndërtuar mbi parimet bazë dhe autentike të tij, pra jo deformues e kërcënues me ngjyrimë të jashtme, nuk duhet shikuar e trajtuar nga ne si fobi. Nuk mund të mohohet fakti se viteve të fundit ka pasur dhe ka interpretime me qasje e frymë ekstreme, të ashpra dhe radikale të mësimëve të Islamit, si nga individët ashtu edhe nga grupet e caktuara të njerëzve, të cilët me vetëdije ose jo, kanë rënë nën ndikimin e këtij lloji të interpretimit jo të drejtë dhe jo racional, mirëpo, fatmirësisht, marrë në përqindje lokale dhe globale, këta njerëz dhe grupe devijuesish, janë vetëm një bujashkë e

trungut të madh të muslimanëve në botë, të cilët në shumicë absolute përfaqësojnë interpretimin e Islamit të drejtë, racional, liberal dhe tolerant.

Në vendin tonë, si dhe në rajon e më gjerë, sidomos pas viteve të 90-ta ka pasur dhe ka prirje të rritjes së një praktike jo tradicionale të fesë islame. Kjo është bërë dhe po bëhet përmes një fryme jo autoktone, jashtë vijës zyrtare të komunitetit fetar musliman, si dhe larg parimeve e rregullave të shkollës fetare juridike hanefite, e cila tek ne është praktikuar rreth 600 vite më radhë.

Në vendin tonë dhe në trojet shqiptare kudo ku ka besimtarë të besimit islam, duhet të mësohet dhe kultivohet Islami burimor i vijës së mesme, larg çdo interpretimi radikal dhe ekstrem. Një qasje reale ndaj Islamit, e cila nuk i përçau as besimtarët e as kombin tonë, si dhe as fqinjët tanë, qofshin ata të afërt apo të largët, qasje e cila duhet të vazhdojë të jetë rruga jonë obligative e të sotmes dhe të ardhmes.

Vazhdimi dhe kultivimi i kulturës sonë fetare islame mbi bazat e shkollës fetare juridike-hanefite, e cila për dallim nga drejtimit e tjera, elementin racional në mungesë të argumentit sheriatik e konsideron si burim mbështetës për shumë çështje fetare islame, padyshim se është dhe do të jetë në të mirë dhe në interes të përgjithshëm të komunitetit musliman në rend të parë dhe të shoqërisë sonë në përgjithësi.

## **Toleranca ndaj pakicave fetare jomuslimane në kohën e Shtetit Osman, model edhe për të sotmen**

Nisur nga fakti se Shteti Osman ishte një fuqi që dominoi për më shumë se pesë shekuj, duke përfshirë edhe pjesën tonë në Kosovë dhe në gjithë territoret shqiptare njësoj në Ballkan, por edhe më gjerë, pashmangshëm të bën të mendosh dhe analizosh se cila ishte filozofia dhe qasja e saj ndaj pakicave, apo siç quhen sot në fjalorin bashkëkohor, minoriteteve, që jetuan e vepruan nën administrimin e pushtetit osman. Toleranca dhe respekti ndaj pakicave fetare gjatë pushtetit osman i kishte rrënjët në mësimet e fesë islame, e cila ishte edhe fe zyrtare në mbretërinë osmane.

Siç është e ditur, Islami në thelbin e tij përkrah dhe respekton pluralizmin kulturologjik-fetar dhe dallimet etnike, fetare, racore, dhe gjuhësore, bazuar në shumë ajete kur'anore nga të cilët mund t'i ndajmë si vijon:

**1. “Ju njerëz! Vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete. S’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat), e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”.<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Sure El-Huxhurat: 13

**2. “Secili popull kishte të dërguarin, e kur u vinte i dërguari i tyre bëhej gjykimi i drejtë mes tyre, dhe atyre nuk u bëhej padrejtësi”.<sup>1</sup>**

**3. “Nga argumentet e Tij (Zotit) është krijimi i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë (ndarje-dallim) ka argument për njerëz”.<sup>2</sup>**

Edhe në traditën e Muhammedit a.s., përkatësisht në thëniet e tij, shihet qartë konsiderata e lartë si dhe respekti që ai u bënte pakicave. Në këtë kontekst do të kishim përmendur vetëm dy nga hadithet e tij:

*1. “Allahu ua ndalon hyrjen në shtëpitë e ithtarëve të librit, pa lejen e tyre”.*

*2. “Ti që shtyp pjesëtarin e pakicës së mbrojtur, e mashtron atë ose i ngarkon detyra jashtë aftësive të tij, apo ua uzurpon pronën, do të japësh përgjegjësi para Zotit në Ditën e Gjykimit”<sup>3</sup>*

Kuptimi i gjerë i konceptit të ithtarëve të librit ka qenë një bazament i fortë në të cilin të gjithë sundimtarët muslimanë janë mbështetur përgjatë historisë, në vendet ku ata sundonin, sidomos në zonat multietnike dhe multikulturore, qoftë në kohën e Emevive, Abasive, Andaluzisë, në kohën e sundimit të muslimanëve në Indi dhe, së fundi, gjatë Shtetit Osman.

Gjatë shfletimit të historisë islame në përgjithësi, nuk mund të gjejmë ndonjë rast kur

---

<sup>1</sup> Sure Junus: 47

<sup>2</sup> Sure Er-Rrum: 22

<sup>3</sup> Ebu Davud, Sunenu Ebu Davud, vëllimi 3, Bejrut, 1981, f. 437.

jomuslimanët janë akuzuar ose janë përndjekur pse kanë qenë pjesëtarë dhe respektues të fesë së tyre. Këtë të vërtetë e dëshmojnë edhe studiuesit e feve të tjera në literaturën e tyre, në mesin e të cilëve edhe Thomas W. Arnold, i cili në lidhje me këtë, ndër të tjera thotë: “Nuk kemi asnjë informacion për përpjekjet e organizuara të ushtrimit të trysnisë mbi jomuslimanët që të pranojnë me dhunë Islamin, dhe nuk ekziston dëbimi i organizuar sistematik i njerëzve për shkak të përkatësisë së krishterë. Sikur halifët të kishin vendosur që të zbatonin vetëm ndonjë nga metodat e lartpërmendura, kjo përpjekje për të shfarrosur krishterimin do të kishte sukses të njëjtë si përpjekja e Ferdinandit dhe Izabelës që kanë mënjanuar Islamin nga Spanja, ose Luixhit XIV që ndalonte protestantizimin në Francë, ose rasti i çifutëve në Angli...”<sup>1</sup>

Kjo që u theksua më lartë tregon në pika të shkurtra për parimet islame dhe qasjen që kanë pasur muslimanët në përgjithësi gjatë historisë së tyre ndaj pakicave fetare, sidomos në kohën kur ata ishin fuqi sunduese në pjesë të ndryshme të botës.

Sa përket Shtetit Osman, mund të thuhet se ai vazhdoi të jetë mjaft i kujdesshëm në trajtimin e pakicave fetare, ngase frymëzimin kryesor e kishte po ashtu tek të njëjtat parime, porosi, praktika dhe modele të mëhershme të sundimit

---

<sup>1</sup> Thomas W. Arnold, *The Preaching of the Islam: A history of the Propagation of Muslim Faith*, Lahore 1986, f. 80.

musliman. Parim kryesor të këtij respektimi ka qenë ajeti kur'anor: **“Në fe nuk ka dhunë”**.<sup>1</sup>

Shteti Osman, i cili u krijua në Anadoll në vitin 1299, fillimisht si një principatë e vogël e që më pas u zgjerua në tri kontinente, është shembull në respektimin e pakicave fetare, etnike dhe kulturore, të cilat i praktikonte kjo fuqi botërore e asaj kohe. Siç edhe u theksua më sipër, kjo fuqi vazhdoi t'i qëndrojë besnik traditave të mëhershme islame, dhe krijoi edhe një *nidham*, një sistem të quajtur “*Sistemi osman i milletit*”, që përcaktonte detajisht raportet mes shtetit dhe bashkësive të ndryshme fetare. Shoqëria e shtetit osman përbëhej kryesisht nga muslimanët dhe jomuslimanët. Muslimanët bënë pjesë në shoqëri islame, pavarësisht nga raca, kultura dhe sekt, kurse pjesa tjetër e popullit ishin të organizuar në bashkësi rreth kishave, si rreth asaj ortodokse<sup>2</sup>, gregoriane<sup>3</sup>, kurse çifutët organizoheshin rreth sinagogës<sup>4</sup>.

Ky sistem i “milletit” për herë të parë ishte themeluar nga Sulltan Mehmeti II, pas çlirimit të Stambollit. Sipas rregullores së tij, patriarku ortodoks merrte pjesë në këshillin perandorik, parim ky që më vonë u zgjerua edhe te bashkësitë e tjera, që përmes kësaj shteti i asaj kohe, të gjithë

---

<sup>1</sup> Sure El-Bekare, ajeti 256.

<sup>2</sup> Grekët, bullgarët dhe serbët.

<sup>3</sup> Gruzianët dhe armenët.

<sup>4</sup> Ekmeleddin Ihsanoglu, “A Culture of Peaceful Coexistence”, IRCICA, Stamboll, f. 57.

jomuslimanëve u ofronte liri fetare dhe siguri për jetën dhe pronën e tyre.<sup>1</sup>

Jomuslimanët zbatonin ligjet e veta, në të drejtën private dhe të drejtën familjare, kurse për çështje të tjera i nënshtroheshin së drejtës penale muslimane. Ishin të detyruar të paguanin dy lloje tatimesh: xhizjen (për mbrojtjen e ofruar nga muslimanët), si dhe haraçin (për tokë). Gratë, fëmijët, pleqtë dhe plakët, të sëmurët dhe njerëzit e fesë nuk detyroheshin me pagim të tatimeve të tilla.<sup>2</sup>

Se sa tolerant ishte Shteti Osman ndaj feve të tjera dëshmojnë fakte të ndryshme historike. Për shembull, gjatë inkuizicionit në Andalusi, (Spanjën e sotme) kur të gjithë muslimanët u larguan me dhunë, u vranë dhe u masakruan pa mëshirë në emër të fesë, në mesin e të përndjekurve bënë pjesë edhe çifutët, të cilët për një kohë të gjatë kishin bashkëjetuar me muslimanët pa asnjë problem. Çifutët e ikur nga sunduesit e Spanjës dhe Portugalisë në fund të shekullit 15 erdhën në Selanik, qytet i cili në kohën e Shtetit Osman njihej si kryeqytet i çifutëve me 100.000 banorë, ku 80% të tyre ishin nga komuniteti hebre.

Shqiptarët shumicë që e kishin përqafuar Islamin si fe nuk konsideroheshin “raja” por nënshtetas të Perandorisë, të cilët gëzonin të drejtat civile, liri personale, humanitare

---

<sup>1</sup> Ibid.

<sup>2</sup> Ibid, f. 59.

ekonomike etj. Këto të drejta i kishin fituar edhe pakicat katolike, ortodokse, sidomos katolikët e Mirditës, Dukagjinit, e të Malësisë së Kurveleshit etj., të cilët posedonin arat, vreshtat, kopshtet, blegtoritë, bënin tregti etj.<sup>1</sup>

Dr. Herman Gross, në librin “Ekonomia Ballkanike”, thotë se “Shqiptarët gjatë pesë shekujve që kanë bashkëjetuar me turqit osmanli, në sajë të aftësisë së përshtatjes dhe talentëve të tyre si nëpunës, kishin zënë shkallët më të larta në qeverinë e Stambollit dhe kishin luajtur role të rëndësishme për Perandorinë”.<sup>2</sup>

Kurse studiuesi Robert Matran në këtë kontekst thotë: “...drejtuesit osmanë nuk kanë pasur vullnet për asimilimin e popullsive të pushtuara, nuk kryen as osmanizëm dhe as islamizëm të detyruar; përndryshe si do të mund të shpjegonim ruajtjen e gjuhëve greke, bullgare, serbe apo të gjuhëve të tjera, të feve të krishtera e të parisë lokale...”<sup>3</sup>

**Mehmet Handziç**, një studiues boshnjak thotë: “Është mendim i gabuar i atyre që thonë se Islami është përhapur me dhunë. Ekzistojnë argumente të shumtë që e hedhin poshtë këtë ide. *Unë mund të përmend vetëm një dhe ai është se shekulli 19 nuk do të gjente asnjë të krishterë dhe asnjë kishë e manastir*

---

<sup>1</sup> Nexhip Alpan, Nesip Kaçi, Shqiptarët në Perandorinë Osmane, monografi, Albin, 1997, f. 11.

<sup>2</sup> Ibid, f. 12/13.

<sup>3</sup> Robert Matran, *L’histoire de L’Empire Ottoman*, Fayard, Paris, 1989, f. 11.

*në Ballkan, sikur Islami të përhapej me dhunë shtetërore.*<sup>1</sup>” Një shembull po ashtu mjaft interesant i frymës së pluralizmit në shekullin 15 është edhe premtimi i Sulltan Mehmetit II-të në Bosnjë dhe Hercegovinë, me të cilin garanton mbrojtjen e franjevitëve: “...askush të mos pengojë dhe të mos shqetësojë klerikët boshnjakë në kishat e tyre. Le të jetojnë në qetësi në mbretërinë time... As shkëlqesia ime e lartë, as vezirët e mi, as shtetasit e mi dhe askush nga banorët e Perandorisë sime të mos provojë t’i fyejë e t’i shqetësojë as ata, as jetët e tyre e as kishat e tyre.”<sup>2</sup>

Në një fjalim publik, Sulltan Mahmudi II-të, ndër të tjera kishte thënë: “Unë i dalloj shtetasit: kush është musliman ai është në xhami, kush është i krishterë ai është në kishë, kush është çifut ai është në sinagogë, kurse në ditët e tjera nuk ka dallim mes tyre.”<sup>3</sup>

Një fakt tjetër që tregon se sa e madhe ishte toleranca ndaj pakicave fetare në kohën e sundimit osman është edhe financimi që bëhej nga arka shtetërore për ndërtimin apo edhe rindërtimin e objekteve fetare joislame.

Pas futjes së sistemit të Tanzimatit në fuqi, në vitin 1839, të gjitha degët dhe pozicionet e qeverisë ishin të hapura për jomuslimanët, që të përfitojnë nga të drejtat e reja politike dhe

---

<sup>1</sup> H. Mehmed Handziç, *Islamizija Bosne i Hercegovine*, Sarajevë 1940, f. 13.

<sup>2</sup> Ekmeledin Ihsanoglu, f. 63.

<sup>3</sup> Resat Kaynar, *Mustafa Pasa ve Tanzimat*, Ankara, 1954 f. 100.

administrative, në rend të parë barazinë e muslimanëve dhe të popujve të tjerë (*Ehli Islam ve mileti saire*).

Të krishterët merrnin pjesë në punën e gjykatës tregtare dhe u vunë nën mbrojtjen e ligjit tregtar. Në vitin 1850, qeveria osmane pranoi **protestantët** si millet në vete. Ideja e osmanizmit, e bazuar në përfaqësimin e drejtë në administratë dhe në të drejtat e njëjta, u sanksionua si parim i rëndësishëm në kushtetutën e vitit 1876 (**Kanuni Esasi**). Në **Mexhlisi Umm**, parlamentin e parë osman, pos të tjerëve, pjesëmarrës ishin edhe përfaqësuesit e qytetarëve jomuslimanë, të cilët vazhdimisht merrnin pjesë në veprimtarinë ligjvënëse. Jomuslimanët u liruan nga statusi i **dhim-mive** për t'u bërë pastaj qytetarë me të drejta të barabarta.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Më gjerësisht shih librin: “Kultura e bashkëjetesës”, të autorit Ekmeludin Ihsanoglu, botuar në gjuhën shqipe nga Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, 2010.

## **Loja me ndjenjat e qytetarëve në emër të fesë, duhet të ndërpritet**

*“Kur Dini bëhet Dinar (interes material) - ai nuk është më fe!”*

Në çdo vend dhe shoqëri të botës, ka pasur dhe ka njerëz me bindje fetare të ndryshme nga njëri-tjetri. Autori Udo Tworuschka, në librin e tij “Leksikoni i religjioneve në botë”, numëron dhjetëra e qindra bindje e besime fetare të cilat i pasojnë popujt e ndryshëm të sipërfaqes së kësaj toke. Ndryshueshmëria e bindjeve dhe perceptimeve të fetarëve ndaj një fuqie absolute nuk buron nga Zoti, por nga vetë shkalla dhe niveli perceptues i tyre.

Përkushtimi dhe dorëzimi shpirtëror ndaj Zotit si krijues të qenies njeri dhe të universit në tërësi, është e gjithë urtësia dhe filozofia e shpalljeve hyjnore dhe udhërrëfyesve të njohur në literaturën fetare si peygamber dhe profet.

Mirëpo, duke mos qenë në gjendje të vlerësimit dhe studimit si dhe të pranimin të drejtë të mësimave të Zotit përmes të dërguarve të Tij, shumë shoqëri njerëzore jo rrallëherë kanë devijuar nga mesazhi qenësor e burimor i besimit në Zot, ndërsa shumë liderë fetarë duke thirrur gabimisht dhe iracionalisht në emër të Tij, e kanë humbur veten, por edhe pasuesit dhe ndjekësit e tyre i kanë lajthitur nga injoranca dhe fanatizmi i sëmure si dhe qasja e verbër e tyre.

Në rastet kur feja nga thirrësit e saj shihet si mjet interesi i çastit apo si urë transferuese dhe avancuese politike e materiale, për të arritur privilegje të kësaj bote dhe kësaj jete të përkohshme, atëherë feja si fe humb qëllimin dhe esencën e saj të brendshme, ndërsa edhe dëmi është më i madh sesa vetë dobia për të cilën pretendohet nga bartësit e tillë.

Thënë ndryshe, kur mësimet e fesë devijojnë nga parimet bazë duke marrë kahje të gabuara, me qëllime, synime dhe interesa të ngushta individuale dhe grupore, me bindje dhe besim të tepruar në vete, duke i dhënë të drejtën e quajtjes së vetes si pasuesit më të denjë të Zotit në sipërfaqen e tokës, ndërsa të gjithë të tjerët të cilët nuk mendojnë e besojnë si ta të devijuar dhe të humbur, është sinjali më i qartë se mesazhi hyjnor dhe parësor i besimit dhe përkushtimit në një Zot - Krijues i njerëzimit dhe gjithësisë - është devijuar dhe zhdrejtësuar.

Me përfundimin e luftës në vendin tonë dhe përfundimin e sistemit komunist në Shqipëri, u hap edhe dera për shumë misionarë të feve të ndryshme, të cilët si duket mezi kishin pritur që t'ju jepet mundësia e pranisë dhe aktivitetit të tyre në një shoqëri të dërrmuar dhe të sakatosur skajshmërisht nga presioni, dhuna dhe varfëria e skajshme, e shkaktuar nga regjimi i hekurt komunist në Shqipëri si dhe nga lufta e përgjakshme të cilën e shkaktoi politika serbo-sllave në Kosovë. Shumë individë dhe organizata

të ndryshme që vinin e instaloheshin në emër të solidaritetit nga jashtë trojeve tona, nuk hezituan të fshihnin edhe tendencën për të propaganduar besimin dhe bindjet fetare të cilat ata i përfaqësonin. Ky realitet nuk ishte i përkufizuar vetëm tek njëri besim fetar apo tjetri, por tek të gjitha fetë pa dallim. Bashkë me kafshatën e bukës e cila shumë familjeve të shoqërisë tonë i mungonte pas luftës, si dhe në tokën ende të pa tharë nga gjaku i derdhur i bijve dhe bijave tona, nën rënkime e vuajtjet e freskëta të mjerimit, këta misionarë “shpëtues” dhe këto organizata me prapavijë fetare e sektare, qytetarëve tanë, përveç dorës së ndihmës materiale, u ofronin edhe ndonjë fletushkë, libër apo CD, me përmbajtje të fesë “shpëtuese”, me qasje krejt ndryshe nga ajo që populli ynë ishte kalitur në fe shekuj me radhë. Një veprim të tillë, misionarët shpëtues e bënë me bindjen dhe perceptimin e tyre të gabuar dhe tendencioz, thuajse në këtë vend dhe në këto troje asnjëherë nuk ka pasur as fe, as fetarë dhe as prijës të saj!

Në kohën e sotme kur çdo gjë është globalizuar, sigurisht se mendimet dhe opinionet e kundërta, por as edhe risitë në emër të fesë nuk mund të kufizohen, mirëpo pyetja e cila lind nga e gjithë kjo është: “Vallë kjo qasje dhe ky investim i jashtëm me orientime dhe kahje të reja fetare e sektare në trojet shqiptare në përgjithësi dhe në Kosovën e pasluftës në veçanti, më shumë i bëri hair apo sherr shoqërisë sonë?! Përgjigjen le t’a

mendojë, analizojë dhe le ta gjejë secili në vete, por në rend të parë për këtë, le të mendojnë protagonistët dhe misionarët “shpëtimtarë”. Deri më tani qytetarët në përgjithësi nuk po shohin sinjale të hairit në këtë tundim të ri në shoqërinë tonë në emër të risive fetare sektare, të cilat shumica e tyre janë më shumë kulturë dhe fanatizma të tjerëve se sa mësim të mirëfillta shpirtërore të mbështetura në parimet bazë të besimit në Zot dhe fesë në gjenezën e saj!

Tendencat me orientime përçarëse në emër të fesë, në vendin tonë u përqendruan dhe po përqendrohen më shumë tek komuniteti musliman si grupimi më i madh fetar në vend, sesa tek të tjerët!

Mendimi i gabuar nga ana e pretenduesve dhe opinionistëve të jashtëm se gjoja muslimanët e këtij vendi dhe këtyre trojeve nuk dinë dhe nuk e njohin fenë siç ajo duhet të njihet, si dhe mosaftësia e vetë thirrësve të kësaj qasjeje të re për të bërë dallimin mes fesë në gjenezën e saj dhe doktrinave, ideologjive, kulturave dhe mësimëve fetare si prodhime të ideologëve të ndryshëm në pjesë të ndryshme të botës, të ngjyrosura me kulturën dhe traditat e vendeve nga ata vinin dhe vinë, se sa me vetë fenë dhe ajkën e saj, për shoqërinë tonë në përgjithësi ishte dhe është një qasje dhe dozë e rëndë, e cila nuk mund të pranohet dhe përpihet me lehtësi, edhe pse gjurmët e një qasjeje të tillë kanë lëshuar

rrënjë në një pjesë të shoqërisë sonë të pavetëdijshe ose të manipuluar.

Kjo prirje e paanalizuar dhe e pashoshitur nga ana e thirrësve të jashtëm, të ndihmuar edhe nga bijtë dhe bijat tona, në mesin e radhëve të komunitetit më të madh fetar musliman, më shumë ka shkaktuar huti dhe përçarje sesa unitet dhe bashkim të radhëve të tij. Kjo ndihet, shihet dhe preket tek një pjesë jo e vogël e pjesëtarëve muslimanë në hapësirën tonë. Thirrësit e trendeve të reja në emër të fesë ndoshta mund të kenë pasur qëllim të mirë, por që ata nuk e kanë marrë fare në konsideratë mentalitetin, ambientin dhe traditat e vendit tonë, është mëse e qartë.

Nëse në të ardhmen nuk zhvillohet një debat i brendshëm dhe i sinqertë me qëllim të bashkërendimit të radhëve dhe të koordinimit të ndjekjes së një rruge interpretuese të përbashkët zyrtare të prijësve fetarë të muslimanëve në vendin tonë, rreziku i një përçarjeje dhe polarizimi mes komunitetit më të madh fetar në vend do të jetë i pashmangshëm.

Liria e mendimit dhe të shprehurit në sistemin demokratik, shumë prijësve fetarë i ka dhënë mundësi dhe hapësirë që në opinion të hedhin mendime dhe qëndrime fetare, herë të drejta e herë-herë shumë të zhdrejta dhe të rrezikshme për vetë fenë që përfaqësojnë, por edhe për unitetin e përgjithshëm të besimtarëve. Ata u ndien dhe po ndihen si të paprekshëm në qëndrimet dhe deklaratimet e tyre të pamatura,

shpeshherë edhe afetare, ngase asnjëherë nuk morën kundërpërgjigje dhe reagime zyrtare profesionale të meritueshme nga institucioni më i lartë fetar në vend.

Si duket, mosdashamirët e stabilitetit tonë fetar, shoqëror dhe kombëtar, paraprkishtë e kanë studiuar mirë mundësinë e dobësimit dhe ligështimit tonë edhe përmes elementeve devijuese fetare, prandaj investimet e tyre në këtë drejtim shihen qartë se nuk kanë munguar në gjithë këto vitet e fundit në mesin tonë. Ata, përveç pykave ndarëse që mbollën dhe që po vazhdojnë të fusin në mesin e komunitetit musliman shumicë të Kosovës, sollën edhe disa ide të reja sektare fetare, të cilat për ne në të kaluarën kurrë nuk kanë qenë të njohura, dhe asnjëherë nuk janë konsideruar trunq dhe brumi i fesë të cilën e kemi kultivuar në trojet tona.

Përqendrimi në çështje dytësore para atyre qenësore dhe prioritare në emër të fesë, u përdor si forma më e lehtë e tërheqjes së vëmendjes dhe rënies në sy tek të tjerët, duke u paraqitur se gjoja këta janë pikërisht ata që e njohin fenë e vërtetë, më shumë se të tjerët!

Lëvizjet e reja fetare në vendin tonë, por edhe më gjerë në rajon, vazhdojnë të jenë të përqendruara kryesisht në çështje sekondare dhe formalitete sipërfaqësore, larg esencës, tekstit dhe boshtit të shenjtë të fesë islame. Në vend që fokusimi i tyre të jetë për Rizaa të Zotit, që do të nënkuptonte ruajtjen e unitetit fetar në shoqëri,

afrimin e njerëzve mes vete, edukimin shpirtëror dhe moral, drejtësinë, bamirësinë dhe solidaritetin e përbashkët njerëzor, ata shkaktuan dhe po shkaktojnë ndasi në mesin e vetë xhematit - ithtarëve muslimanë në rend të parë - por, edhe të tjerëve në përgjithësi. Disa shkuan deri në ekstrem, saqë edhe baballarëve e gjyshërve tanë në xhami u thoshin dhe po u thonë se “edhe forma e faljes në mënyrën që e kanë praktikuar deri sot për qindra vite me radhë, ka qenë e gabuar”!

Sipas tyre, as të parët tanë si mësues fetarë, me emër e nam që ishin, si Hafiz Ali Korça, Haxhi Vehbi Dibra, Hafiz Ismet Dibra, Hafiz Sherif Ahmeti, Mulla Idriz Gjilani, Haxhi Vesel Guta, Ferid Vokopola, Hafiz Ibrahim Dalliu etj., nuk kanë qenë njohës të mirë të fesë, sepse nyjën e besimit - “akdien” - e kanë pasur të lidhur gabimisht tek Zoti, prandaj edhe mendimet që kanë dalë prej tyre janë devijuese!

Këto veprime të tilla të pamatura, me tendencë të krijimit të fraksioneve në mesin e komunitetit më të madh fetar në vend, janë rreziku i drejtpërdrejtë dhe që ngjason me formën dhe mënyrën e njëjtë të cilën e kanë praktikuar më herët grupe të ndryshme në botën islame, duke e ndarë popullin e vet në tabore sektare fetare deri në ekstrem, rezultati i të cilave më së miri shihet edhe sot, saqë gati nuk kalon ditë e që në ato vende të mos ketë gjakderdhje e vëllavrasje mes njerëzve të pafajshëm “në emër të Allahut!”, e ku

secila palë pretendon se është më e denjë se tjetra, në praktikimin e mësimave të Tij.

Ne, në këtë pjesë të tokës së Zotit, nuk kemi nevojë për të tilla erëra e modele. Instalimi i këtyre rrymave në vendin tonë nuk mund të ketë emër tjetër veçse anarki dhe vetëvrasje, si shoqëri dhe si komb.

Njerëzit dhe shoqëritë e mençura mësojnë dhe përfitojnë nga përvojat e të tjerëve, por edhe nga gabimet e tyre, prandaj ne nuk duhet të lejojmë që modelet e të tjerëve dështuese dhe shkatërruese të përftohen e futen në funksion edhe në mesin tonë, epilogu i të cilave dihet paraprakisht.

Në emër të lirisë së shprehjes, për asnjërin prijs të çdo komuniteti fetar, nuk është e drejtë që të fyejë, cenojë apo edhe të luftojë tjetrin përmes elementeve të tij besuese dhe fetare.

Meqë qytetarët tanë në përgjithësi, me përjashtime të vogla e ndiejnë veten pjesëtarë të njëres apo tjetres fe, kurse interesimi për fenë nuk është duke u zbehur, por përkundrazi është në rritje, organizimi fetar në vendin tonë duhet të ketë adresë të qartë dhe njëherazi të ndiejë përgjegjësi para qytetarëve dhe vendit.

Mësimet, qasja dhe forma e interpretimit të mësimave fetare në mesin tonë, siç dihet është përhapur përmes Shtetit Osman dhe që nga ajo kohë, besimtarët shqiptarë të besimit islam, kanë qenë praktikues të fesë mbi medhebin hanefi, në shumicë absolute. Vazhdimësia jonë me këtë

qasje dhe këtë formë nga e kaluara jonë trashëguese, nënkupton edhe termin “Islam tradicional”, që mesa duket disa ende nuk e kanë ose nuk duan ta kenë të qartë. Islami tradicional tek ne është një vijë e mesme e praktikimit të fesë; as radikale e as ekstreme, por ofruese dhe integruese me ithtarët e vet dhe jo kërcënuese ndaj pjesëtarëve të besimeve të tjera. Kjo vijë e zhvillimit dhe interpretimit të mësimave të fesë, krahas dy burimeve qenësore, Kur’anit dhe Hadithit, për bazë dhe mbështetje ka edhe arsyen, por edhe traditën e një rrethi të caktuar të një shoqërie - *urf*-in. Kjo qasje e fesë në mesin tonë, asnjëherë mbi 500 vite me radhë e më shumë nuk ka shkaktuar përçarje në mesin e kombit tonë, por gjithmonë është treguar dhe konfirmuar si qasje e drejtë ndaj fesë, unifikuese, liberale dhe ofruese dhe jo përjashtuese ndaj dikujt, e cila edhe pjesëtarët e besimeve të tjera i pranon si pjesë të shoqërisë me të drejta të barabarta, të shprehjes së lirë, të besimit dhe të bindjes.

Islami ynë interpretues tradicional nuk nënkupton censurimin e mendimeve të të tjerëve, mirëpo përjashton çdo fraksion, çdo sekt, apo çdo orientim i cili në emër të Islamit, krahas burimeve të lartpërmendura, përdor frikën, kërcënimin, shantazhimin, imponimin apo edhe vrasjen e njerëzve, të cilët nuk mendojnë dhe nuk besojnë si ata.

## KOMUNITETI MUSLIMAN SHQIPTAR VIS-A-VIS EUROPËS

Me paraqitjen e qenies njerëzore në sipërfaqen e tokës janë paraqitur edhe dallimet gjuhësore, etnike dhe racore etj. Njerëzit edhe pse gjenetikisht janë shumë të përafërt, jo rrallë ndodh që njëri-tjetrin ta shikojnë me syrin e urrejtjes dhe armiqësisë. Ajo që ata i bënë që të mos njohin njëri-tjetrin janë disa faktorë si; egoja, largësia, mosafërsia e mjaftueshme, mosbashkëpunimi reciprok, interesat materiale, politike dhe strategjike, por edhe divergjencat e tjera si ajo etnike, racore, nacionaliste dhe fetare. Në të kaluarën, ose para më pak se një gjysmë shekulli, kontaktet dhe njohja mes njerëzve të viseve dhe vendeve të ndryshme të botës, në mungesë të mjeteve të sotme të informimit, për shumë prej njerëzve ka qenë e vështirë por edhe e pamundur. Ndërsa sot qëndron një realitet krejtësisht tjetër. Si kurrë më parë, në ditët tona mundësia e kontaktit dhe thithjes së informacioneve, qoftë edhe për imtësinë më të vogël, ekziston në formën më të lehtë të mundshme. Përmes qasjes në mjetet elektronike çdonjëri mund të mësojë për racën, përkatësinë fetare dhe kombëtare, si dhe për identitetin e kulturën të cilës i takon një bashkësi njerëzore.

Nëse kjo qasje jonë në mjetet elektronike bashkëkohore na bën të mundur që të njohim njerëzit në distancën më të skajshme të botës,

atëherë kjo mundësi para së gjithash duhet të na nxisë që ne së pari të njohim vendin tonë dhe kontinentin europian, të cilit i takojmë fizikisht dhe gjeografikisht, e pastaj edhe pjesët e tjera të botës. Kontinenti i Europës, i sotshëm, si asnjëherë gjatë historisë nuk ka qenë më i stërmbushur me diversitete të ndryshme etnike, racore, kulturore dhe fetare të popujve të ndryshëm, autoktonë dhe të ardhur si emigrantë, të cilët kanë zbarkuar në të, në kërkim të kushteve më të mira të jetës dhe punës. Me fjalë të tjera, laramania etnike, kulturore por edhe fetare është bërë sot pjesë e përditshmërisë gati në të gjitha vendet europiane, e cila dita-ditës vetëm se po rritet e po shtohet.

Vendet europiane, për dallim nga shumë pjesë të tjera, i kanë hapur dyert e solidarizimit për miliona njerëz të pjesëve të ndryshme të botës me varfëri të skajshme, në emër të humanizmit dhe të respektit ndaj qenies njeri.

Pjesë e shoqërive dërrmuese të Europës Perëndimore sot janë edhe shqiptarët, të cilët atje shkuan dekada më herët, në kërkim të punës, të strehimit dhe të sigurisë nga pushtuesit e pamëshirshëm serbë, dhe të tjerët të ikur nga persekutimi i regjimit të egër komunist e ateist në Shqipëri. Rrethanat historike, gjeopolitike dhe gjeostrategjike të një periudhe të gjatë kohore të sundimit turk në Ballkan, Azi dhe Afrikë, u bënë sebeb që pjesa dërrmuese e etnitetit shqiptar, por edhe pjesëtarë të etnitetëve të tjera të gadishullit

ballkanik si boshnjakët, goranët, ashkalitë, romët etj., që fenë islame ta pranojnë si fe të tyre shpirtërore. Identiteti i shumicës së popullit tonë shqipfolës, si pjesëtar të besimit islam, nuk është zgjedhje jona e sotme, por një realitet shumë më i hershëm, i trashëguar nga të parët tanë disa shekuj me radhë. Përkatësia fetare islame e shqiptarëve historikisht nuk është treguar se ka qenë pengesë e ruajtjes edhe të vlerave tona kombëtare.<sup>1</sup> Madje, shumë historianë dhe analistë vendas dhe ndërkombëtarë elementin islam te shqiptarët e shohin edhe si mjet të fuqishëm të mbrojtjes nga sllavizimi dhe asimilimi kombëtar. Ndërsa, rastet e rralla të diskriminimit në emër të fesë i konsiderojnë si përjashtuese apo të izoluar, të cilat nuk merren si argumente të një qëndrimi të përgjithshëm të Shtetit Osman karshi komuniteteve jomuslimane të asaj kohe.

Tani, në periudhën e sotme kohore në të cilën po jetojmë, përkatësisht fillimi i shekullit 21, kur shumë rrethana në shkallë globale kanë ndryshuar, e sidomos rritja e fobisë ndaj Islamit dhe muslimanëve, dikush edhe mund të parashtrojë pyetjen se, cila do të jetë e ardhmja jonë, e ardhmja shqiptare në Ballkan dhe Europë?! A mund të shihet apo edhe të komentohet në qarqe të ndryshme përkatësia

---

<sup>1</sup> Të këtij mendimi janë edhe disa studiues të huaj të historisë shqiptare si: Tomas W. Arnold, Roberto Morocco della Roka etj.

fetare me shumicë muslimane e shqiptarëve si rrezik për të ardhmen e Ballkanit dhe Europës?!

Këto janë disa nga pyetjet dhe shqetësimet që janë lakuar dhe po lakohen kohë pas kohe nga disa intelektualë brenda dhe jashtë kufirit e rajonit tonë, por edhe në qarqe vendimarrëse të rëndësisë së veçantë.<sup>1</sup>

Mirëpo, përgjigjja për këtë shqetësim është se vendet perëndimore nuk kanë se çfarë të frikësohen dhe brengosen nga elementi islam i kultivuar tradicionalisht tek shqiptarët, i cili në këto troje u praktikua shekuj me radhë duke mos krijuar rrezik dhe kërcënim për asnjë komunitet tjetër në baza dhe bindje fetare<sup>2</sup>. Shqiptarët ditën të jetojnë me muslimanin, me ortodoksin, me katolikun, me çifutin e të tjerë. Islami në parimet e tij autentike nuk ka zhvilluar dhe nuk zhvillon politikë të ndarjes, largimit dhe anatemit, por

---

<sup>1</sup> Propaganda serbe ka qenë ajo e para që, jo vetëm tani pas shpalljes së pavarësisë por edhe më herët, përbërjen e popullsisë së Kosovës me shumicë të besimit islam, është munduar ta paraqesë si rrezik dhe kërcënim para opinionit europian dhe qarqeve vendimarrëse. Me këtë propagandë të pabazuar, shteti dhe politika serbe ka synuar dhe synon edhe sot që në këtë çështje të fitojë simpatinë dhe përkrahjen e vendeve perëndimore, kinse në Kosovë ajo ka luftuar dhe po lufton për të mbrojtur jo vetëm interesin e vet, por edhe të botës së krishterë në Europë, nga fundamentalistët islamikë të cilët mund të zhvillohen e rriten në Kosovë!

<sup>2</sup> Edhe sistemi i milletit osman i kishte dhënë të drejtën të gjithë komuniteteve fetare që të vetorganizohen nën mbrojtjen dhe sigurimin e qeverisë osmane.

zhvillon filozofi të afrimit dhe integritit. Prandaj, edhe hebrenjtë që ndiqeshin e persekutoheshin nga nazistët dhe grupe të tjera fanatike fetare në Europë, gjetën strehim tek shqiptarët muslimanë e të krishterë.

Shqiptarët asnjëherë, askënd nuk e cenuan dhe nuk e rrezikuan në emër të fesë, sepse që herët qenë të frymëzuar se jeta, pasuria dhe nderi i çdo njeriu është gjë e shenjtë e cila duhet të ruhet dhe të mbrohet.

Në media të ndryshme botërore, vitet e fundit është folur për disa lloje të Islamit; si Islami arab, Islami shi'it, Islami europian, Islami turk, Islami shqiptar, Islami aziatik etj. Në fakt, një përcaktim i tillë i Islamit nuk është shkencor, sepse Islami si fe hyjnore, i bazuar në dy elementet e tij kryesore, Kur'an dhe Hadith, është një dhe i vetëm. Kurse, është e vërtetë se forma e interpretimit të mësimave të Islamit ka dalluar dhe dallon edhe tani prej një vendi në tjetrin, prej një periudhe kohore në një periudhë tjetër. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se ne kemi të bëjmë me një Islam të dytë apo të tretë. Në fakt kemi të bëjmë vetëm me një interpretim dhe qasje ndryshe. Dallimi në interpretime nuk vjen nga Islami por nga njerëzit, të cilët ndjekin shkolla dhe drejtime të ndryshme fetare në emër të tij, përkatësisht nga mënyra të cilës ata i qasen studimeve të Islamit. Gjithashtu, dallimet në interpretime vijnë edhe si nga niveli arsimor, intelektual dhe pranues i tyre, por edhe nga ndikimi i rrethanave dhe ambientit në të cilin

ata jetojnë dhe veprojnë. Këta janë disa faktorë që kanë ndikuar dhe ndikojnë drejtpërdrejt në këndvështrimet e ndryshme që studiuesit (teologët) mund t'i kenë ndaj Islamit, zakonisht rreth çështjeve dytësore të tij.

Përshtatshmëria e disa porosive dhe mësimëve islame, që kryesisht kanë të bëjnë me gjendjen shoqërore dhe sociale të një vendi të caktuar, ka qenë praktikë që nga koha e Muhammedit a.s., dhe gjeneratës së tij të parë, kurse elementi që e ka përcaktuar më së shumti një elasticitet të tillë të udhëzimeve fetare ka qenë tradita dhe zakoni, i njohur në literaturën islame si *Urfi*<sup>1</sup> i një vendi dhe një populli, i cili si i tillë është konsideruar dhe konsiderohet pjesë e legjislacionit (të drejtës) sheriatik.

Sot në mesin e shqiptarëve ka kuadro që kanë arritur shkallën më të lartë akademike në studimet fetare islame, të cilët mund të japin kontributin pozitiv në orientimin e drejtë të besimtarëve muslimanë në trojet shqiptare, por edhe më gjerë, në Europë e në botë.

Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, me një traditë mbi 20 vjeçare, është institucioni më i lartë fetar në Kosovë, i cili meriton të mbështetet nga instancat e larta zyrtare të vendit për rolin kyç që ka luajtur në sferën fetare dhe kombëtare, rol ky që mund të vazhdojë të jetë i fuqishëm

---

<sup>1</sup> Me termin **URF-i**, në legjislacionin sheriatik nënkuptohen traditat, zakonet, rrethanat shoqërore dhe mentaliteti i një populli ku jeton e vepron.

edhe më tej. Përkrahja e këtij institucioni arsimor nënkupton edhe përkrahjen e drejtpërdrejtë të mënyrës dhe formës së interpretimit të Islamit, e cila në të ardhmen tonë duhet të zhvillohet dhe kultivohet nga njerëz intelektualë dhe akademikë shqipfolës që e duan të mirën e fesë dhe të vendit. Shqipëria po ashtu ka bërë një hap tejet të qëlluar së fundmi me themelimin e universitetit “Bedër”, i cili do të jetë në shërbim të vendit dhe shoqërisë për të edukuar gjeneratat e ardhshme nga bijtë dhe bijat e vendit tonë shqipfolës.

Duke parë rëndësinë e prodhimit të kuadrove vendas në fushën e studimeve islame, Gjermania si dhe vendet e tjera europiane, së fundmi kanë themeluar dhe janë në themelim e sipër të fakulteteve dhe departamenteve islame në kuadër të universiteteve më të njohur që kanë, si Tübingen, Osnabrück, Frankfurt, Vjenë etj.

Në kuadër të kontinentit të madh europian, si pjesëtarë të fesë islame që jemi, në krahasim me numrin e pjesëtarëve të krishterë ne konsiderohemi pakicë<sup>1</sup>, mirëpo kjo pakicë muslimane në Ballkan, përkatësisht në Europën Juglindore, është autoktone, është pjesë e shoqërisë së gjerë europiane shumëshekullore, e cila duhet trajtuar njësoj me gjithë qytetarët e tjerë pa dallim.

---

<sup>1</sup> Sipas statistikave të fundit, numri i përgjithshëm i muslimanëve në gjithë kontinentin europian nuk kalon më shumë se 5-6%, kurse në Ballkan - Europën Juglindore arrin deri në 14%.

Fetë kryesore që dominojnë tani në Europë, që të gjitha e kanë burimin në Lindje, e jo në Perëndim. Prandaj, nëse tri fetë qiellore monoteiste burojnë nga e njëjta pjesë e botës, atëherë është e drejtë dhe e rrugës që të gjitha të shikohen dhe trajtohen në mënyrë të barabartë, sepse vetëm forma e trajtimit të njëjtë të të gjitha feve do të jetë rruga garantuese e përhershme e paqes dhe harmonisë afatgjatë në Europë, por edhe jashtë saj.

Është shumë e dhimbshme kur dëgjon se njerëzit ende shtypen dhe vriten në emër të fesë nëpër pjesë të ndryshme të botës.

Prijësit fetarë shqiptarë nuk duhet të lejojnë që të bien pre e asnjë ideologjie, shkolle apo fraksioni të huaj, që dëmton interesin tonë të përgjithshëm kombëtar. Ata gjithmonë duhet të jenë të vetëdijshëm për kontekstin kohor dhe hapësinor në të cilin jetojnë.

## **Islami është mbi elementet fanatike dhe adetet çoroditëse të fiseve dhe popujve të ndryshëm**

Mesazhi i fesë islame, si edhe i feve të mëhershme ibrahimite (abrahamike), ka pasur dhe ka karakter global (ndërkombëtar). Globaliteti i Islamit vërtetohet edhe në tekstet e shumta kur'anore, përmes së cilëve adresohen të gjithë njerëzit e kësaj bote, pa dallim race, kombi apo etnie. Islami nuk është përkufizuar ndonjëherë dhe nuk mund të përkufizohet as sot, si një fe lokale ose provinciale. Ndryshe, një epitete të tillë e kanë pasur edhe fetë e mëhershme qiellore ibrahimite, ithtarët e të cilave kanë qenë dhe janë edhe sot pjesëtarë të racave dhe kombeve të ndryshëm nga të gjitha anët e globit.

Edhe dy perandoritë e hershme, ajo romake dhe bizantine, janë identifikuar me fetë, të cilat burimin e kanë pasur në Lindjen e Mesme, mirëpo, ithtarët, ushtarët dhe qeveritarët e tyre nuk kanë qenë vetëm banorët e Lindjes, por pjesëtarë të çdo lloj kombi e vendi të ndryshëm, përfshirë edhe pjesët e Europës së sotme. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me Islamin, ithtarët e të cilit nuk kanë qenë të përkufizuar dhe të zgjedhur të një kombi apo rrethi.

Nga vetë përcaktimi “fe qiellore dhe monoteiste”, kuptohet edhe qëllimi i saj universal e global. Si rrjedhojë e këtyre fakteve të sipërpërmendura, asnjë njeri, asnjë grup shoqëror

ose popull apo komb i caktuar, nuk mund të ketë monopol mbi fenë e cila gëzon karakterin hyjnor, sepse ajo është për të gjithë dhe mbi të gjithë, dhe buron nga një Zot i Vetëm. Islami është vula e mesazhit hyjnor dedikuar njerëzimit. Pas shpalljes hyjnore të Islamit, muslimanët besojnë bindshëm se nuk do të ketë më shpallje tjetër, dhe as peygamberë të tjerë. Kur'ani besohet si vulë e të gjitha shpalljeve, derisa jeta njerëzore të marrë fund në sipërfaqen e Tokës.

Feja islame, si bosht dhe parim të saj kryesor ka formimin e individit mbi tiparet dhe virtytet e larta etiko-morale dhe njerëzore, duke e mbajtur e ruajtur atë, që të qëndrojë brenda natyrës krijuese **humane-insan**, e të mos dalë jashtë saj në të gjallë të tij gjatë jetës në këtë botë. Prandaj, në mënyrë që ai të mos hamendet në përzgjedhjen e një fuqie absolute, Islami i bënë të qartë njeriut se besimi në një Zot të Vetëm, Krijues të tij dhe të gjithësisë, është besimi i drejtë dhe i shëndoshë, dhe se çdo besim dhe perceptim tjetër ndaj Zotit të gjithësisë është jo i drejtë.

Duke besuar Zotin si fuqi absolute në univers, dhe duke besuar në ballafaqimin me Ditën e Gjykimit, njeriu në brendësinë e tij, krijon bindjen e brendshme se për veprimet dhe bëmat e tij në këtë jetë, të fshehta ose publike, të vogla apo të mëdha, përveç tij dhe njerëzve përreth, i sheh dhe i regjistron edhe Krijuesi, të Cilët nuk mund t'i shmanget asgjë e të mbetet e paevidentuar, qoftë edhe lëvizja e grimcës më të vogël se atomi.

Me ngulitjen e këtij besimi në thellësinë e tij shpirtërore, njeriu do matet dhe do të studiojë gjithnjë, paraprakisht sjelljet dhe veprimet e tij në jetë, kudo që ai mund të ndodhet; në familje, në vetmi, fqinjësi, shoqëri, në shtet, si dhe gjetiu.

Lajmet e publikuara në uebsajtet informative dhe në gazeta lokale e ndërkombëtare, ku paraqiten ngjarje të pazakonta si ajo në Somali, përmes së cilave shihet një ambient i mbyllur me fëmijë, këmbët e të cilëve ishin lidhur me zinxhir për të mos i lënë të dalin jashtë objektit, derisa të indoktrinohen plotësisht për të marrë aksione vetëvrasëse ndaj “pabesimtarëve perëndimorë”, në emër të “Islamit”, është shqetësuese për opinionin musliman dhe më gjerë!

Një pamje e tillë e shëmtuar dhe aq e dhimbshme, por edhe të tjera të mëhershme, si ajo e një vrasjeje makabre me pushkë automatike të një gruaje të mjerë afgane nga një grup “burrash” me bindje talibane, gjoja në emër të ruajtjes e mbrojtjes së moralit dhe nderit në Afganistan, e paraqitur në mediat më të mëdha botërore si CNN dhe BBC, që tronditi gjithë botën, e më vonë dhe akti tjetër i një të tërbuari pakistanez që i kishte prerë hundën gruas së tij, në shenjë ndëshkimi për padëgjueshmërinë e saj, dhe shumë veprime të tjera makabre si vrasjet e vajzave në emër të nderit, ndalimi i ngasjes së automjetit motorik për gra, fyerja dhe vrasja e njerëzve në pabesi, e shumë ngjarje të tjera të ulëta për vetëdijen normale njerëzore që kanë

ndodhur dhe mund të ndodhin në mesin e shoqërive muslimane, përgjithësisht, asnjëra prej tyre nuk mund të lidhet a ndërlidhet me Islamin dhe themelet e tij bazë<sup>1</sup>. Veprat e liga, padrejtësitë dhe zullumi - veprimet mizore, ndodhin në mesin e shoqërive që kanë edukatë, mentalitet dhe arsimim të nivelit minimal, si dhe dominim të fanatizmit të tepruar dhe varfëri të tepërt.

Islami është larg çdo veprimi dhunues që mund të ushtrohet ndaj dikujt padrejtësisht. Drejtësia, butësia dhe humanizmi janë kërkesa dhe porosi të tij, qoftë edhe ndaj armikut në kohë lufte, e lëre më ndaj njerëzve në ambient të paqes dhe lirisë. Mësimet burimore islame, janë kundër çdo veprimi të shëmtuar, i cili bie ndesh me natyrën krijuese të njeriut dhe shpirtin e çiltër të tij.

Islami nuk lidhet me fanatizmat dhe adetet e çoroditura të asnjë populli, përkundrazi, ai i kundërshton dhe lufton ato në mënyrë të prerë dhe të drejtpërdrejtë. Çdo akt jo human, çdo padrejtësi dhe mizori ndaj kujtdo qoftë, është në kundërshtim me parimet bazë të Kur'anit dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë të mësimave dhe burimeve autentike të tij.

---

<sup>1</sup> Raste abuzive ndaj gjinisë femërore ndodhin edhe në botën perëndimore, por në forma dhe mënyra të ndryshme, të cilat nuk lidhen në emër të fesë. Sipas një statistike të fundit rreth 1/3 e femrave në kontinentin europian përjetojnë dhunë nga burrat e tyre.

Veprimet e njerëzve mbi bazën e ideologjive të shpikura nga ideologë të ndryshëm, me qëllime politiko-fetare të një kohe dhe vendi të caktuar në botë, janë të devijuara dhe nuk përkojnë me Kur'anin dhe traditën e bekuar të të dërguarit të Zotit xh.sh., Muhammedit a.s..

Islami askund dhe asnjëherë nuk mëson se si t'i urrejmë, përbuzim ose vrasim njerëzit. Përkundrazi, ai na mëson për formën dhe mënyrën se si t'i afrojmë ata, me butësinë dhe urtësinë më të mirë të mundshme. Abuzimi me fëmijë të moshës së njomë, ose shkelja e të drejtave të femrës, duke u thirrur në Zot, janë sjellje në kundërshtim të plotë me mësimet dhe fenë e Tij. Në të tilla raste asnjëherë nuk kemi të bëjmë me Islamin si fe, por me keqpërdorimin, abuzimin dhe devijimin e tij, në mënyrë të qëllimshme, me vetëdije apo jo.

Besimi në Zotin, në bazë të imitimit të verbër, është i predispozuar të jetë i çalë, sepse si i tillë nuk është ngulitur mbi bazën e studimit, arsyes, analizës dhe bindjes së shëndoshë. Asnjë adet i shëmtuar e i çoroditur, si dhe asnjë element fanatizmi, i cili mund të gjendet në mesin e shoqërive muslimane, nuk mund të ndërlihet dhe t'i atribuohet Islamit burimor, qoftë arab, pakistanez, indian, afgan, indonezian, turk, shqiptar apo tjetër.

Feja islame duhet të besohet dhe kultivohet mbi burimet e saj dhe mbi studimet dhe interpretimet e studiuesve, që nuk bien në

kundërshtim me parimet dhe themelet kryesore dhe autentike të mesazhit hyjnor - *Er-rişaletu es-semavije*.

## **Pse ndodhin vrasje të njerëzve të pafajshëm në emër të “Islamit”?**

Shpërthimet e njëpasnjëshme në qendra të mëdha botërore; Nju Jork, Xhakartë, Stamboll, Madrid, Londër, Amman, si dhe në shumë pjesë të tjera të planetit tonë, të planifikuara dhe të ekzekutuara nga qarqe të errëta, janë aktet më të ulëta që mund t'i planifikojë dhe ndërmarrë qenia e quajtur njeri. Të gjuash gurin dhe të fshehësh dorën është hipokrizia dhe gjesti më i ulët i mundshëm, i cili nuk mund të justifikohet nga asnjë njeri që ka ndjenja dhe shpirt njerëzor. Të vrasësh njerëz të pafajshëm, me paramendim, është krimi më i madh që mund të bëjë njeriu në të gjallë të tij. Më e keqja e gjithë kësaj është se këto shpërthime vrastare janë duke u ndërlidhur me grupe njerëzish që thërrasin në emër të Islamit dhe muslimanëve.

Islami dhe parimet e tij themelore janë larg veprimeve të tilla dhe larg këtyre njerëzve, që veten e quajnë praktikues “të denjë” të Islamit, sepse në gjithë historinë e mësimave islame nuk mund të hasim në argumente që lejojnë akte të tilla të liga dhe tinëzare, përmes të cilëve targetohen njerëz të pafajshëm, qoftë kalimtarë rasti ose ahengu. Në Kur'an, si burim i parë i Islamit, dhe në Hadith si burim i dytë i tij, askund nuk është e shënuar dhuna dhe mizoria si mjete të përdorura ndonjëherë, ndaj kujtudo qoftë, në

kohë paqeje apo jashtë mejdanit - frontit të luftës së drejtpërdrejtë me armikun.

Muhammedi a.s., transmetuesi, shpjeguesi dhe komentuesi i parë i Kur'anit, kur shokët e tij shkonin në luftë, i këshillonte me sa vijon: *“Mos mbytni fëmijë, gra, pleq, të pafajshëm, mos shkatërroni kisha, sinagoga, e mos shkulni as drunjtë e njomë...”*

Muhammedi a.s., ka pasur respekt ndaj njeriut pa dallim, e ka vlerësuar atë si krijesë të çmuar dhe të dalluar nga Zoti. Një qëndrim i tillë në fakt ka qenë edhe në përputhje me parimet e shpalljes kur'anore, sepse në citatet e tij Kur'ani e pranon gjenezën njerëzore si një dhe unike! Të gjithë njerëzit janë bijë të Ademit dhe Havës. Nëse respekti i Muhammedit a.s., ndaj pjesëtarëve të besimeve të tjera fetare ka qenë në nivel të lartë, atëherë sjelljet e tij ndaj pjesëtarëve të vet kanë qenë edhe më të afërta dhe më të qëndrueshme.

Aktet e bombave tinëzare që vrasin fëmijë, gra, pleq e plaka, qoftë edhe të besimit islam janë veprime fundërrinore dhe makabre të brejtësve të vlerave fetare, humane dhe njerëzore.

Në të gjitha rastet e shënuara deri sot, nga këto shpërthime masive vrastare, viktimë kanë qenë njerëzit e pafajshëm, të cilët nuk kanë përgjegjësi, vendimarrje apo ndikim për ndryshimin e çfarëdo situate në nivel lokal apo global.

Pa marrë parasysh rrethanat politike, gjeostrategjike, qoftë edhe lufta e drejtë që mund të zhvillohet ndaj armikut, asnjëherë nuk mund t'i justifikojmë vrasësit e të pafajshmëve.

Nëse dikush gjen fuqi të arsyetojë veprimet e tilla makabre, duhet t'a kuptojë se Islami dhe parimet e tij i kundërshtojnë dhe mohojnë këto veprime dhe mendime në mënyrë të fuqishme dhe të prerë, për faktin se ato bien në kundërshtim të drejtpërdrejtë me vetë Kur'anin dhe traditën e Muhammedit a.s..

Nëse grupet e tilla "islame" mendojnë se janë duke i kontribuar interesave politike të muslimanëve, dhe se janë duke çuar ujë në mullirin e tyre, e kanë tepër gabim. Me planifikimin dhe ekzekutimin e hapave të tillë, ata Islamit dhe muslimanëve janë duke i dhënë një imazh dhe pasqyrë të keqe në gjithë botën. Opinioni botëror, pas ngjarjeve të 11 Shtatorit e deri në ngjarjet e fundit të cilat po ndodhin kohë pas kohe, ka fituar një përshtypje negative ndaj Islamit dhe muslimanëve në përgjithësi, duke i paraqitur muslimanët në masmediat e përditshme të tyre si njerëz të egër, të tmerrshëm, vrasës të pamëshirshëm, të pashpirt, jo civilizues e mosdurues ndaj pjesëtarëve të besimeve të tjera fetare etj..<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Mbi këtë sjellje joadekuate të "muslimanëve" përgjithësisht, në "fjalorin" botëror është shtuar edhe një fjalë e re, islamofobia, që nënkupton frikën ndaj Islamit. Në fakt islamofobia nënkupton një paragjykim apo urrejtje nga frika irracionale kundër Islamit dhe muslimanëve. Nga psikologët islamofobia cilësohet si frikë ngjethëse dhe e fortë. Më 1997, britaniku Runnymede Trust e ka përcaktuar islamofobinë si frikë apo urrejtje të Islamit, përkatësisht, frikë dhe mosdashje të të gjithë muslimanëve. Ndërsa

Gjithashtu edhe paraqitja e të rrëmbyerve jomuslimanë, nën tytën e armëve të “muxhahidinëve”, në masmediat televizive botërore, është e pajustificueshme në aspektin human, dhe për më tepër gjë e ndaluar rreptësisht në etikën dhe moralin islam. Mësimi fetar islam kërkon nga njeriu që të jetë i mëshirshëm dhe i kujdesshëm, qoftë edhe ndaj kafshës, e lëre më ndaj njeriut që është krijesa më e shtrenjtë e Zotit në tokë. Sipas etikës islame ndalohet qoftë edhe shfaqja e mjetit therës me rastin e therjes së kafshës, e si do të mund të lejohej shfaqja e armës ndaj njeriut, të pajisur me intelekt, logjikë dhe vetëdije e ndjenjë të plotë për hapësirën dhe ambientin në të cilën jeton dhe vepron.

Të gjitha instancat më të larta të kreut fetar islam në botë, sjelljet e tilla i kanë gjykuar dhe i gjykojnë me gjuhën dhe fjalorin më të ashpër të mundshëm. Shejhul Ez-her, gjatë bombardimit të Qendrës Tregtare Botërore në Nju Jork dhe Pentagon, më 11 Shtator të vitit 2001, pati lëshuar deklaratën e tij si vijon: *“Të vrasësh burra, gra dhe fëmijë të pafajshëm është akt i tmerrshëm dhe i urryer që asnjë besim monoteist jo vetëm që nuk e përkrah, por edhe e dënon pa mëshirë”*.

---

studiuesi Steven Vertovec thotë se një prirje e perceptuar e islamofobisë në rritje është vërejtur sidomos gjatë viteve 2000. Sido që të jetë, muslimanët janë ata që po pësojnë në çdo mënyrë nga këto sulme alogjike, vrastare dhe pa dyshim, antiislame.

Prandaj, nga gjithë ajo e cila u theksua më sipër, rezulton se aktet e tilla, kurrsesi nuk mund të ndërlidhen me Islamin dhe as me muslimanët e devotshëm, të cilët janë pasues të vërtetë dhe të drejtë të Kur'anit dhe traditës së Muhammedit a.s.. Të gjithë ata që mbysin njerëz të pafajshëm, kalimtarë të rastit, dasmorë të hotelit, punëtorë të bankave, duke mos përjashtuar moshën, gjininë dhe përkatësinë fetare e kombëtare të tyre, nuk mund të quhen njerëz në kuptimin human, ndërsa më së paku mund të quhen muslimanë!

## **A duhet të ketë ndonjë zyrë për adresimin e çështjeve fetare islame tek ne?**

Njerëzit kudo në vendet dhe ambientet demokratike janë të lirë të mendojnë dhe shprehin lirisht atë që ndiejnë në brendësinë e tyre deri në kufijtë e caktuar dhe të sanksionuar me ligj. Laramania dhe diversiteti i mendimeve të njerëzve është i vjetër aq sa është i vjetër edhe vetë njerëzimi. Edhe në fe, mendimet e dijetarëve dhe studiuesve në çështje të shumta dytësore islame nuk kanë qenë dhe nuk janë as sot identike. Si rezultat i mendimeve të ndryshme, dhe kundër mendimeve të studiuesve, në botë kanë lindur sektet dhe grupimet e shumta fetare islame. Prandaj, nisur nga ky realitet ekzistues mbi llojllojshmërinë e mendimeve fetare në emër të Islamit, është mirë që çdo komunitet fetar i një vendi të ketë një qendër ose një adresë në të cilën do të mbështetej masa e gjerë, e cila në një formë apo tjetër, do të kontrollonte dhe parandalonte devijimet e mundshme të mendimeve të individëve apo grupeve jo profesionale që mund të thirren në emër të fesë. Kjo do të ndihmonte në unifikimin e mendimeve dhe opinionëve në të mirë të një komuniteti fetar në rend të parë, por edhe më gjerë. Edhe në Kosovë si dhe në trojet shqiptare duhet të jetë e qartë adresa zyrtare për adresimin e çështjeve fetare të muslimanëve, që në këtë rast do të duhej të ishte Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), e cila është institucioni kryesor

fetar për çështjet e muslimanëve në Kosovë. Vitet e fundit, kjo bashkësi fetare, në mungesë të aktivitetit të saj të duhur për të qenë sa më afër besimtarëve të vet dhe më afër kërkesave të tyre, i ka hapur rrugën fetvave dhe deklaratave të pamatura të shumë individëve, të cilët kanë shkaktuar dhe po shkaktojnë huti në opinionin e gjerë të besimtarëve muslimanë të Kosovës dhe më gjerë pa asnjë nevojë.

Çështjet islame me peshë, janë detyrë e studiuesve të mirëfilltë të cilët duhet të jenë prijës të proceseve islame në trojet tona, e jo individët, të cilët nën ndikimin e emocioneve dhe acarimeve të rastit, larg arsyes së shëndoshë, marrin hapa që jo rrallëherë rezultojnë të jenë të gabueshëm dhe të dëmshëm, si për fenë ashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi. Nëse shteti nuk mbështet dhe nuk e zyrtarizon pozitën juridike të Bashkësisë Islame të Kosovës në rrethana të reja të krijuara në vend, dhe nuk e njeh si adresë zyrtare të komunitetit musliman në Kosovë, atëherë, kështu si kanë rrjedhur ngjarjet në këto vitet e pasluftës, gjërat do të dalin nga binarët dhe pastaj do të jetë shumë vonë që ato të kthehen në normalitetin e tyre.

Prandaj, për të mirën e të gjithëve, tek ne duhet të ketë një derë zyrtare, kryesore dhe permanente për interpretimin e çështjeve të fesë islame si instanca më e lartë profesionale. Një adresë e tillë, e njohur edhe nga besimtarët, do të ndihmonte në ruajtjen e paqes dhe harmonisë fetare në vend

dhe rajon, duke garantuar njëherazi edhe një bashkëjetesë afatgjatë për të gjithë qytetarët pa dallim përkatësie fetare.

Orientimi i besimtarëve muslimanë, shumicë të vendit tonë, mbi baza shpirtërore të shëndosha, nënkupton edhe orientimin e të ardhmes së vendit tonë. Ndryshe, neglizhenca jonë në këtë drejtim, do të hapë derën e individëve dhe organizatave të huaja që të merren me interpretimin e fesë në forma të ndryshme, nën bindje fetare jo adekuate për Islamin në rend të parë, por jo edhe të pajtueshme për vendin dhe rrethanat tona specifike; fetare, shoqërore dhe kulturore. Të tillët do të bëjnë edhe gara që të dominojnë e të krijojnë mjegullina e destabilitet të mendimeve dhe opinioneve, të cilat në mënyrë të pashmangshme do të dëmtojnë ndjeshëm të ardhmen e shoqërisë në përgjithësi. Riorganizimi i Bashkësisë Islame, si dhe i komuniteteve të tjera muslimane në rajon për të pasur një pasqyrim të qartë të vizonit të tyre karshi opinionit, është i domosdoshëm për kohën në të cilën jetojmë, dhe garanci për stabilitetin dhe unitetin e besimtarëve muslimanë në trojet tona shekullore.

## **Xhamia, faltoret dhe pesha e fjalës publike**

Xhamitë dhe faltoret janë vende ku besimtarët muslimanë mblidhen për t'u lutur bashkërisht. Gjatë gjithë historisë, e deri më sot, xhamia nuk ka luajtur rolin e vetëm të një objekti kulti, por gjithmonë ka qenë edhe në përgjegjësinë e një institucioni fetar edhe arsimor, por edhe kulturor, i cili krahas adhurimit ndaj Zotit që është bërë në të, si detyrë primare që ka pasur, rol të rëndësishëm ka luajtur edhe për jetën dhe orientimin e besimtarëve muslimanë në përditshmërinë e tyre. Përmes xhamisë njerëzit janë ftuar të jenë në shkallën e duhur të sjelljes dhe etikës morale, të jetojnë në harmoni me mësimet e Zotit, dhe të mos tejkalojnë kufijtë e natyrës njerëzore mbi të cilën natyrë ata janë krijuar. Qëllimi i xhamisë ishte dhe vazhdon të jetë thirrja e njerëzve në besimin në një Zot, në kultivim të dashurisë mes njerëzve, në drejtësi e sinqeritet, solidaritet e devotshmëri.

Imami<sup>1</sup> i xhamisë është një person i autorizuar nga organet e larta fetare për të qenë prijës i besimtarëve në lutje, mësues i fesë, si dhe përgjegjës për shërbimet e tjera të përditshme fetare që kanë besimtarët. Krahas kultivimit të besimit në xhami, imami duhet të punojë paralelisht edhe në ngritjen e virtyteve etiko-morale të besimtarëve. Imami si prijës i

---

<sup>1</sup> Imam është shprehje që i përgjigjet fjalës tonë: prijës, udhëheqës, mësues etj.

besimtarëve të xhematit të xhamisë dhe më gjerë është një person i rëndësishëm dhe me peshë në mesin e besimtarëve muslimanë, i cili para se të vendosë të marrë këtë përgjegjësi, duhet të jetë në nivel të duhur të edukatës, arsimimit dhe të etikës, cilësi dhe virtyte këto të domosdoshme të një prijësi të mirëfilltë të fesë.

Prandaj, duke u nisur nga kjo peshë e madhe ndikuese në publik, çdo ligjërues që del në ballë të oxhakut, ose në krye të vendit, për t'i ftuar njerëzit në mësim fetar, duhet të ketë parasysh peshën e përgjegjësisë, dhe të jetë i ndërgjegjshëm për të gjithë atë që nxjerr nga goja, sepse çdo fjalë e tij zë vend të veçantë tek njerëzit besimtarë. Parapërgatitja për ligjërime para masës së njerëzve është domosdoshmëri për një imam të vetëdijshëm dhe të ndërgjegjshëm për vendin dhe rrethanat në të cilat jeton.

Ajo që duket jo pak brengosëse, tek një pjesë e prijësve të xhamive tona në vitet e fundit është mënyra dhe metodologjia e ligjërimit, e cila shihet qartë se është në kundërshtim me etikën dhe disiplinën islame të rregullit dhe rendit në xhami<sup>1</sup>. Gabimi më i madh që bëjnë disa nga

---

<sup>1</sup> Në shumë vende të botës islame si: Turqi, Indonezi, Bosnje e Hercegovinë, dhe së fundi edhe në Shqipëri, kryesuesit e fesë, që janë përgjegjës dhe udhëheqës të komunitetit musliman, kohë pas kohe organizojnë seminare dhe trajnime informative dhe edukative për imamët e tyre. Këto seminare kanë për qëllim vetëdijësimin dhe kontrollimin e punës dhe aktivitetit që ushtrojnë ata gjatë punës së tyre.

imamët në trojet tona është imitimi ose huazimi i metodologjisë së huaj gjatë ligjërimit, ose mosmarrja fare parasysh e veçantive të masës së pranishme që i drejtohen. Disa e kanë bërë zakon të qajnë me zë të lartë para xhematit, gjë që është e mundshme dhe e natyrshme të ndodhë ndonjëherë, sepse është normale që njeriu gjatë ligjërimit edhe mund të ngacmohet shpirtërisht dhe emocionalisht, në momente dhe raste të caktuara, mirëpo nuk është e hijshme dhe e pranueshme kur qarja me zë ripërsëritet shumë herë dhe kalon në rutinë të përhershme për një prijës fetar. Në anën tjetër, disa të tjerë ngrejnë zërin jashtë përmasave të ligjëruesit normal, shpeshherë edhe duke u betuar se atë që janë duke thënë është një e vërtetë që nuk pranon alternativë tjetër, kurse ca të tjerë, në ligjërimet dhe kuvendet e tyre nënçmojnë të gjithë ata të cilët nuk pajtohen me mendimin e tyre, duke menduar se vetëm ata janë më meritoret në propagandimin e drejtë të fesë dhe praktikuesit më të sinqertë të saj.<sup>1</sup> Këto forma, janë qasje të gabuara që nuk përkojnë me mësimet e mirëfillta të historisë së thirrjes islame, as në vendin tonë e as gjetiu. Si të tilla, në mungesë të vetëdijes për vendin dhe rrethanat në të cilat jetojmë si shoqëri, këto metoda më shumë po shkaktojnë huti në mesin e besimtarëve sesa po japin dobi e begati.

---

<sup>1</sup> Studiuesi i mirëfilltë i mësimave fetare islame asnjëherë nuk pretendon se i di të gjitha çështjet e fesë, sepse ai është i vetëdijshëm se dija dhe shkenca janë det pa brigje.

Masa jonë e rëndomtë nuk është në gjendje të vlerësojë gjithë atë që thotë një prijës i xhamisë, sidomos nëse ai nuk flet me gjuhën dhe nivelin intelektual e arsimor që kanë të pranishmit.

Pikërisht për arsyt e sipërthëna, ligjëruesi në xhami dhe jashtë saj duhet të jetë i ndërgjegjshëm për mënyrën se nga po e drejton masën,<sup>1</sup> përkatësisht xhematin e tij. Fjalët që ai thotë duhet të jenë të mbështetura në parimet islame, në logjikë dhe arsye të shëndoshë, e jo të flasë përmendsh, ose të huazojë mendime dhe ide të gatshme të të tjerëve, pa i analizuar dhe pa bërë krahasime të mjaftueshme nga literatura e përgjithshme fetare.

Masa e gjerë mund të mos i ketë të njohura detajisht mësimet islame, por ajo është në gjendje të vlerësojë atë që thuhet nga ana e predikuesve dhe të gjykojë se është apo nuk është e bazuar në burimet reale të Kur'anit dhe traditës së Pejgamberit a.s., si dhe në argumentet logjike e racionale në përgjithësi.

Në këtë kontekst vlen të theksohet edhe thënia e një studiuesi të mirëfilltë të Islamit nga trevat tona arbërore, H. Ef. Sali Ferhatit, i cili pas rënies së sistemit komunist në Shqipëri ishte njëri nga

---

<sup>1</sup> Imamët e një vendi duhet të kenë një program unik, të cilit duhet t'i përmbahen gjatë detyrës së tyre në xhemat. Në të kundërt, do të lindin huti dhe turbullira rreth interpretimit të fesë, sepse në mungesë të një programi dhe instance supreme, çdonjëri do të pretendojë se është më meritator dhe më i drejtë në interpretimin e fesë sesa tjetri.

themeluesit e parë të Komunitetit Musliman bashkë me Haxhi Hafiz Sabri Koçin, në vitin 1990. Në një bisedë të lirë, gjatë qëndrimit të tij në Medinë në kohën e Haxhit të vitit 1991, si student që ishim në atë kohë na pati thënë: *“Imami injorant është rreziku i fesë. Ai duhet jetë i orientuar në kohë dhe në hapësirën ku vepron, ndryshe dëmi i tij është më i madh se dobia, dhe kjo deri më sot është vërtetuar në shumë raste dhe në shumë vende!”*

## NJERIU DHE PËRGJEGJËSIA E TIJ NË TOKË

Njeriu është krijesa e vetme në sipërfaqen e tokës që është pajisur me forcën e intelektit, të logjikës me *fikir-racio*. Asnjë gjallesë tjetër e gjallë në planetin Tokë dhe me gjerë, të paktën deri më tani, nuk është konfirmuar shkencërisht se posedon arsye, përmes së cilës gjykon dhe dallon të mirën dhe të keqen, ose që mund të bëjë ndonjë planifikim paraprak të ndonjë veprimi afatshkurtër apo afatgjatë. Gjallesat e tjera, përveç njeriut, veprojnë dhe reagojnë në bazë të instinktit, momentit dhe rastit. Kjo divergjencë, apo ky dallimi ynë nga bota e gjallë është dhunti e Krijuesit tonë, Zotit të Madhëruar, i Cili që në momentin e parë të krijimit na veçoi me këtë cilësi dhe dhunti të lartë.

Ndryshe, njeriu është e vetmja gjallesë në botë që komunikon me fjalë dhe me shkrim, dhe e vetmja që merr pendën në dorë për të evidentuar mendimet, përsiatjet, zbulimet dhe të arriturat e ndryshme të tij. Fuqia e të menduarit, përsiatjes, meditimit dhe studimit e ka bërë atë që të flasë si dhe të formulojë fjalë e fjali për t'u kuptuar e për të komunikuar me të tjerët.

Një privilegj dhe përparësi kaq e madhe që iu dha njeriut nga Krijuesi ynë, megjithatë nuk është lënë krejtësisht pa përgjegjësi.

Siç dihet, edhe nga jeta jonë e përditshme, ai që shpik diçka të re dhe të paqenë është edhe personi më i informuar për natyrën e veprimit

dhe funksionimin e asaj gjëje. Një inxhinier dhe projektues makine është shumë normale të dijë për çdo imtësi të saj dhe që saktësisht të ketë të qartë se cila është fuqia, kapaciteti, qëndrueshmëria dhe vlefshmëria e saj.

Atëherë, nëse krijesa njeri është e informuar mirë për gjërat e reja të zbuluara me mendjen e tij, megjithatë të kufizuar, atëherë si mund të pretendojë ndonjëri që i Gjithëdituri dhe i Gjithëinformuari, Krijuesi Suprem të mos të jetë i informuar për krijesën më të dashur të tij, njeriun!

Kjo është edhe arsyeja se pse Zoti atë nuk e la të vetmuar dhe pa përgjegjësi në misionin e tij të përkohshëm në tokë. I fali veshët të dëgjojë të mirën dhe të keqen, sytë të shikojë të mirat dhe të këqijat, si dhe i dha gjënë më të çmuar, mendjen, që përmes saj të dallojë pozitiven nga negativja, për gjithë atë me të cilën ai ballafaqohet në jetën e tij.

Mirëpo, me gjithë këto dhunti e përparësi të shtrenjta, të cilat përbëjnë konstruktin e brendshëm dhe të jashtëm të njeriut, ai nuk u la që të rrugëtojë i vetmuar në këtë botë pa këshillë hyjnore. Me vendosjen e krijesës njeri në sipërfaqen e tokës, Zoti i dërgoi profetë, njerëz të dalluar nga mesi i tyre me misionin dhe qëllimin që përmes tyre bota njerëzore të udhëzohet në orientim të drejtë në besimin në një Zot. Kjo ndodhi sepse Ai, duke qenë Krijues i njeriut, e dinte se atij i nevojitet një udhëzues me udhëzime e porosi hyjnore të natyrës shpirtërore.

Qenia njerëzore në përgjithësi, gjatë ekzistencës së saj është ballafaquar me të keqen dhe të mirën, me pagën dhe luftën, me të bardhën dhe me të zezën. Në brendësinë dhe konstruktin e saj gjithmonë ka ekzistuar animi nga e mira, por edhe lakmia ndaj epshit, egos dhe interesit. Në mendjen e saj gjithherë kanë qarkulluar dhe qarkullojnë mendime nga më të ndryshmet. Në brendësinë e shpirtit njeri janë ngulitur ndjenja pozitive të dashurisë, solidaritetit, afërsisë, por edhe ndjenja të tjera negative siç është egoja, inati, xhelozia, si dhe ajo e më të keqes, groteskja, mizoria, vrasja dhe luftimi i tjetrit.

Shikuar në përgjithësi, njeriu vazhdimisht ballafaqohet me luftën mes të mirës dhe të keqes. Mirëpo, që e mira të triumfojë tek ai, nevojitet një fuqi e përhershme, e cila e ndihmon atë kudo dhe kurdoherë. E ajo fuqi e palëkundur dhe e qëndrueshme është “Besimi në Zotin Fuqiplotë dhe në mësimet e Tij”.

Dikush mund të pyesë se, pse besimi në Zot genka kaq garantim i madh për ruajtjen e njeriut nga e liga dhe e shëmtuara?

Përgjigjja në këtë pyetje tanimë është edhe konfirmimi shkencor, nga sociologët, pedagogët dhe psikologët e ndryshëm të botës, të cilët kanë konstatuar se nuk ka fuqi lëvizëse më të madhe dhe më ndikuese në brendësinë dhe thellësinë e shpirtit të njeriut sesa ndjenja e besimit në Zotin e Plotfuqishëm. Prandaj, pikërisht për këtë, besimi i drejtë në Zotin e Gjithëfuqishëm është i

rëndësishëm, si për individin ashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi.

Ndryshe, të besuarit në Zot është mbështetja më e fortë e parandalimit dhe largimit nga e keqja, sepse një njeri i cili në brendësinë e zemrës dhe shpirtit ka të ngulitur bindjen në Zot, ai nuk mund të jetë person që mund të dëmtojë dikë pa të drejtë, duke qenë i vetëdijshtëm për veprimin e tij dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të Zotit. Të gjithë veprimet e liga dhe të shëmtuara që ndodhin në mesin e njerëzve janë rezultat i mungesës së edukimit, mos respektimit të ligjit, por edhe i mungesës së një besimi të sigurt në Zotin e Madhëruar. Dhuna ndaj njëri-tjetrit, moskujdesi për njëri-tjetrin, egoizmi i pakontrolluar, presionet psikike nga më të ndryshmet, dhunimet dhe prostitucioni, vrasjet dhe vetëvrasjet, droga e alkooli, përgjithësisht çdo e keqe që dallohet me një arsye të shëndoshë, janë nga veprimet e liga e të shëmtuara, të cilat dita-ditës janë në rritje, dhe po ndodhin edhe si shkak i mungesës së frikës dhe llogarisë ndaj Zotit.

Si njerëz dhe besimtarë të Zotit, ne jemi të porositur të qëndrojmë në nivelin e duhur të njerëzillëkut në këtë botë. Ruajtja e rendit dhe qetësisë në sipërfaqen e tokës është përgjegjësi të cilën Zoti ia la njeriut, duke i dhënë epitelin edhe “Mëkëmbës në tokë”.

Shoqëria jonë, pjesë e të cilës jemi, ka nevojë të këshillohet e të sugjerohet nga të gjithë ne, sepse

kanë filluar të shfaqen shenja të një tatëpjete, që herët apo vonë mund të na kushtojë të gjithëve pa dallim. Nisur nga aspekti i mësimave të Zotit, por edhe nga këndvështrimi logjik, jemi të thirrur që njerëzve t'ua përkujtojmë të mirat që ata i shpien drejt prosperitetit, por edhe të këqijat që i çojnë drejt dobësimit, venitjes dhe shkatërrimit. Këshilla e mirë dhe fjala e mirë mes njëri-tjetrit kurdoherë është e nevojshme dhe ajo nuk duhet të ndërpritet.

Thënia e të dërguarit tonë Muhammedit a.s.: *“Të gjithë jeni kujdestarë të asaj që u është besuar juve dhe të gjithë jeni përgjegjës për të”*, është një porosi shumë domethënëse dhe aktuale edhe në ditët tona. Prindi në shtëpi, mësuesi në shkollë, gjykatësi në gjykatë, polici në punën e tij, imami në xhaminë e tij, ministri në ministrinë e tij, kryetari nga pozita e tij, pra të gjithë pa dallim janë të thirrur dhe të obliguar që detyrën e tyre ta kryejnë me nder, në suaza të përgjegjësi që kanë për një shoqëri përparimtare dhe të bereqetshme.

Për të pasur një mirëqenie të përgjithshme të njerëzve, si qenie humane jemi të thirrur nga Zoti, që çdoherë të pengojmë e flakërojmë të keqen si dhe të eliminojmë urrejtjen ndaj njëri-tjetrit, duke e zëvendësuar atë me dashuri dhe respekt. Gjithashtu, edhe ndihma mes vete në të mirë e në të mbarë, e jo në të keqe e armiqësi, është porosi po ashtu e Zotit. Ai në librin e tij na këshillon me porosinë: **“...Bashkëpunoni dhe bashkëveproni**

**në të mirë dhe devotshmëri, dhe mos bashkëpunoni në të keqe dhe në armiqësi**". (El-Maide: 2)

Pastaj:

**"Keni kujdes nga e keqja** (fitneja dhe turbullirat), **sepse kur ajo ndodh, në të nuk përfshihen vetëm zullumqarët** (të këqijtë), **por edhe të mirët** (pra, të pafajshmit)". (El-Enfal: 25)

Zoti është në ndihmën tonë kur ne duam dhe ndihmojmë njëri-tjetrin. Sjellja e mirë, duke filluar së pari me veten tonë, me familjen dhe anëtarët më të ngushtë; prindërit, gruan, fëmijët, të afërmit e afërt dhe të largët, me fqinjët, me shoqërinë e ngushtë e të gjerë, pa dyshim se janë porosi të rëndësishme për të gjithë.

Prandaj, edhe ruajtja e atdheut nga e keqja dhe e liga për mirëqenien e të cilit kemi vuajtur kohë të gjatë, gjenerata me radhë, është po ashtu detyrë e secilit. Të gjithë jemi të obliguar që të mos të lejojmë që padrejtësia (zullumi) ndaj kujtdo qoftë të zërë rrënjë në mesin tonë. Edhe i dërguari i Zotit, Muhammedi a.s., porosiste: *"Ruajuni lutjes së atij që i keni bërë padrejtësi, vetëm pse keni pasur mundësi, sepse mes lutjeve të tij dhe Zotit nuk ka perde"*.

Prandaj, edhe porosia që del nga kjo është që kur të gjykojmë, të gjykojmë drejt, të mos e ngrejmë zërin ndaj të tjerëve pa nevojë, të qëndrojmë modestë dhe të mos ecim me mendjemadhësi në tokë, ashtu siç edhe na mëson Zoti:

**“Mos ec në tokë me mendjemadhësi e kryelartësi, sepse ti as nuk do të arrish të çash tokën e as nuk do të arrish lartësinë e maleve (kodrave)”. (El-Isra: 37)**

## **Virtytet e larta njerëzore janë edhe porosi hyjnore**

Virtytet si: dashuria, sinqeriteti, drejtësia, solidariteti, morali i lartë, kujdesi ndaj të varfërve, të mjerëve dhe të paaftëve etj., janë disa nga elementet kyçe të një shoqërie të begatë dhe përparimtare. Nëse këto virtyte i mungojnë një shoqërie, ajo krijon individë dhe të ardhme të saj të çalë e destabilizuese. Kohët e fundit, si rezultat i rrethanave ende jo të favorshme të vendit tonë; qoftë në rrafshin politik por edhe në atë social, si shoqëri po ballafaqohemi me varfëri të skajshme të cilën po e vuajnë një pjesë jo e vogël e banorëve të vendit tonë. Ndërkaq, në anën tjetër, pasurimi deri në majat më të larta të mundshme i një pjese tjetër të shoqërisë; në formë të padrejtë mbi kurrizin e të paaftit, të dobët dhe të lënurit pas dore, lë të kuptohet se në këtë shoqëri po ndodh diçka që s'është e virtytshme dhe e ndershme. Keqpërdorimi i herëpashershëm edhe i fuqisë institucionale për të bërë padrejtësi ndaj atyre që janë pa krah dhe pa mbështetje, si dhe shumë e shumë veprime të tjera jo të ligjshme, përgjithësisht kanë krijuar një lloj humbje të besimit mes njerëzve, një lloj zillie e mërie, por edhe humbje shprese e optimizmi, për t'u bërë më mirë në një të ardhme të afërt.

Shpërkujdesja për të mirën e njëri-tjetrit dhe të veprimit të drejtë dhe të sinqertë, bën që as më të lumturit të mos jenë të lumtur, por as të gëzuarit

të mos gëzohen për të mirat që kanë. Asnjëherë nuk mund të ndihesh mirë, si njeri me ndjenja të duhura humane, nëse fqiu i afërt apo i largët është në vuajtje dhe në nevojë për shkak të varfërisë dhe mjerimit që mund ta ketë kapluar. Zhveshja nga solidariteti dhe animi nga egoizmi janë virtyte të botës anormale që nuk përkojnë me natyrën e vërtetë njerëzore, mirëpo sot shumë njerëz të ngopur shpeshherë ikin nga vetja dhe harrojnë dhimbjet dhe vuajtjet e të tjerëve. Në kohët e fundit ka filluar me të madhe të dominojë interesi personal ndaj atij kolektiv, një dukuri e re në shoqëritë e sotme moderne, e cila ka kapluar edhe popullin tonë. Të gjithë veprimeve, të mira ose të këqija që ndodhin në shoqëri, jemi ne ata që ua hapim rrugën, sepse rrugët dhe shtigjet në këtë botë i bëjnë dhe i krijojnë vetëm njerëzit.

Pra, të ligat dhe të këqijat që na godasin, si individ dhe si shoqëri, janë rezultat i veprimeve dhe menaxhimeve tona. Askush nuk e mbanë rendin dhe qetësinë në shtëpinë tonë. Rendi shtëpiak çrregullohet dhe humb ekuilibrin nëse nuk e bëjmë punën mirë, ashtu si duhet, dhe nëse nuk tregohemi të kujdesshëm dhe të përgjegjshëm.

Të gjithë duhet të kuptojmë se nuk mund të ketë të ardhme të ndritur të një shoqërie nëse nuk dominon vlera ndaj të pavlerës, e mira ndaj të keqes, drejtësia ndaj padrejtësisë, sinqeriteti ndaj urrejtjes, besnikëria ndaj tradhtisë, morali ndaj jo

moralit, fitimi hallall ndaj atij haram, shkollimi i drejtë ndaj atij të padrejtë dhe të çalë etj., etj.

Nëpërkëmbja e vlerave dhe etikës morale është një veprim që rrezikon të ardhmen e shoqërisë. Kur shoqëria humb vlerat morale është ngjashëm me drurin që humb lëvoren e tij, epilogu i të cilit është vyshkja dhe tharja. Prandaj, është detyrë që virtytet njerëzore dhe humane të kultivohen që herët në shpirtin e çdo individi.

Asnjë njeri i arsyeshëm, as në të kaluarën e as tani, nuk mund të pajtohet që nxënësi apo studenti ynë të shkojë në sallën e mësimit me bindjen se mund të kopjojë njohuri nga shoku i tij, vetëm që ta kalojë provimin. Fatkeqësisht, kjo dukuri negative po ndodh në mesin tonë. Nëse nxënësi mësohet dhe lejohet t'i kalojë provimet duke kopjuar, dhe ai vazhdon në këtë formë deri në diplomimin e tij dhe, pas diplomimit atij i ofrohet një vend pune me përgjegjësi kolektive duke marrë diplomën e tij si dëshmi, atëherë shtrohet pyetja se cili do të jetë fati i atij vendi të punës dhe asaj përgjegjësie që ai do ta marrë mbi supet e tij dhe cili do të jetë fati i shoqërisë në përgjithësi?! Kush është fajtor në këtë rast, studenti apo përgjegjësit që e kanë lejuar apo edhe i kanë krijuar kushte e rrethana që ai të ngrihet në karrierën e tij pseudo, të paangazhim dhe mësimet mbi profesionin për të cilin ai edhe krekoset?!

Si shoqëri duhet ta pranojmë autokritikën për veprimet tona të pamatura dhe të pakontrolluara

mirë, por edhe t'i kritikojmë dhe të kritikohemi për hapat vazhdues dëmtues që ne ose dikush mund t'i ndërmarrë nga mesi ynë.

Edhe në fushën e drejtësisë, nëse gjykatësi nuk gjykon drejtë ndaj atij të cilit i është bërë padrejtësi, ose qëllimisht apo edhe duke qenë i ndikuar nga të "lartit" merr vendim të padrejtë në dëm të të dobët, vetëm pse ka mundësi, dhe të cilin veprim e vazhdon edhe shumë herë të tjera, atëherë baraspesha dhe ekuilibri në shoqëri do të mungojë. Ndërsa si pasojë e kësaj, në mesin tonë do të lindin çrregullime dhe anarki, ku njerëzit do ta marrin ligjin në dorë individualisht për t'i zgjedhur hallet dhe problemet e tyre.

Askush mos të mendojë dhe kujtojë se për veprimet e tij të padrejta do të jetë i qetë në këtë apo në botën tjetër. Lutjet e atij që i është bërë padrejtësi do ta godasin ushtruesin e padrejtësisë në një apo formë tjetër, herët apo vonë, në këtë apo në botën tjetër, në ditën dhe momentin kur askush nuk do të mund t'i ikë drejtësisë absolute. Zoti nuk ia merr shpirtin fytyrëziut pa ia marrë fytyrën para botës, dhe kjo është dëshmuar dhe dëshmohet vazhdimisht edhe në përditshmërinë tonë.

Prandaj, nga ajo që thamë më sipër, mund të thuhet se virtytet e lartpërmendura përveç që janë porosi për një shoqëri të mirëfilltë njerëzore, para së gjithash janë edhe porosi të Zotit, ushtrimi dhe praktikimi i të cilave është në të mirë të individit në rend të parë, pastaj edhe të

çdo shoqërie që mëton të jetë e organizuar mirë, e konsoliduar dhe e qëndrueshme. Kur çdo njeri bën atë që i vjen për dore, pa asnjë fije përgjegjësi, kur fjala e premtuar nuk zbatohet, kur mungon veprimi i sinqertë, aty pa dyshim se mungon edhe sinqeriteti edhe drejtësia. Po ashtu, kur njerëzit humbin vlerat etike dhe morale, atëherë askush të mos mendojë e shpresojë se mund të presë ditë të mira, as për veten, as për fëmijët dhe familjen, por as për shoqërinë në përgjithësi.

## **Kush mund të flasë për Kur'anin e kush jo?!**

Të flitet për Kur'anin si libër hyjnor nuk është gjë e lehtë dhe punë e thjeshtë. Kur'ani s'mund të përkufizohet dhe të përmyllet me njohuri sipërfaqësore.

Ai është një libër i cili nga pamja e jashtme duket si të gjithë librat e rëndomtë, por që nga përmbajtja dhe kuptimi nuk i ngjan dhe nuk mund t'i ngjajë asnjë tjetri në botë. Që nga momenti i parë i shpalljes, Kur'ani fillimisht është mësuar përmendsh nga besimtarët dhe paralelisht është shkruar dhe materializuar në mjetet e kohës. Kjo ndodhte përmes skalitjes në rrasa gurësh, lëkura e eshtra shtazësh, lëvore të drunjte etj., gjendje kjo e cila e ka përcjellur atë deri në zbulimin e mjeteve të shkrimit klasik dhe modern. Për dallim nga librat e tjerë të rëndomtë, Kur'ani përveç që është shkruar vazhdimisht, ai është përcjellë edhe nga një element tjetër shumë i rëndësishëm, institucioni i memorizimit (*hifdh*). Prandaj, dy elementet e sipërpërmendura kanë qenë dy shtylla bazë që e kanë ruajtur deri më sot origjinalitetin e Kur'anit, nga ndonjë devijim i mundshëm, sado i vogël që mund të ishte ai.

Memorizimi i këtij libri të shenjtë nga mijëra besimtarë nëpër botë, edhe sot garanton që edhe në rastin ekstrem, për ndonjë "X" arsye të zhdukeshin të gjithë librat që posedojmë, i vetmi do të ishte Kur'ani, i cili do të mund të rikthehej në autenticitetin e tij të mëparshëm.

Ky libër hyjnor nuk është poezi, prozë, dramë apo ndonjë gjini letrare që mund të mësohen e perceptohen për një çast, ditë, javë ose edhe më gjatë. Gjykimi për të dhe me të nuk është e drejtë e një njeriu që nuk është njohës dhe studiues i tij i mirëfilltë.

Në momentin kur një njeri gjykon me vetëm një pjesë të tij, duke lënë anash ose duke mos e marrë në konsideratë gjithëpërfshirjen dhe kontekstin e tij të tërësishëm, është i ngjashëm me një njeri që kërcen në mes të një deti pa zotëruar artin dhe shkathtësinë e notit.

Kur'ani në hegjemonizmin e tij i ngjan nyjeve të trupit të njeriut, të cilat janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën, dhe funksionimi i të cilave është i paimagjinueshëm në rastin e shkëputjes së vetëm njërës pjesë nga tjetra.

Lidhur me këtë që u përmend më sipër, vlen të theksohet shembulli ilustrues i një burri, që shpesh e hasim si tregim në librat e shpjegimeve (ekzegjezës) kur'anore, në të cilët thuhet se, në një rast ai i paskësh thënë gruas së tij se është e divorcuar për aq kohë sa do t'i zgjaste periudha kohore e fjalës kur'anore "*hine*" - حِين.

Qëllimi i fjalës "*hine*" është vështirë të kuptohet pa kontekstin kur'anor, prandaj gruaja e divorcuar, duke mos e kuptuar qartë periudhën e shkurorëzimit, e shqetësuar kërkon ndihmë tek dijetarët muslimanë.

Dijetari i parë në pyetjen e gruas për kohëzgjatjen e divorcit i thotë se është ndarë nga

burri i saj për një kohëzgjatje që është sa një mijë vjet, duke argumentuar gjykimin e tij me ajetin kur'anor:

هل أتى على الإنسان حين من الدار لم يكن شيا مذكورا

**“A nuk ka kaluar njeriu një periudhë kohore, kur nuk vlente as të përmendet?!” (El-Insan: 1)**

Dijetari i dytë shihet se ishte paksa më i butë në përkufizimin e kohës së divorcit për gruan e zemëruar, të cilës i thotë: “Ti je e ndarë për aq kohë sa zgjat një vit, duke argumentuar gjykimin e tij po ashtu me ajetin kur'anor:

توتى أكلها كل حين باذن ربها

**“Druri - pema e jep frytin e saj në çdo kohë (d.m.th. çdo vit)”. (Ibrahim: 25)**

Ndërsa dijetari i tretë ishte më relaksuesi për gruan e shqetësuar. Ai i thotë asaj se është e ndarë për aq kohë sa zgjat një ditë e vetme, përgjigje kjo të cilën e mbështeti po ashtu në ajetin kur'anor:

فسبحان الله حين تمسون و حين تصبحون

**“Atëherë le te jetë i lavdëruar Allahu sa herë që ju bini në mbrëmje dhe agoni në mëngjes (d.m.th. çdo ditë)”. (Er-Rum: 17)**

Gjykimi i fundit, sipas Kur'anit, e liroi gruan e merakosur nga hidhërimi i tepërt që kishte dhe ia

riktheu shpresën për ribashkimin e saj bashkëshortor<sup>1</sup>.

Ky tregim nga shkenca e tefsirit (ekzegjezës) dhe studimeve kur'anore është sinjali më i qartë dhe më i shkëlqyer mbi faktin se Kur'ani është një tekst tepër i thellë, respektivisht një univers i pambërthyer deri në fund, kuptimin e të cilit e dinë vetëm ekspertët e mirëfilltë të tij, edhe pse edhe vetë ata asnjëherë nuk mund të konkludojnë se shpjegimi i tyre ishte përfundimtar, qoftë edhe për një pjesë të pjesshme të tij!

Me fjalë të tjera Kur'ani është një det pa brigje (بحر لا ساحل له), në të cilin zhytësi sa herë që zhytet në thellësinë e tij gjen margaritarë të rinj e të pazbuluar më parë.

Vlen të theksohet gjithashtu se deri në ditët e sotme mijëra e mijëra dijetarë i janë qasur studimit dhe analizës së Librit tonë të shenjtë, duke filluar që nga momentet e para të shpalljes. Kurse, po për të janë shkruar tonelata librash dhe janë shterur bojëra të pafundme, mirëpo asnjë nga dijetarët dhe komentuesit, qoftë edhe më eminentët, në fund të punës së tyre të lodhshme nuk kanë arritur të gjykojnë se e kanë arritur fundin e shpjegimit të Kur'anit, dhe se për të tjerët nuk ka më vend për qasje studimi dhe analize të mëtutjeshme, qoftë për kohën e tyre, ose për të ardhmen e afërt apo të largët.

---

<sup>1</sup> Shih librin “Si të komentohet Kur'ani”, Enes Kariç, f. 17, Prishtinë, 2010.

Kemi të bëjmë me një libër të stërbushur me thirrje për lexim, studim, arsimim, përparim e hulumtim në tokë e nën tokë, po edhe në kozmosin e gjerë e të pakufishëm. Kur'ani është edhe sfidues, sidomos kur disa ajete të tij sinjalizojnë çështje të cilat lidhen me fushën e mjekësisë dhe gjeologjisë.<sup>1</sup>

Prandaj, e gjithë kjo që u përmend më lartë mbi vlerat e Librit tonë, vetvetiu shtron edhe pyetjen se, pasi ky libër është i përsosur dhe i pazëvendësueshëm, atëherë pse pasuesit e tij, jo rrallëherë, në mendimet tona dhe në ato të shkallës ndërkombëtare, paraqiten si njerëz të egër, të vrazhdë e të rrezikshëm për shoqërinë moderne, të prapambetur, shpellorë, njerëz arkaikë, demode, terroristë e gjakpirës? Ku qëndron problemi?

---

<sup>1</sup> Nga aspektet që Kur'ani sfidon më së shumti është letërsia, përkatësisht pamundësia e bërjes së një libri si Kur'ani. Në lëmin e letërsisë, Kur'ani është një poemë, lloj poezie që bën pjesë në gjininë lirike. Por, në Kur'an kemi edhe gjininë epike, rrëfimin, përkatësisht tregimet për të dërguarit e Zotit. Gjithashtu, në Kur'an kemi edhe skenat dramatike, që përgjithësisht bëjnë që Kur'anin sot ta shquajmë si vlerën më të lartë letrare, madje qoftë edhe sipas orientimeve bashkëkohore letrare, sidomos të modelit të *ars combinatorial* (arti i kombinuar). Po ashtu, vlerë e jashtëzakonshme artistike letrare e shprehjes kur'anore është lidhja semantike me atë fonologjike apo tingullore, që për një vepër letrare është alfa dhe omega e krijimit artistik letrar. Pra, ajo që shqiptohet fle në shpirtin e çdokujt, e njohu apo nuk e njohu atë gjuhë. Ky element e shquan Kur'anin fund e krye.

Nga urrejtja e tepërt që është akumuluar ndaj ithtarëve të tij së fundi, një prift i ngarkuar në Amerikë kishte ftuar haptazi ithtarët e tij në një fushatë kundër Kur'anit, duke vendosur që të shpallë edhe “Ditën ndërkombëtare të djegies së tij” (*International burn the Qur'an day*). Kjo ishte bërë në shenjë revolte ndaj Islamit dhe muslimanëve, hap të cilin fatmirësisht në momentin e fundit kishin arritur t'a parandalonin njerëzit e mendjes dhe arsyes së shëndoshë nga vetë komuniteti i tij.

Mirëpo, a është faji tek ky Libër hyjnor për gjithë këto akuza të llahtarshme?<sup>1</sup>

Nëse dikush i akuzon muslimanët me të këqijat e lartpërmendura, sigurisht se për të mund të thuhet se s'ka pasur dhe as nuk do të ketë asnjëherë elementin e vetëm mbështetës në Kur'an, sepse, në asnjë mënyrë, teksti hyjnor nuk e nxit askënd të jetë vrasës i njeriut të pafajshëm, kushdo që mund të ishte ai. Përkundrazi, fjala e Zotit i nxit njerëzit të jenë solidarizues, ndihmës dhe shpëtues të njëri-tjetrit. Madje, Kur'ani na

---

<sup>1</sup> Sikurse pati thënë edhe Montgomery Watt për Muhammedin a.s., se është nga njerëzit e famshëm që në Perëndim urrehet sepse, fatkeqësisht nuk njihet, njësoj mund të themi edhe për Kur'anin se, të gjithë ata që e urrejnë, e shajnë, duan ta djegin a shqyejnë, janë njerëz që nuk e kanë lexuar kurrë. Po të lexonin vetëm njërin prej secilës sure, dhe të mendonin rreth asaj që flitet në të, jo që do ta flaknin por do ta ruanin me respektin më të madh, në vendin më të dashur në shtëpitë apo librotekat e tyre. Madje edhe do ta lexonin çdo ditë.

mëson edhe se shpëtimi i një njeriu të vetëm, sipas porosive kur'anore, është sikurse shpëtimi i tërë botës, ndërsa mbytja e një njeriu të pafajshëm është sikurse vrasja e tërë njerëzimit.

Kur'ani gjithashtu na paralajmëron se të gjithë njerëzit, pa dallim, kanë një zanafillë të vetme dhe të përbashkët të krijimit, duke na u drejtuar me apelin: **“O njerëz! Ne ju kemi krijuar juve nga një mashkull dhe nga një femër (Ademi dhe Hava)”**. (El-Huxhurat: 13)

Kjo është thirrja më e qartë dhe më e hapur, e cila nuk lë vend për dyshimin edhe më të vogël rreth farës së përbashkët të të gjithë frymës njerëzore në botë. Asnjë akt i ulët antinjerëzor nuk mund t'i ngjitet Kur'anit dhe mësimëve të tij autentike.

Prandaj, të gjithë duhet t'a kuptojnë se nuk mund të ketë musliman terrorist, siç edhe nuk mund të ketë terroristë muslimanë! Aktet terrorizuese të shkatërrimit në masë të njerëzve nuk kanë pasur dhe nuk mund të kenë asnjëherë mbështetje në Kur'an, sepse misioni kur'anor është integrimi e jo dezintegrimi, respekti dhe dashuria për njëri-tjetrin e jo urrejtja dhe racizmi.

Keqpërdorim të fesë ka pasur dhe mund të ketë përherë nga grupe të caktuara njerëzish, mirëpo ata nuk mund t'i bindin të tjerët, qoftë edhe me të vetmin argument se veprimet e tyre të liga eventuale i kanë të mbështetura në mësimet

hyjnore të Zotit, sepse ato mësimet asnjëherë nuk mund të jenë kundër qenies njeri!<sup>1</sup>

Muslimanët duhet të jenë pasues të drejtë, të sinqertë e të kujdesshëm të Kur'anit, e kurrësi të mos e lejojmë veten të gjykojmë me fjalën e tij nën ndikimin e emocioneve dhe frustrimeve të pakontrolluara, sepse kjo formë patjetër do të na çojë në shtrembërimin e udhëzimit të drejtë të Zotit, ndërsa në Ditën e Gjykimit, në mënyrë të pashmangshme kemi për të dhënë përgjegjësi për devijimin e qëllimshëm apo të pakujdesshëm të fjalës së Zotit të Madhërishëm.

---

<sup>1</sup> Është fakt i pamohueshëm se keqpërdorime dhe keqinterpretime të fesë nuk kanë ndodhur dhe nuk ndodhin vetëm tek muslimanët, por edhe tek të gjithë pjesëtarët e feve qiellore, si dhe tek ato të shpikura nga njerëzit.

## **Studiues shqiptarë dhe definicione të çmuara të tyre për Kur'anin**

Definicioni njoftues që jepet nga ana e studiuesve për një lëmi ose materie të caktuar shkencore, filozofike apo shoqërore, është i një rëndësie të veçantë. Sa më i qartë dhe sa më bindës e konciz që është ai, aq më mirë dhe aq më fuqishëm pranohet materia referuese e subjektit nga ana e lexuesve dhe studiuesve.

Për Kur'anin ekzistojnë përkufizime nga më të ndryshmet, të cilët janë evidentuar nga studiuesit që në kohët e hershme, dhe të cilët vazhdojnë edhe në kohën e sotme bashkëkohore. Përshkrime të ndryshme për Kur'anin janë të pranishëm edhe në vetë tekstin e tij,<sup>1</sup> mirëpo pavarësisht nga kjo, studiuesit e tij vazhdimisht kanë shprehur qëndrimet e tyre për të dhënë dhe nxjerrë përkufizime të reja të tyre.

Në mesin e shumë studiuesve të Kur'anit në botë bëjnë pjesë edhe shqiptarët, të cilët gjatë rrjedhës së kohës kanë ndarë mendime dhe vlerësime të çmuara për librin e shenjtë të muslimanëve - Kur'anin.

Gjatë gjithë historisë, për shqiptarët muslimanë libri i Zotit ka qenë i identifikuar përmes emrave si: Mus'haf, Kur'ani Qerimi, Qelamullahi, Qitabi etj.

---

<sup>1</sup> Vetëm fjala Kur'an - القرآن, me nyjën shquese apo pa të, në tekstin kur'anor është përmendur 59 herë.

Ndër të parët që janë marrë me studimet e Kur'anit, në fund të shekullit 19 dhe në fillim të shekullit 20, nga shqiptarët ishin: Hafiz Ali Korça, Haxhi Vehbi Dibra (Agolli), Ismet Dibra, Hafiz Ibrahim Dalliu, Ferid Vokopola, Sadik Bega, H. Sherif Ahmeti etj. Këta studiues bëjnë pjesë në mesin e studiuesve më të famshëm shqiptarë të Kur'anit dhe Islamit, përgjatë gjithë periudhës së shekullit që po e lëmë pas.

Në revistat islame dhe të tjerat, me përmbajtje shkencore dhe kulturore, si: *“Zani i Naltë”*, *“Kultura Islame”*, *“Dituria Islame”* etj., përmes një rubrike të caktuar nga redaksia enkas për Kur'anin, të titulluar me tituj të ndryshëm si; *“Ç’është Kur’ani”*, *“Fleta e Tefsirit”* etj., hasim në punime mjaft të rëndësishme për shkencën e komentimit të Kur'anit veçanërisht, si dhe për të gjitha shkencat islame në përgjithësi. Kurse më vonë, punime të rëndësishme për Mus-hafin kanë dhënë edhe shqiptarët jashtë vendit të tyre amë, përmes punimeve e botimeve të ndryshme.

**Hafiz Ali Korça**, në kohën e tij, ishte njëri nga njohësit më të thellë të Kur'anit dhe vlerave të tij. Zotërimin dhe aftësinë e tij në shpjegimin e fjalës së Zotit e vërejmë në komentimin që ai i bëri dhjetë sureve të pjesës së fundit të Kur'anit<sup>1</sup>. Në mesin e shumë opinioneve dhe qëndrimeve të tij për Kur'anin, mund të seleksionohet mendimi i tij se: *“Kur’ani dhe çdo ajet i tij është burim i kulturës së*

---

<sup>1</sup> Shih: Hafiz Ali Korça, Vepra 8, “Komentimi i Kur'anit”, Logos, Shkup, 2008.

*lulëzimit jo vetëm i myslimanëve, kulturë e cila ka pjellë edhe kulturën Evropiane të sotme.”<sup>1</sup>*

Ndërsa **Haxhi Vehbi Dibra (Agolli)**, po ashtu njohës i thellë i Kur’anit dhe disiplinave islame në përgjithësi, thotë se është i vetëdijshëm se sado që do të mund të shkruante nuk do t’ia dilte mbanë ta cilësonte atë me gjithë cilësitë dhe vetitë që ai i gëzon.

*Ai thotë: “Cila është ajo pendë kompetente e cila mundet me shpreh dhe me përshkruar madhështinë dhe hapësirën shumë të naltë të këtij oqeani të pafund të diturisë dhe filozofisë. Me gjithë këtë mungesë brumi që gjejë në veten time nuk mundem me heshtë përpara fakteve e mbresave shpirtërore që në këto momente i ndiej para këtij libri të shenjtë”.<sup>2</sup>*

*“Kur’ani i madhnueshëm është një libër hyjnor i cili shpërndan dhe përhap dritë gjithkrah. Ai mbështjell gjithë naltësinat, përfshinë të gjitha burimet e virtyeteve të larta të njerëzisë. Ai spjeron dobitë dhe dëmet a atyre që ju shtrohen dispozitat e tij shumë të shenjta. Ai merr nën mbrojtje dhe garanton të drejtat e të gjitha kombeve dhe krejt popujve mysliman e jo mysliman. Është dekret hyjnor dhe Akt kredencial<sup>3</sup> që dokumenton dërgatën hyjnore mbi Profetin Muhammed a.s.”<sup>4</sup>*

---

<sup>1</sup> Shih: Hafiz Ali Korça: “Spjegimi i kuptimit të disa sureve të shkurtëra të Kur’anit të Shenjtë”, Michigan, 1996.

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Fjalë latine në kuptimin e ndajfoljes (lat. credere) besoj, (italisht-credenziali). Për më gjerësisht shih Mikel Ndreca, *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të huaja*, Prishtinë, 1986, f. 413.

<sup>4</sup> Zani i Naltë, Nr. 4, 1933, f. 499.

*“Ky Kur’an tash e 13 shekuj thërret krejt botën njerëzore e xhinore<sup>1</sup> në konkurs e në provë, i propozon artistëve letrar që të hartojnë një vepër të tillë, që t’i ngajë sëpaku edhe në kaptinën më të vogël të tij, mirëpo të gjitha përpjekjet e tyre kanë përfunduar në disfavor. Letrarët më të famshëm të botës nuk kanë arritur me hartue as edhe një frazë të shkurtë e cila do të krahasohej me naltësinë letrare të kësaj veprë, që s’është vepër por fjalë e Amshueshme e të Madhit Krijues.”<sup>2</sup>*

*“Ky libër nuk është krijesa e mendjes njerëzore, por është drejtpërdrejt fjala e Mrekullueshme që ka buruar nga Selia e padukshme e Unitetit të amshueshëm, si një dhuratë e mëshirës së Naltë, e si një dritë e mrekullueshme e së vërtetës së Plotë për me forcue e vërtetue peygambërllukun e të dërguarit të Tij Muhammedit a.s.”<sup>3</sup>*

---

<sup>1</sup> Xhinët janë krijesa të padukshme për të cilat nuk ka të dhëna të detajuara as në literaturën islame e as në atë shkencore, pos ajeteve kur’anore që na bëjnë me dije se ato janë krijesa të padukshme të krijuara nga materia e zjarrit.

<sup>2</sup> Me këtë fjali, Haxhi Vehbi Dibra kundërshton mendimin e mu’tezilive, të cilët mbështesin mendimin e tyre mbi Kur’anin si vepër të krijuar të Zotit. Kjo është një problematikë e cila është zhvilluar dhe debatuar shumë kohë mes akaidologëve (studiuesve të doktrinës së besimit në Zot).

Aspekti material i Kur’anit është i krijuar, mirëpo fjala e Zotit, Kur’ani është cilësi e Zotit e amshueshme e pafillim dhe e pambarim. Për më gjerësisht shih Muhammed Handziq: “Uvod u tefsirsku i hadisku nauku”, Sarajevë, 1972, f. 5-6.

<sup>3</sup> Zani i Naltë, Nr. 4, 1933, f. 500.

Dibra çmon në pedestal rëndësinë e Kur'anit dhe pazëvendësueshmërinë e tij, jo vetëm në rrethanat që u shpall, por, sipas tij, i tillë do të vazhdojë të jetë përgjithmonë. Vlerësimet e Vehbi Dibrës për librin e parë të më shumë se 1.5 miliardë muslimanëve të botës janë aktuale edhe sot, madje mëse të domosdoshme të përmenden edhe në këto kohë, kur tensionet në baza fetare mes botës perëndimore dhe asaj lindore janë në rritje, si rezultat i shtrembërimeve që po i bëjnë feve qiellore mediat e sotme, fatkeqësisht!

*“Në një kohë kur ishte shkatërrue rregulli i shoqërisë njerëzore, në një kohë kur vogjelia e mjerë po lëngonte dhe po shtypej ndër kthetrat e torturës barbare, në një kohë kur popujt dhe kombet luftonin mes tyre pa mëshirë, vetëm për plaçkë e gjak, në një kohë kur njerëzve nuk u njihej barazimi para drejtësisë, në një kohë kur në botë sundonte vetëm kaosi, (pyet çuditshëm Dibra), a nuk ishte Kur’ani i Madhnueshëm që thirri njerëzinë në “Unitet” e në “Barazim”?! A nuk ishte ky libër hyjnor që me normat e Drejtësisë së Naltë, përthevojë - mbështuell njerëzinë nën balancën e së Drejtës, e kjo dritë e vetëtimtë-e shpejtë e Kur’anit shkëlqeu në katër anët e botës, në një mënyrë nga e cila u çuditën të gjitha mendjet e larta të njerëzisë.”<sup>1</sup>*

Ndërsa studiuesi tjetër po ashtu i njohur ndër shqiptarët, **Hafiz Ismet Dibra**, në definicionin e tij për Kur'anin gjithashtu ka prekur shumë anë dhe dimensione të tij përmbajtësore. Ai fillimisht

---

<sup>1</sup> Po aty, f. 500.

ofron një vlerësim të përgjithshëm për Kur'anin, duke e formuluar kështu:

*“Kur’ani është një libër i diturisë dhe filozofisë së mjaftueshme, veç vlerave tjera që mbështjell në vete është edhe një pasqyrë e vërtetë e së kaluemes dhe një dritë e shkëlqyeshme për të ardhmen. Kur’ani është një përmbledhës i mistereve të gjithësisë. Kur’ani është një Statut Hyjnor, në bazë të të cilit duhet rregullohet, të administrohet e të civilizohet trupi njerëzor që jeton në fytyrë të tokës.”<sup>1</sup>*

*“Kur’anin duhet ta nderojnë edhe ata të cilët e duan Isaun, ngase ky libër është treguar shumë bujar në favor të Krishtit. Me përbuzë Kur’anin është si me krye një vepër e cila përpara mendjes dhe arsyes është një krim.”<sup>2</sup>*

Një definicion dhe një shtjellim tepër domethënës për vlerën, porosinë dhe synimet e Kur’anit e jep dhe publicisti më i njohur i islamistikës, në të gjithë trojet shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore, **H. Ef. Sherif Ahmeti**. Ai në shumë punime të tij për Kur’anin, flet me epitetin më të lartë, si:

*“Kur’ani me shprehjet e tij aq sa mund të kuptohet, zgjon ndjenjë të lart te njeriu për lidhmëni të shumta mes tij dhe Zotit, mes tij dhe botës e cila e rrethon, jep sqarime për madhërinë dhe urtësinë, për fuqinë dhe sundimin e Zotit xh.sh., orienton mendjet kah ligjet dhe rregullat të cilat mbretërojnë në gjithësi, dhe të*

---

<sup>1</sup> Hafiz Ismet Dibra, *A ka dyshim në qenien e Zotit, Ç’është Kur’ani*, Michigan, 1993, f. 2.

<sup>2</sup> Ibid, f. 3.

*cilat zhvillohen dhe shfaqen vetëm sipas vullnetit të Tij.”<sup>1</sup>*

*“Kur’ani është fjalë e Zotit. Leximi i tij konsiderohet ibadet. Është libër i fesë i cili na mëson rregulla dhe dispozita të nevojshme dhe të domosdoshme për të gëzuar jetën e kësaj bote. Është libër i pacenueshëm në domethëniet e veta, nuk ndryshon dhe nuk zëvendësohet me ndonjë thënie tjetër.”<sup>2</sup>*

Vlerësimet e sipërpërmendura për Kur’anin nga ana e këtyre dijetarëve të njohur të Kur’anit dhe të Islamit, të cilët vepruan në kohë dhe rrethana të ndryshme në Shqipëri e Kosovë, dhe në vise e vende të tjera, të bëjnë të kuptosh se sa i vlefshëm dhe sa vend të lartë ka zënë Kur’ani ndër shqiptarët si në formimin dhe kultivimin e besimit fetar, po ashtu edhe në organizimin dhe zhvillimin e jetës në bazë të mësimave dhe udhëzimeve të tij.

---

<sup>1</sup> H. Sherif Ahmeti, *Dituria Islame*, Nr. 35, 1988, Prishtinë, f. 23.

<sup>2</sup> H. Sherif Ahmeti, *Edukata Islame*, Nr. 46/47, 1986, Prishtinë, f. 3.

## Femra sipas Kur'anit dhe të drejtës islame

Ajo që ne kuptojmë nga Kur'ani dhe Librat e Shenjtë rreth krijimit të parë të njeriut është e vërteta se të dy gjinitë janë krijesa të Zotit, krijesat më të dashura, të cilat Ai me dëshirën e Tij i solli mbi sipërfaqen e tokës. Nga të gjitha krijesat në tokë, njeriu është krijesa më e çmuar e Zotit, duke filluar nga konstrukti i tij fizik, fiziologjik dhe psikologjik.

Sipas konceptit kur'anor dhe islam, njeriu është qenie humane, njeri, me kuptimin e plotë të fjalës, pa dallim në gjini; mashkull apo femër. Ai meriton respekt dhe konsideratë të veçantë.

Jeta njerëzore si dhe gjallesat e tjera nuk mund të mendohet se si do të ekzistonin pa praninë e gjinive të kundërta: **“Dhe ne krijuam prej çdo sendi dy lloje (mashkull e femër) që ju ta përkujtoni (madhështinë e Zotit)”<sup>1</sup>.**

Pastaj citati tjetër kur'anor: **“I pastër nga të metat është Ai që krijoi të gjitha llojet - çiftet nga çfarë mbanë toka, nga vetë ata - njerëzit dhe nga çfarë ata nuk dinë.”<sup>2</sup>**

Nga një postulat dhe aksiomë e tillë shihet shumë qartë se të dy gjinitë janë të domosdoshme për vazhdimësinë e botës së gjallë njerëzore, por edhe të natyrës jonjerëzore. Sipas porosive të Kur'anit, mashkulli dhe femra janë dy krijesa të

---

<sup>1</sup> Sure Edh-Dharriyat: 49.

<sup>2</sup> Sure El-Ja-sin: 36.

barabarta, të cilët në mënyrë absolute gëzojnë të drejtat e tyre individuale dhe reciproke.

Femra, njësoj si mashkulli, gëzon të drejtën e arsimimit, punës, të drejtën e pasurisë dhe të trashëgimisë.

Kur'ani i atribuohet gruas në cilësinë dhe në natyrën krijuese, e cila është në përputhshmëri me shpirtin dhe konstruktin krijues të saj. Vlen të theksohet se, të drejtat dhe obligimet që i ka paraparë Islami për gruan kanë përmirësuar gabimet e kohërave të kaluara tek shumë popuj të vjetër, e sidomos të periudhës mesjetare.

## Barazia burrë-grua

*“Pa dyshim, gruaja është e barabartë me burrin.”<sup>1</sup>*  
(Hadith)

**“Pasha natën që me errësirë mbulon gjithësinë! Pasha ditën kur ajo shkreptin! Pasha Atë që e krijoi mashkullin e femrën! Vërtetë, veprimi juaj është i llojlojtë.”<sup>2</sup>**

Muhammed Muteveli Esh-Sharavi,<sup>3</sup> në shtjellimin e kuptimit të këtij ajeti kur'anor thotë: “Njerëzit mendojnë se gruaja dhe burri janë krijuar si dy krijesa konkurrenente mes vete, dhe harrojnë se në fakt ato janë krijesa të cilat e plotësojnë njëra-tjetrën. Zoti i Madhëruar përmes ajetit të lartpërmendur kur'anor ka dashur të na sqarojë plotësimin e burrit dhe gruas, duke i krahasuar ata me plotësimin e natës dhe ditës. Edhe pse nata dhe dita janë të kundërta në rolin të cilin ato e kryejnë në kozmos, megjithatë ato nuk janë plotësisht të pavarura, por në fakt janë dy fenomene të kundërta natyrore të cilat plotësohen njëra me tjetrën”.<sup>4</sup>

Jeta nuk plotësohet veçse me ditët dhe netët, ashtu siç nuk plotësohen pa njëri-tjetrin edhe mashkulli e femra. As burri e as gruaja nuk janë

---

<sup>1</sup> *Thënie e Muhammedit a.s.*, e transmetuar nga Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ahmed.

<sup>2</sup> Sure El-Lejl: 1-4.

<sup>3</sup> Komentatori më me famë i Kur'anit në fundshekullin 20.

<sup>4</sup> Muhammed Muteveli Esh-Sharavi, *El-mer'tu fi-l Kur'an el-Kerim*, Dituria, Prishtinë, f. 14.

krijesa të pavarura, por janë dy krijesa me gjini të kundërt, të cilat plotësojnë njëri-tjetrin; kjo është natyrshmëria e tyre.

Për nga natyra krijuese e tij, mashkulli është krijesë më e fuqishme, më e qëndrueshme, dhe një fenomen i tillë nuk është prezent vetëm te bota njerëzore. Njësoj është edhe tek gjallesat e tjera në kozmos. Sipas mësimave kur'anore, mashkulli fizikisht është më i fuqishëm se sa femra. Gjatë historisë njerëzore, meshkujt kanë qenë më të dalluar se femrat. Liderët e popujve zakonisht vijnë nga gjinia mashkullore. Luftërat dhe shkatërrimet, në të shumtën e rasteve janë shkaktuar dhe udhëhequr nga meshkujt, edhe pse iniciativat e femrave gjithashtu nuk kanë munguar. Edhe në ndërtimet dhe zbulimet e rëndësishme shkencore dominojnë meshkujt. Me këtë nuk mund të mohohet kontributi i gjinisë femërore në të kaluarën dhe në të sotmen, mirëpo do të ishte me rëndësi të kuptojmë realitetin; mashkulli dhe femra janë dy krijesa të Zotit me gjini të kundërta, me ndryshime fiziologjike, por plotësisht të barabarta në gëzimin e të drejtave njerëzore gjatë jetës në këtë botë. Të barabartë janë edhe para detyrave dhe obligimeve të Zotit.

Dashuria, respekti, bashkëpunimi e mirëkuptimi mes burrit dhe gruas është kërkesë e Kur'anit. Burri gjen kënaqësi dhe prehje shpirtërore kur është afër gruas së tij, njësoj edhe gruaja. Dashurinë dhe mëshirën të cilën e ka

krijuar Zoti mes dy gjinive duhet respektuar dhe kultivuar.

**“Dhe nga faktet e madhërisë së Tij është që për të mirën tuaj Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), që të gjeni prehje tek ato dhe ndërmjet jush krijoi dashuri dhe mëshirë.”<sup>1</sup>**

Në të kaluarën, tek shumë shoqëri, gruaja nuk është konsideruar si partner i barabartë me burrin. Ajo është privuar nga të drejtat elementare të jetës, është trajtuar si barrë, si shejtan, etj. Në Romë dhe Greqinë e vjetër gruaja nuk zotëronte asnjë të drejtë,<sup>2</sup> ndërsa kinezët gruan nuk e llogarisnin si njeri, ndërsa indianët sipas sistemit të tyre juridik “Manu”, e detyronin gruan të lidhej pas një mashkulli; në fëmijëri pas të atit, në rini pas burrit, me vdekjen e tij pas të birit ose pas një farefisi të burrit.<sup>3</sup> Budistët në fillim të themelimit të fesë së tyre nuk pranonin që femrat të jenë ithtare të besimit budist. Ndërsa arabët paraislamikë gruan e trajtonin si barrë, ndërsa nga ana shpirtërore si shkak turpi e poshtërimi. Gruaja trajtohej pikërisht si mjet i plotësimit të epsheve të mashkullit dhe jo diçka më tepër.

Kur’ani i erdhi në ndihmë gruas që vuante. Së pari shpalli barazinë në krijim të burrit e të gruas, të njerëzve të çdo race, dhe të krejt njerëzimit:

---

<sup>1</sup> Sure Er-Rrum: 21.

<sup>2</sup> Armaner Neda, *Hadislere Gore Kadinin Sosyal, Durumun Umumi Bir Bakis*, Ankara, 1961, Nr. 9/133.

<sup>3</sup> Ahmed Shelebij, *Mukarenetul Edjan, Edjanul Hind el-kubra*.

**“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Zoti më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat). Zoti është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.”<sup>1</sup>**

Pastaj porosia tjetër: **“O ju njerëz, kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu), dhe nga ajo (vete) krijo i palën (shoqen) e tij, e prej atyre u shtuan shumë burra e gra.”<sup>2</sup>**

Para Zotit, në gëzimin e të drejtave dhe bartjen e përgjegjësiave, gruaja është plotësisht e barabartë me burrin. Gjithashtu, gruaja dhe burri janë dy krijesa plotësisht të pavarura në përgjegjësinë që kanë ndaj Krijuesit të tyre.

**“Kush bën një vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë) e (në botën tjetër), do t’i japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.”<sup>3</sup>**

**“Kush ka bërë ndonjë vepër të keqe ndëshkohet vetëm për peshën e asaj të keqe, e kush bënë ndonjë vepër të mirë, qoftë mashkull a femër, duke qenë besimtar, të tillët hyjnë në Xhennet dhe aty shpërblehen pa masë.”<sup>4</sup>**

---

<sup>1</sup> Sure El-Huxhurat: 13.

<sup>2</sup> Sure En-Nisa: 1.

<sup>3</sup> Sure En-Nahl: 97.

<sup>4</sup> Sure El-Gafir: 40.

**“Unë nuk ia humb mundin asnjërit prej jush, qoftë mashkull apo femër.”<sup>1</sup>**

Sipas Kur'anit, në besimin ndaj Zotit, në njohjen e urdhrave dhe ndalesave, në aspektin e botës dhe përjetësisë, në ndëshkim ose shpërblim, në fitim të Parajsës (Xhennetit) apo Ferrit (Xhehennemit), mes burrit dhe gruas nuk ka asnjë dallim.

---

<sup>1</sup> Ali Imran: 195.

## E drejta e femrës në edukim dhe arsimim

Askund në literaturën islame, duke filluar nga Kur'ani, pastaj tradita e profetit Muhammed a.s., por edhe tek të gjithë librat dhe veprat e autorëve muslimanë, nuk mund të gjendet një pjesë sado e vogël teksti që cenon të drejtën e femrës për edukim dhe arsimim. Dijetarët muslimanë si ajet të parë të shpallur nga Zoti e radhisin fjalën “Lexo, mëso, studio,”<sup>1</sup> ndërsa si mjet të parë të përmendur në Kur'an e radhisin “pendën”.<sup>2</sup>

Të lexuarit dhe të shkruarit është kërkesë për të gjithë njerëzit pa dallim gjinie. Besimtarët porositen që gjithmonë t'i luten Zotit të tyre që t'u shtojë diturinë.<sup>3</sup> Mbështetur në pikëpamje të drejtë fetare, nuk ekziston asnjë pengesë e cila femrës do t'ia mohonte të drejtën për arsimim dhe edukim. Nxitja për edukim dhe arsimim nuk ka munguar as në kohën sa qe gjallë profeti Muhammed a.s.. Ai thoshte:

*“Kërkimi i diturisë është obligim për çdo besimtar dhe besimtare.”<sup>4</sup>*

*“Dituria duhet kërkuar kudo, qoftë edhe në Kinë.”<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup> **“(O njeri!) Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo se Zoti yt është më bujari! Ai e mësoi njeriun të shkruajë me pendë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte.”** (Sure El-Alak: 1-5)

<sup>2</sup> **“Pasha lapsin dhe atë që shkruajnë.”**

<sup>3</sup> **“...thuaj: “Zoti im, më shto dituri”,** (Ta ha: 114).

<sup>4</sup> Transmeton Ibni Maxheh dhe të tjerët, si hadith, mund të ngrihet në shkallën e “hasenit”.

*“Për njeriun që kërkon dituri luten edhe peshqit në thellësiat më të thella të deteve dhe oqeanëve...”*

Mësimet islame i kushtojnë rëndësi të veçantë kërkimit të diturisë, kjo për faktin se njeriu nuk mund të arrijë shkallën e një besimtari të mirëfilltë e të singertë ndaj Zotit nëse nuk njoftohet me porositë e Zotit, ndërsa njohja e porosive të Zotit nuk mund të arrihet vetëm se përmes mësimit dhe studimit. Prandaj, asnjë parim kur'anor dhe asnjë porosi profetike nuk bie në kundërshtim me të drejtën e shkollimit të njeriut, qoftë ai mashkull apo femër. Në Kur'an lexojmë: **“Thuaj: “A mund të barazohen të diturit me të paditurit”<sup>2</sup>** duke mos veçuar meshkujt apo femrat. Këtu pyetja u drejtohet njerëzve në përgjithësi, pa dallim gjinie, ngjyre apo kombi.

Të drejtën e shkollimit të femrës në baza fetare e kanë nëpërkëmbur njerëzit që kanë qenë injorantë ndaj mësimëve të mirëfillta islame, duke i dhënë përparësi fanatizmit dhe traditës së një rrethi apo vendi, dhe jo mësimëve dhe porosive të mirëfillta kur'anore. Askush nuk guxon të flasë në emër të Kur'anit dhe të thotë se, sipas mësimëve kur'anore, njerëzve u është cunguar e drejta për shkollim dhe arsimim. Kur'ani thërret në formimin sa më të lartë të personalitetit të

---

<sup>1</sup> Muhammedi a.s., e kishte përmendur Kinën nga arsyeja se, në kohën e tij, Kina ishte një vend shumë i largët dhe i pashkelur për të dhe shokët e tij, për shkak të distancës së largët dhe mungesës së mjeteve për një udhëtim të shpejtë gjer atje.

<sup>2</sup> Sure Ez-Zumer: 9.

njeriut, pa dallim gjinie, mashkull apo femër, dhe në zgjerimin sa më të gjerë të diapazonit kulturor. Me këtë rast nuk mund të anashkalojmë faktin se, në mesin e njerëzve më të ditur të botës, e mendjeve më të ndritura dhe më me ndikim në botë, të cilët edhe kishin vendosur baza shkencore sidomos gjatë mesjetës, bëjnë pjesë edhe shumë ithtarë të besimit islam, të cilët për kërkimin e diturisë dhe shkencës frymëzoheshin nga mësimet kur'anore.<sup>1</sup>

Thënë prerazi, mësimi dhe arsimimi i njeriut, qoftë mashkull apo femër, është kërkesë hyjnore dhe njerëzore.

---

<sup>1</sup> Si Ibni Sina (Avicena), Fahu Razi, Ibni Rushdi (Averroes) etj.

## **Të drejtat martesore**

Institucioni i martesës është sistemi më i vjetër shoqëror që njeh njerëzimi, sepse si i tillë njihet që prej martesës së parë, të Ademit a.s., me Havanë, të cilët deshti Zoti të jenë bërthamë e tërë shoqërisë njerëzore. Që në fillim ishte më se e qartë se Ademi dhe Havaja nuk ishin thjesht vetëm burrë e grua, apo mashkull e femër. Ata ishin bashkëshortë me plot kuptimin e lidhjes, bashkimit, emocionit të dashurisë, mëshirës, si dhe përgjegjësi dhe detyrimeve bashkëshortore.

Në Islam femra gëzon të drejtën absolute që të jetë përcaktuese e fatit të vet. Martesa e detyruar, siç është praktikuar në të kaluarën dhe që, ndoshta ende praktikohet në shoqëri të ndryshme që kanë një shkallë të ulët të emancipimit, pa asnjë dyshim se është një shkelje e rëndë e të drejtës së femrës në zgjedhjen e partnerit të saj të jetës. Një hap i tillë do të binte në kundërshtim direkt me parimet kur'anore. Tradita islame i ka porositur të rinjtë që kanë vendosur të lidhin kurorë mes vete, që këtë ta bëjnë përmes rrugës zyrtare dhe ligjore. Fejesa duhet të bëhet në praninë e dëshmitarëve dhe të regjistrohet në akte normative. Mësimet islame e ndalojnë martesën e të rinjve që nuk e kanë arritur moshën madhore, vitet e pjekurisë. Martesa në Islam është e parapëlqyer për çdo njeri në moshë të rritur, të aftë fizikisht dhe psikikisht, si mënyra më e mirë

për formimin dhe krijimin e institucionit familjar dhe, pa dyshim si masa më e mirë parandaluese për t'u shmangur nga rrugët që çojnë në zgjerimin e prostitucionit dhe imoralitetit.

Sipas rregullave fetare islame, gruaja e martuar gëzon të drejtat e plota, të garantuara edhe me Kur'an. Ajo nuk guxon të nëpërkëmbet; të ushtrohet dhunë mbi të, t'i mohohet e drejta në pasuri, trashëgimi, ose t'i mohohet e drejta në kërkimin e shkurorëzimit<sup>1</sup> nga burri i saj. Kur'ani ka porositur: ***“...kaloni jetë të mirë me to (gratë), nëse i urreni ato, bëni durim, pse ndodh që Zoti të japë shumë të mira në diçka që ju e urreni.”***<sup>2</sup>

Sjellja korrekte dhe respekti reciprok mes dy bashkëshortëve është obligim, urdhër i Zotit, dhe si i tillë në mënyrë të pashmangshme duhet respektuar. Gruaja duhet t'i ketë të qarta të drejtat e veta dhe obligimet që ka ndaj burrit të saj, dhe nuk duhet t'i anashkalojë apo t'i tejkalojë ato. Po ashtu, edhe burri duhet t'i njohë të drejtat e tij dhe obligimet që ka ndaj gruas, në mënyrë që të mos i nëpërkëmbë ato.

Muhammedi a.s., thoshte: *“Më i miri në mesin tuaj është ai i cili sillet më mirë me familjen e tij, ndërsa unë nga mesi juaj sillem më së miri me familjen time.”*

---

<sup>1</sup> Ashtu siç gëzon të drejtën në zgjedhjen e bashkëshortit të saj, gruaja njëkohësisht gëzon edhe të drejtën e kërkesës për shkurorëzim nga bashkëshorti i saj, qoftë përmes rrugës private ose edhe ligjore.

<sup>2</sup> Sure En-Nisa: 19.

Martesa është një institucion i shenjtë që duhet të ruhet në maksimum, ndërsa në momentin kur jeta bashkëshortore bëhet e padurueshme, dhe nuk gjenden rrugë përveç ndarjes, atëherë duhen kërkuar zgjidhje dhe mënyra që sa më mirë dhe pa dhimbje të mëdha të tejkalohet situata e krijuar, gjithmonë duke pasur në konsideratë të drejtat që i gëzon secila palë gjatë dhe pas procesit të shkurorëzimit.

Një thënie arabe që shpeshherë në literaturën islame i atribuohet Muhammedit a.s., thotë: *“Gjëja më e urryer, por e lejuar është shkurorëzimi”*.

Sipas mësimave të Kur’anit dhe porosive profetike, femra është e detyruar të mbulojë pjesët intime të saj, duke mos i ekspozuar në vende publike.<sup>1</sup> Nga Librat e Shenjtë, si në Dhiatën e Vjetër apo atë të Re, ka pjesë që e quajnë turp zbulimin dhe urdhërojnë mbulimin.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> “O ti Pejgamber, thuaju grave të tua, bijave të tua dhe grave të besimtarëve, le të vënë mbulesën mbi trupin e tyre, sepse kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe), e të mos ofendohen. Zoti i falë gabimet e kaluara, Ai është Mëshirues”. (Sure El-Ahzab: 59)

<sup>2</sup> Bibla, Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re, Zanafilla 24/64-65; Isaia, 3/16-17.

## **E drejta e femrës për punë**

Në Kur'an nuk hasim ndonjë ajet që e mohon të drejtën e femrës për të punuar dhe përfituar nga mundi dhe djersa e saj, mirëpo mësimet islame kanë vënë disa kushte që do t'i ndihmonin femrës të jetë e suksesshme në punën e saj, në mënyrë që të ketë kohë të mjaftueshme për të qenë edhe një bashkëshorte, por edhe një nënë e suksesshme në edukimin e fëmijëve dhe ruajtjen e rendit shtëpiak. Në Islam, institucioni familjar është i shenjtë, ndërsa kontributin madhor për shenjtërinë e saj e jep gruaja. Ajo është personi që mbikëqyr dhe udhëheq rendin e brendshëm shtëpiak. Pikërisht duke u nisur nga ky fakt, në shumë shoqëri islame njerëzit ngurrojnë që gruaja e tyre përveç punëve të bollshme të shtëpisë të jetë e angazhuar edhe me ndonjë punë të re, jashtë ambientit shtëpiak. Pa dyshim se puna për gruan do të ishte mbingarkesë, mirëpo vlen të theksojmë se këtë nuk e bëjnë nga pikëpamjet e tyre fetare, por, të shtyra më tepër nga tradita dhe rrethi ku jetojnë, apo për shkaqe të tjera ekonomike apo sociale. Në shoqërinë islame nuk ekziston asnjë pengesë që gruaja të bëhet mjeke, tregtare, inxhinierë, ose të ushtrojë çfarëdo profesioni tjetër që e ushtron edhe mashkulli. Kushti i vetëm është që puna e saj të mos jetë në kundërshtim me natyrën e saj.

## Të drejtat politike të femrës

Në Kur'an nuk ka pohime të hapura mbi të drejtat politike të gruas, mirëpo ka disa ajete që i afrohen çështjes në mënyrë indirekte. Në një ajet kur'anor thuhet: ***“Besimtarët dhe besimtare të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë dhe ndalojnë nga e keqja”***.<sup>1</sup>

Në këtë ajet pohohet se detyra për të dashur dhe ndihmuar njëri-tjetrin, duke ndaluar të keqen dhe duke urdhëruar për të mirë, në mënyrë të përgjithshme u përket si burrave ashtu edhe grave. Prandaj, edhe detyra e kryetarit të shtetit s'është gjë tjetër veçse e njëjta veprimtari politike në emër të popullit, të cilën punë edhe grua mund ta kryejë. Ka gra që gjatë historisë janë marrë me politikë, kanë drejtuar ushtri dhe shtete. Shembuj të tillë kemi edhe te popujt muslimanë.<sup>2</sup> Në shumë shoqëri islame sot gruaja është pjesë e qeverisë, anëtare e parlamentit, princeshë etj. Prandaj, marrja me politikë dhe të ushtruarit e politikës nga ana e gruas nuk është në kundërshtim me mësimet islame, absolutisht.

---

<sup>1</sup> Sure En-Neml, ajeti 23.

<sup>2</sup> Dr. Bekir Topaloglu, *Gruaja në Islam*, f. 242 (përkthim në gjuhën shqipe).

## E drejta për të zgjedhur

E drejta për të votuar, për të zgjedhur apo për t'u zgjedhur nuk është e sanksionuar në asnjë ajet kur'anor. Në periudhat e para të Islamit, zgjedhja e kryetarit të shtetit bëhej me miratimin personal të drejtpërdrejtë të zgjedhësit, domethënë takim ballë për ballë dhe personal. Një hap të tillë e kishte praktikuar edhe vetë profeti Muhammed a.s., sa ishte gjallë.<sup>1</sup>

Gruaja është pjesë e pandashme e shoqërisë dhe zëri i saj është po ashtu i pandashëm në zgjedhjen e pushtetit, dhe për këtë nuk ka asnjë pengesë, qoftë direkt nga Kur'ani ose nga mësimet islame në përgjithësi.

Porosia e fundit e Muhammedit a.s., të cilën ia kishte drejtuar të pranishmëve me rastin e fjalimit të tij lamtumirës ishte:

*Njerëz! Ju këshilloj të merrni parasysh të drejtat e grave dhe, për këtë veçanti të keni frikë Zotin. Ju i morët gratë si amanet nga Zoti; duke dhënë fjalën në emër të Zotit, ju u bekuat me nderin dhe virtytin e tyre. Ju keni të drejta mbi gratë dhe ato kanë të drejta mbi ju, dhe e drejta e grave mbi ju është që t'u siguronit atyre çdo veshje e ushqim në përshtatje me fenë dhe traditën.*

---

<sup>1</sup> Siç ishte rasti në marrëveshjen e Akabes në afërsi të Mekës pak para emigrimit të Muhammedit a.s. për në Medinë.

## **Rileximi i teksteve të Islamit në kontekstin e kohës - nevojë e domosdoshme**

Islami është fe hyjnore monoteiste, e cila që në lindje të saj është mbështetur mbi dy burime themelore të tij: Kur'anin dhe thëniet e Muhammedit a.s.. Këto dy shtylla kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë edhe sot alfa dhe omega e Islamit dhe mësimëve të tij.

Burimi i parë - Kur'ani - në mesin e muslimanëve asnjëherë nuk ka qenë temë diskutimi, qoftë për shenjtërinë, vërtetësinë apo saktësinë e tij. Gjithashtu edhe thëniet dhe veprimet praktike të Muhammedit a.s., askush nga besimtarët muslimanë nuk i ka vënë ndonjëherë në dyshim si të drejta dhe buruese të tij, të cilat duhen pasuar dhe praktikuar.

Mirëpo, për dallim nga burimi i parë - Kur'ani - gjeneratat e mëvonshme pas vdekjes së Muhammedit a.s., pas vdekjes së shokëve të tij (*sahabët*) dhe të shokëve të shokëve të tij (*tabi'inët*), dijetarët muslimanë fillojnë të diskutojnë për hadithin, por jo për legjitimitetin e tij, se është apo nuk është burim i Islamit, mirëpo për formën dhe rrugët transmetuese të fjalëve të të dërguarit deri tek gjeneratat e mëvonshme. Ndërsa për tekstin kur'anor, besimtarët muslimanë asnjëherë nuk kanë pasur një diskutim siç kishin për porositë verbale dhe praktike të Muhammedit a.s..

Ndarja më e madhe për hadithin si dhe divergjencat në mesin e dijetarëve muslimanë ka ndodhur kryesisht nga ithtarët shi'itë. Ata refuzonin të pranonin të gjitha hadithet të cilat nuk buronin nga transmetues, anëtarë të familjes së ngushtë të Muhammedit a.s, kurse ithtarët sunnitë ishin kategorikë se për shkallën dhe legjitimitetin e "hadithit" duhet marrë parasysh saktësia dhe fortësia e zinxhirit transmetues të tij dhe jo kushtëzimi që transmetuesi të jetë vetëm nga familjarët e Muhammedit a.s..

Kjo ndarje fillet i ka që nga fundi i shekullit të gjashtë dhe fillimi i shekullit të shtatë, për të vazhduar e thelluar vazhdimisht deri më sot.

Lindja e shkollave juridike fetare islame pas Muhammedit a.s., pastaj ndarjet e studiuesve muslimanë në mendime dhe fraksione të ndryshme, nuk burojnë nga Kur'ani e as nga gjeneza e hadithit, por nga mendimi, rezonimi, niveli i pranimi si dhe i qasjeve të ndryshme të prijësve dijetarë të muslimanëve gjatë shekujve, që ata i kanë pasur mbi tekstet dhe burimet islame.

Në mesin e të gjithë dijetarëve muslimanë në botë ekzistojnë çështje unanime dhe vija të kuqe të përbashkëta, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me parimet bazë të besimit dhe fesë, por jo edhe për çështje të tjera dytësore, për të cilat ka pasur dhe ka hapësirë të komentimit dhe shtjellimit të lirë.

Çdo mendim, opinion dhe analizë nga njerëzit studiues të Islamit, nuk është dhe nuk

konsiderohet mendim i shenjtë, prandaj si i tillë nuk është bazë dhe mbështetje e përhershme e fesë islame, i cili duhet patjetër të ndiqet gjeneratë pas gjenerate, sepse mendimi i dijetarëve dhe i filozofëve të Islamit, mund të jetë relativ, i saktë ose i pasaktë. Një gjykim apo opinion i momentit, rastit apo i një periudhe kohore mund të jetë edhe i domosdoshëm për një kohë dhe vend të caktuar, por jo i plotfuqishëm dhe legjitim për të gjitha vendet dhe të gjitha gjeneratat njerëzore. Shenjtëria e mendimeve të dijetarëve të hershëm, si dhe bindja se ata dhe mendimet e tyre janë të shenjta dhe të paprekshme, si dhe të pandryshueshme për gjeneratat e ardhshme, është qëndrim i gabuar, i cili e ka dëmtuar dhe po e dëmton botën islame në përgjithësi, si me dekadencë ashtu edhe me çrregullime të brendshme shoqërore, duke ngelur peng të fetvave të tejkaluara, të cilat sot janë të pazbatueshme.

Një konsensus mes dijetarëve muslimanë, i dalë para 100 viteve ose më herët për një çështje të caktuar fetare, i cili ka të bëjë me formën dhe mënyrën e rregullimit të jetës shoqërore, në rrethana specifike, nuk mund të jetë detyrues edhe për kohën e sotme ose pas të sotmes, sepse natyra e jetës së njerëzve në tokë është zhvilluese, qarkulluese dhe jo statike. Ngjarjet dhe risitë e reja në botë janë të panumërta, kurse teksti kur'anor nuk përfshin dhe nuk jep zgjedhje të

detajuar dhe të drejtpërdrejtë për çdo ballafaqim të ri në rrjedhat tona të reja shoqërore.

Pikërisht, edhe për këtë arsye, dijetarët muslimanë kanë paraparë institucionin e *ixhtihadit* (studimit të përhershëm dhe të analizës konstante të teksteve fetare), si dhe atë të krahasimit, analogjisë (*kijasin*), si formë aktive për të kërkuar zgjedhje të reja në rrethana të reja të vendit dhe kohës së veprimit njerëzor. Është gjë e tepruar dhe injorancë e realitetit të kohës që të thuhet se librat e vjetra përmbajnë sot përgjigje për çdo pyetje të re!

Çdo kohë ka problemet e veta si dhe kërkesat dhe nevojat e reja. Toka sillet, yjet lëvizin në rrugët e tyre dhe akrepat e orës nuk ndalen. Prandaj, edhe ndryshimi i fetvave sipas vendit dhe kohës, për çështje të cilat nuk kanë mbështetje të prerë nga Kur’ani dhe Sunneti (tradita e Pejgamberit a.s.), është e drejtë legjitime si dhe praktikë e hershme që ato të shqyrtohen përmes institucionit të “ixhtihadit” dhe “kijazit”, i cili sot shihet edhe si një nevojë e domosdoshme.

Ata të cilët në të kaluarën kanë mbyllur, ose që edhe sot pretendojnë të mbyllin derën e ixhtihadit dhe kijazit (studimit, krahasimit si dhe analogjisë së rrjedhave ndryshuese të kohës) me tekstin e shenjtë të librit të Zotit, si dhe të opinionëve të ndryshme të dijetarëve klasikë muslimanë, janë kundër koherencës së vetë tekstit kur’anor, si dhe kundër natyrës së përshtatshmërisë së tij për të gjithë vendet dhe për të gjitha kohërat.

Nëse muslimanët në rregullimin e jetës së tyre shoqërore sot ballafaqohen me elemente dhe risi të reja, të cilat i sjellin njerëzit me kalimin e kohës, me rrethana rrënjësisht të ndryshme nga e kaluara, me sisteme të reja shoqërore dhe organizative, për të cilat nuk gjejmë praktikë të mëhershme të tyre, e as përgjigje në librat dhe mendimet klasike të dijetarëve muslimanë të mëhershëm, a do të thotë kjo se muslimanët nuk duhet ta angazhojnë mendjen e tyre që t'i qasen studimit dhe të bëjnë analogji të reja për çështje të reja, rreth të cilave nuk ekziston shpjegim paraprak në mësimet e literaturës së hershme fetare islame?!

Në interpretimin e tekstit të Kur'anit, duhet të bëhet dallimi midis ajeteve normative dhe kontekstuale të tij, sepse disa ajete të librit të shenjtë janë absolute dhe nuk mund të bëhet kompromis për të dhënë interpretime alternative, por duhet të kuptohet se ajetet jo normative, janë lënë të tilla që të kuptohen në kontekstin dhe në proporcionalitetin mes tyre. Dijetarët tradicionalë nuk e vlerësojnë këtë dallim, prandaj të gjitha ajetet i marrin si normative pa dallim. Robëria, për shembull, duke qenë një porosi e përhapur e shekullit të shtatë në Arabi, është përmendur shpesh në Kur'an, mirëpo sot nuk mund të thuhet se ajo është normë islame e cila duhet praktikuar.

Në vitin 2005 njëri nga studiuesit bashkëkohorë të Islamit në Europë, Tarik Ramadan, kishte kërkuar nga të gjithë

muslimanët e botës moratorium mbi dënimet trupore të njerëzve në emër të Islamit, sidomos të gurëzimit të njerëzve deri në vdekje. Ai në këtë kontekst thotë edhe sot se, është e pamundshme që ne si muslimanë të qëndrojmë të heshtur ndaj padrejtësive të cilat i bëhen anëtarëve më të varfër dhe më të dobët të shoqërisë, në emër të fesë, prandaj kishte apeluar tek dijetarët që të rillexojnë dhe ristudiojnë tekstet e tyre të mëhershme të fetvave në kontekstin e kohës së sotme.

Edhe në Kosovë dhe më gjerë në rajon, vitet e fundit që po lëmë pas, në mungesë të një forumi ekspertësh të besueshëm të mësimave islame, për të nxjerrë dhe dhënë mendime fetare të studiuara dhe të ekuilibruara, përmes një institucioni të studimit dhe krahasimit të fetvave (dekreteve fetare), rolin e tij dhe të vetë komuniteteve fetare e kanë marrë individë të caktuar, të cilët kanë lëshuar dhe po lëshojnë deklarata të pamatura dhe të çakorduara nga njëri tjetri, e të cilat kanë shkaktuar dhe po shkaktjnë huti dhe përçarje në radhët e vetë besimtarëve muslimanë, e pastaj edhe të qytetarëve në përgjithësi.

Në vend që për çështje fetare të flasin studiues të mësimave islame, të autorizuar nga vetë institucioni i BIK, rolin e saj e kanë marrë njerëz të dytë dhe të tretë, të cilët shihet qartë se në programin e tyre nuk kanë dertin e Islamit dhe të muslimanëve, por krejtësisht diçka tjetër.

Kërkesat për nevojat e besimtarëve muslimanë në vendin tonë dhe më gjerë, duhet të adresohen nga institucioni zyrtar përfaqësues i tyre si dhe nga njerëz kompetentë në fushën e studimeve islame, në përshtatje me rrjedhat, rrethanat dhe ndryshimet që vinë në rrjedhën organizative dhe shoqërore të vendit.

Rileximi i teksteve të hershme islame, sidomos të komentuesve dhe opinionistëve të ndryshëm, në kontekstin e rrjedhave të kohës është nevojë e domosdoshme.

Me këtë assesi nuk nënkuptohet ndryshimi i argumenteve dhe fakteve, por mëtohet gjetja e formës dhe mënyrës më të mirë të praktikimit të udhëzimeve fetare në rrjedhën e ndryshimeve shoqërore.

## PËRMBAJTJA

|                                                                                                  |    |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Fjala e recensuesve                                                                              | 3  |
| Parathënie                                                                                       | 7  |
| Feja dhe interpretimi i saj në mesin tonë                                                        | 11 |
| Liria e bindjes dhe besimit shpirtëror sipas Kur'anit                                            | 20 |
| Toleranca dhe dialogu ndërnjerëzor dhe ndërfetar<br>në këndvështrimin islam                      | 29 |
| Zhvillimi i marrëdhënieve shoqërore dhe bashkëjetesa<br>me pjesëtarë të besimeve të tjera        | 31 |
| Çështje të përbashkëta mes pjesëtarëve të feve<br>monoteiste                                     | 34 |
| Feja dhe përgjegjësia e bartësve të saj në shoqërinë<br>tonë                                     | 37 |
| Provokimet në emër të fesë janë ogurzi                                                           | 48 |
| Vrasja e të pafajshmëve në emër të fesë është veprim<br>kundër porosit të Zotit                  | 54 |
| Sistemi i ri demokratik dhe ballafaqimi me kërkesa të<br>reja të komunitetit musliman shqiptar   | 61 |
| Toleranca ndaj pakicave fetare jomuslimane në kohën<br>e Shtetit Osman, model edhe për të sotmen | 67 |
| Loja me ndjenjat e qytetarëve në emër të fesë, duhet të<br>ndërpritet                            | 75 |

## KOMUNITETI MUSLIMAN SHQIPTAR

|                                                                                                |     |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| <b>VIS-A-VIS EUROPËS</b>                                                                       | 84  |
| Islami është mbi elementet fanatike dhe adetet<br>çoroditëse të fiseve dhe popujve të ndryshëm | 92  |
| Pse ndodhin vrasje të njerëzve të pafajshëm në emër të<br>"Islamit"?                           | 98  |
| A duhet të ketë ndonjë zyrë për adresimin e çështjeve<br>fetare islame tek ne?                 | 103 |
| Xhamia, faltoret dhe pesha e fjalës publike                                                    | 106 |

|                                                                             |            |
|-----------------------------------------------------------------------------|------------|
| <b>NJERIU DHE PËRGJEGJËSIA E TIJ NË TOKË</b>                                | <b>111</b> |
| Virtytet e larta njerëzore janë edhe porosi hyjnore                         | 118        |
| Kush mund të flasë për Kur'anin e kush jo?!                                 | 123        |
| Studiues shqiptarë dhe definicione të çmuara të tyre për Kur'anin           | 131        |
| Femra sipas Kur'anit dhe të drejtës islame                                  | 138        |
| Barazia burrë-grua                                                          | 140        |
| E drejta e femrës në edukim dhe arsimim                                     | 145        |
| Të drejtat martesore                                                        | 148        |
| E drejta e femrës për punë                                                  | 151        |
| Të drejtat politike të femrës                                               | 152        |
| E drejta për të zgjedhur                                                    | 153        |
| Rileximi i teksteve të Islamit në kontekstin e kohës - nevojë e domosdoshme | 154        |
| Përmbajtja                                                                  | 161        |